

(2) До донесување на програмата од ставот (1) на овој член во јавните установи за деца - детски градинки ќе се применуваат Основите на програмата за воспитно-образовна работа со деца од предучилишна возраст во јавните детски градинки.

**Член 243**

Со денот на влегувањето во сила на овој закон престанува да важи Законот за заштита на децата („Службен весник на Република Македонија“ број 98/2000, 17/2003, 65/2004, 113/2005, 98/2008, 107/2008, 83/2009, 156/2009, 51/11 и 157/11).

**Член 244**

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

**L I G J**  
**PËR MBROJTJEN E FEMIJEVE**

**I. DISPOZITA THEMELORE**

**Neni 1**

Me kete ligj rregullohet sistemi dhe organizimi i mbrojtjes së femijeve.

**Neni 2**

(1) Mbrojtja e femijeve eshte veprimtari e organizuar e bazuar në të drejtat e femijeve, si dhe në të drejtat dhe obligimet e prinderve për planifikimin e familjes dhe të shtetit dhe të njesive të vetadministrimit lokal për udheheqjen e politikës popullore humane.

(2) Mbrojtja e femijeve realizohet me sigurimin e kushteve dhe nivelit të standardit jetesor që korresponдон me zhvillimin fizik, mental, emocional, moral dhe social të femijeve.

(3) Shteti, si dhe njesite e vetadministrimit lokal kujdesen për dhenien e ndihmes адекуате materiale prinderve për mbajtjen, ngrитjen, kujdesin dhe mbrojtjen e femijeve dhe organizimin dhe sigurimin e zhvillimit të institucioneve dhe sherbimeve për mbrojtjen e femijeve.

**Neni 3**

Mbrojtja e femijeve sipas ketij ligji realizohet permes sigurimit të të drejtave të caktuara, mjeteve dhe formave për mbrojtjen e femijeve.

**Neni 4**

Në zbatimin e dispozitivave të ketij ligji niset nga parimet e mbrojtjes së të drejtës së jetes dhe zhvillimit të femijes, mbrojtjes së interesit më të mire të femijes, sigurimit të standardit minimal për çдо femije në kushte të barabarta, perjashtimit të cfaredo qofte forme të дискриминимит, respektimit të të drejtës së femijes për liri dhe siguri të personalitetit, mendimit dhe shprehjes së libre, bashkimit dhe аrsимит, kushteve për jete të shendetshme dhe realizimit të të drejtave tjera sociale dhe lirive të femijes.

**Neni 5**

(1) Shteti e siguron të drejtjen e femijes që та shpreh mendimin e tij për të gjitha чeshtjet që kane të bejne me të dhe mendimit të femijes t'i kushtohet vemendje e vecante në pajtim me moshen e tij dhe pјekurine e femijes.

(2) Shprehja e femijes mund të jete e drejtperdrejte ose permes perfaqesuesit ose organit адекуат në menyре dhe në pajtim me proceduren e percaktuar dhe ligj.

**Neni 6**

(1) Të drejta për mbrojtjen e femijeve sipas ketij ligji jane:

- 1) shtesa të femijeve;
- 2) shtesa e vecante;
- 3) ndihma e njehershme në para për foshnje të sapоlinдur;
- 4) shtesa të prinderve për femije dhe
- 5) participim.

(2) Të drejtat nga параграф (1) i ketij ligji, në kushte të percaktuara me kete ligj, i siguron shteti.

(3) Vellim më të madh të të drejtave nga параграф (1) i ketij neni, mund të siguroje komuna, komuna në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, nese për kete siguron mjete nga burime të veta.

(4) Menyren dhe kriteret e peraferta për realizimin e të drejtave për mbrojtjen e femijeve nga параграф (3) i ketij neni, i percakton keshilli i komunes, keshilli i komunes në Qytetin e Shkupit dhe Keshilli i Qytetit të Shkupit.

**Neni 7**

Format e mbrojtjes së femijeve sipas ketij ligji jane:

- 1) perkujdesja dhe edukimi i femijeve të moshes парашkollре;
- 2) pushimi dhe rekreacioni i femijeve dhe
- 3) forma tjera të mbrojtjes.

**Neni 8**

Veprimtaria e mbrojtjes së femijeve eshte me interes publik.

**Neni 9**

Në sigurimin e mbrojtjes së femijes dhe të drejtave të tij, të percaktuara në ligj, perfshihen: prinderit, familja, kujdestaret e femijes dhe familja perkujdesese, si dhe nga institucionet për femije, institucionet аrsimore, sociale, shendetesore dhe kulturore dhe individet, institucionet shteterore dhe institucionet e njesive të vetadministrimit lokal, организатат dhe persona tjere fizike dhe juridike аktivitetet e të cilеve jane të lidhura me dhenien e perkrahjes dhe ndihmes femijeve.

**Neni 10**

(1) Të drejtat e femijeve të percaktuara në nenin 6 të ketij ligji, jane të drejta personale dhe nuk mund të barten.

(2) Të drejtat e femijeve që perbehen nga të ardhura në para, nuk mund të jene lende e permбарimit.

**Neni 11**

(1) Si femije, sipas ketij ligji, konsiderohet çдо person deri në 18 vjet, si dhe persona me pengesa në zhvillimin trupor dhe mental deri në 26 vite të mbushura.

(2) Me perjashtim nga параграф (1) i ketij neni, gjate realizimit të shteses për femije si femije konsiderohet personi deri në 18 vite të mbushura edhe nese personi që eshte në moshe shkollare gjendet në shkollim të rregullt.

**Neni 12**

(1) Ndalohet çдо forme e дискриминимит në baze të races, ngjyres së lekures, gjinise, gjuhes, religjionit, bindjes politike apo bindjes tjeter, origjines nazionale, etnike ose sociale, perkatesise kulturore ose perkatesise tjeter, gjendjes прonesore, paaftesise, lidnjes ose statusit tjeter të femijes ose prinderit të tij apo kujdestarit ligjor.

(2) Ndalohen të gjitha format e shfrytezymit seksual dhe keqperdorimit seksual të femijeve (shqetesim, pornографі për femije, prostitucion femijeror), mashtrimi i dhunshem, shitja ose tregtia me femije, dhuna dhe keqtrajtimi psikik dhe fizik, denimi ose veprimi tjeter johuman, të gjitha

llojet e eksploatimit, shfrytezimi komercial dhe keqperdorimi i femijeve me të cilat cenohen të drejtat dhe lirite themelore të njeriut dhe të drejtat e femijes.

(3) Shteti dhe institucionet e sistemit i ndermarrin të gjitha masat për mbrojtjen e femijeve nga perdorimi ilegal dhe çdo lloj keqperdorimi të punes së femijes në prodhimtarine ilegale dhe tregtine me droga dehese, substanca psikotropike dhe prekursorë.

(4) Ndalohet keqperdorimi i femijeve për shkak të organizimit dhe veprimit politik ose fetar.

(5) Ndalohet perfshirja e femijeve në konflikte të armatosura dhe rekrutimi i tyre në njesite që realizojne veprime luftarake dhe veprime tjera.

(6) Shteti dhe institucionet e sistemit jane të obliguar që t'i ndermarrin të gjitha masat e nevojshme që t'i sigurojne të drejtat e femijes edhe për pengimin e të gjitha formave të diskriminimit dhe keqperdorimit pa marre parasysh vendin se ku jane kryer ato veprime, peshen, intensitetin dhe kohezgjatjen e tyre

(7) Çdo qytetar detyrohet që para organit kompetent të paraqese cfaredo qofte forme të diskriminimit, keqperdorimit dhe shfrytezimit të femijes në format e theksuara në paragrafet (1), (2), (3), (4) dhe (5) të ketij neni edhe atë menjehere pas marrjes së njohurive për ngjarjen.

#### Neni 13

(1) Ndalohet cfaredo lloj i diskriminimit të drejtperdrejte apo të terthorte dhe keqtrajtimi në realizimin e të drejtave dhe formave të mbrojtjes së femijes, të percaktuara me kete ligj.

(2) Ndalimi nga paragrafi (1) i ketij neni, ka të beje me të gjitha institucionet për mbrojtje sociale dhe siguri sociale që vendosin për të drejtat e percaktuara me ligjin, institucionet publike për femije të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonise (në tekstin e metejme: Qeveria), institucionet publike për femije të themeluara nga komuna, komunat në Qytetin e Shkupit, Qyteti i Shkupit dhe institucionet private për femije të themeluara nga persona fizike dhe juridike, personi juridik i regjistruar si agjenci për dhenien e sherbimeve për ruajtjen dhe perkujdesjen e femijeve të moshes parashkolllore, si dhe personi fizik që kryen pune të caktuara nga veprimtaria perkujdesje dhe edukim i femijeve si veprimtari profesionale.

#### Neni 14

(1) Diskriminim i drejtperdrejte, sipas nenit 13 të ketij ligji, eshte çdo veprim me të cilin kerkuesi ose shfrytezuesi i mbrojtjes së femijeve ka qene i vendosur në pozite të pavolitshme nga shfrytezues tjere në raste krahasimtare për shkak të perkatesise racore, etnike ose perkatesise tjeter.

(2) Diskriminim i terthorte, sipas ketij ligji, ekziston kur me dispozite të caktuar neutrale, kriter ose praktike, e vendos kerkuesin ose shfrytezuesin e mbrojtjes së femijeve në pozite të pavolitshme në raport me persona tjere për shkak të perkatesise racore, etnike ose perkatesise tjeter, pervec nese jane percaktuar kriteret ose praktika që jane objektivistisht të arsyeshme me qellim legjitim dhe mjetet për arrijten e atij qellimi jane të pershtatshme dhe të domosdoshme.

#### Neni 15

(1) Në rastet e diskriminimit nga nenet 13 dhe 14 të ketij ligji, kerkuesi ose shfrytezuesi i të drejtave dhe formave të mbrojtjes së femijeve ka të drejte që të kerkoje mbrojtje nga organi kompetent.

(2) Çdo veprim diskriminues, i bere në kryerjen e detyres zyrtare paraqet baze për ngritjen e procedures për diskriminim në pajtim me Ligjin për pengim dhe mbrojtje nga diskriminimi.

#### Neni 16

(1) Perkujdesja dhe edukimi i femijeve organizohet dhe sigurohet në institucione publike dhe private për femije.

(2) Institucione për perkujdesje dhe edukim të femijeve jane: kopshtet për femije dhe qendrat për zhvillim të hershem të femijeve dhe mund të jene: publike (shtetore, të komunes dhe të komunes në Qytetin e Shkupit) dhe private.

(3) Perkujdesja dhe edukimi i femijeve mund të organizohet dhe realizohet edhe në institucione tjera dhe kushte hapasinore, në kushte të percaktuara me kete ligj.

#### Neni 17

(1) Perkujdesja dhe edukimi i femijeve nga mosha parashkolllore eshte forme e mbrojtjes së femijeve që e perbejne të gjithë personat fizike dhe juridike në në territorin e Republikës së Maqedonise, veprimtaria themelore e të cileve eshte kryerja e puneve në lidhje me perkujdesjen dhe edukimin e femijeve të moshes parashkolllore.

(2) Persona juridike nga paragrafi (1) i ketij neni nenkuptohen:

- kopshtet e femijeve,
- qendrat për zhvillim të hershem të femijeve dhe
- Agjencite për dhenien e sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkolllore.

(3) Persona fizike nga paragrafi (1) i ketij neni, nenkuptohen personat fizike që kryejne pune të caktuara nga veprimtaria perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshes parashkolllore.

(4) Personat juridike nga paragrafi (2) alinete 1 dhe 2 të ketij neni mund të organizohen si institucione publike dhe institucione private.

(5) Institucione publike jane personat juridike që jane themeluar nga komuna, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qeveria në kushte të percaktuara me kete ligj.

(6) Institucionet private jane persona juridike të themeluar nga persona vendas ose të huaj fizike ose juridike në kushte të percaktuara me kete ligj.

#### Neni 18

(1) Pushim dhe rekreacion i femijeve organizohet dhe sigurohet në institucione publike dhe private për femije.

(2) Institucione për pushim dhe rekreacion të femijeve jane: publike (pushimore shtetore për femije, pushimore komunale për femije dhe pushimore për femije e Qytetit të Shkupit) dhe pushimore private për femije.

#### Neni 19

(1) Institucionet për femije kane cilesine e personit juridik dhe regjistrohen në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonise.

(2) Institucionet për femije kane statut.

(3) Statutin e miraton organi i menaxhimit të institucionit për femije.

(4) Pelqim për statutin e institucionit publik për femije të themeluar nga komuna dhe komuna e Qytetit të Shkupit, jep keshilli i komunes dhe i komunes në Qytetin e Shkupit.

(5) Pelqim për statutin e institucionit publik për femije të themeluar nga komuna dhe Qyteti i Shkupit, jep keshilli i komunes dhe i Qytetit të Shkupit.

(6) Pelqim për statutin e institucionit publik për femije të themeluar nga Qeveria jep organi i administrates shtetore kompetent për punet nga sfera e mbrojtjes së femijeve (në tekstin e metejme: Ministria).

(7) Për shkak të specifikes së mbrojtjes së femijeve, pelqim për statutin e institucionit privat për femije jep keshilli i komunes në rajonin e së ciles eshte selia e institucionit, në afat prej 15 diteve nga dita e parashtrimit të kerkeses.

(8) Nese në afatin nga paragrafi (7) i ketij neni keshilli i komunes nuk prononcohet, konsiderohet se pelqimi eshte dhene.

(9) Institucioni për femije ka vule.

(10) Në mesin e vules së institucionit publik eshte ste ma e Republikës së Maqedonise, kurse anash eshte emri i Republikës së Maqedonise, emri dhe vendi i institucionit.

#### Neni 20

(1) Zhvillimi i veprimtarise për mbrojtjen e femijeve percaktohet me programin për zhvillimin e veprimtarise për mbrojtjen e femijeve.

(2) Programin nga paragrafi (1) i ketij neni e miraton Qeveria.

(3) Qeveria e percakton rrjetin e institucioneve publike për femije (kopshteve për femije dhe qendrave për zhvillim të hershem të femijeve) të themeluara nga komuna dhe komunat në Qytetin e Shkupit, me propozim të Ministrise pas mendimit paraprak të keshillit të komunes dhe të komunes në Qytetin e Shkupit.

(4) Qeveria e percakton rrjetin e pushimoreve publike për femije, të themeluara nga komuna dhe Qyteti i Shkupit, me propozim të Ministrise pas mendimit paraprak të keshillit të komunes dhe të Qytetit të Shkupit.

(5) Qeveria e percakton rrjetin e institucioneve publike për femije të themeluar nga Qeveria me propozim të Ministrise.

(6) Gjate percaktimit të rrjetit të institucioneve për femije nga paragrafet (3), (4) dhe (5) të ketij neni, Ministria do-rezon te Qeveria pasqyre të institucioneve private për femije.

## II. TË DREJTA PËR MBROJTJEN E FEMIJEVE

### 1. Shtesa për femije

#### Neni 21

Shtesa për femije eshte e drejte e femijes dhe sigurohet si kompensim në para për mbulimin e një pjese të shpenzimeve në ngritjen dhe zhvillimin e femijes.

#### Neni 22

(1) E drejta për shtesa për femije sigurohet për femije, shtetas të Republikës së Maqedonise, që eshte në shkollim të rregullt në Republikën e Maqedonise.

(2) Të drejten për shtesa për femije mund ta realizoje njeri nga prinderit e femijes, kujdestari ose personi të cilit me aktvendim të qendres kompetente për pune sociale i eshte besuar femija dhe jeton në familje me të (në tekstin e me-tejme: shfrytezuesi) në kushte të percaktuara me kete ligj.

(3) Shfrytezuesi duhet të jete shtetas i Republikës së Maqedonise me vendbanim të perhershëm në Republikën e Maqedonise tre vitet e fundit para parashtrimit të kerkeses.

(4) Shfrytezuesi të drejten për shtesa për femije mund ta realizoje vetem sipas një baze.

#### Neni 23

Shtetasi i huaj që ka vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonise mund ta realizoje shtesen për femije në pajtim me kete ligj dhe marreveshjet e ratifikuara nderkombetare në pajtim me Kushtetuten e Republikës së Maqedonise.

#### Neni 24

Shtesa për femije realizohet varesisht nga mosha e femijes dhe gjendja materiale e familjes.

#### Neni 25

(1) E drejta e shteses për femije sigurohet për femije deri në mbushjen e 18 viteve edhe nese femija i moshes shkollore eshte në shkollim të rregullt, edhe atë:

- për femije që eshte nxenes i rregullt në shkolle fillore deri në perfundimin e shkollimit për aq vite sa zgjat shkollimi i rregullt, perfundimisht me 31 gusht të vitit dhe

- për femije që eshte nxenes i rregullt në shkolle të mesme, për çdo vit shkollor perfundimisht me 31 gusht të vitit, por më së gjati deri në mbushjen e 18 viteve.

(2) Femijes të cilit i eshte nderprere cilesia e nxenesit të rregullt nuk i takon shtese për femije dhe e drejta i nderpritet nga dita e pare e muajit të ardhshëm pas perfundimit të asaj cilesie.

(3) Femija që plotesisht dhe pergjithmone ose për më gjate se një vit do të mbetet i paaftë për pune para se t'i mbush 15 vite, ose gjate shkollimit të rregullt, ka të drejte për shtesa për femije gjate kohezgjatjes së paaftesise së femijes, por më së gjati deri në 18 vite moshe.

(4) Si i paaftë për pune plotesisht dhe pergjithmone konsiderohet edhe femija të cilit i eshte pranuar e drejta e aftesimit për pune deri në perfundimin e tij të suksesshem, por më së gjati deri në mbushjen e 18 viteve.

(5) Me perjashtim nga paragrafi (1) i ketij neni, të drejte për shtese për femije ka femija i cili për shkak të semundjes ose lendimit eshte i penguar që rregullisht ta ndjeke mesimin dhe për shkak të pengeses së atille arsimin e vazhdon me korrespondence në pajtim me ligjin.

#### Neni 26

(1) Shtesa për femije u takon femijeve që prindi i mban, edhe atë për: femije të lindur në martesë ose jashte martesë, femije të adoptuar, si dhe për niper, vellezer, mo-tra dhe për femije tjere të marre për mbajtje.

(2) Për femijet e marre për mbajtje, shtesa për femije u takon edhe kur ata kane prinder, nese:

- prinderit jane plotesisht apo pergjithmone të paaftë për pune,

- jane në vuajtje të denimit me burg,

- u eshte hequr e drejta prinderore dhe

- prinderit jane në shkollim të rregullt.

(3) Shtesa për femije nga paragrafi (2) i ketij neni, u takon në rast kur edhe prinderit edhe femijet nuk kane prone ose të hyra tjera nga të cilat femijet mund mbahen.

(4) Shtesa për femije i takon edhe femijes i cili eshte pa kujdes prinderor, e që eshte i vendosur në familje perkujdesese.

#### Neni 27

(1) Gjendja materiale e familjes percaktohet në baze të të hyrave që i realizon familja dhe numrit të anetareve të familjes.

(2) Të hyra në baze të të cilave percaktohet gjendja materiale e familjes konsiderohen të hyrat e realizuara në të gjitha bazat e të gjithë anetareve të familjes si të hyra të familjes, si vijon:

- rroge dhe kompensime të rroges (të zvogeluara për kontributet e percaktuara me ligj),

- të hyra pensionale në pajtim me ligjin,

- kompensim në para për persona të papunesuar,

- ndihme e perhershme në para,

- ndihme sociale në para,

- të hyra në baze të: prones dhe të drejtave pronesore; në baze të kryerjes së veprimtarise së pavarur, në baze të kryerjes së veprimtarise zeytare etj, dhe të hyra tjera që i nenshtrohen tatimit (nga të drejta autoriale, të drejta të pronesise industriale, marreveshje për veper, ekspertize, të hyra të perkohshme),

- të hyra në baze të kryerjes së veprimtarisë bujqesore që paraqesin të hyra kadastrale, që ka sherbyer si baze për percaktimin e tatimit mbi të hyra nga veprimtaria bujqesore),

- të hyra në baze të punës së perkohshme jashtë vendit,  
- të hyra të realizuara jashtë vendit të punetoreve të derguar jashtë vendit,

- alimentacion dhe bursa dhe  
- pagese invalidore civile.

(3) Si të hyra sipas paragrafit (2) të ketij neni, nuk konsiderohen shtesa e vecante, kompensimet për demtim trupor, kompensimi në para për ndihme dhe perkujdesje nga personi tjetër, ndihma e njehershme në para, ndihma e njehershme në para për foshnje të sapolindur, shtesa të femijeve për prinder, të hyrat e familjes perkujdesese, kompensimi në para për shpenzime për personin e perkujdesur në familje perkujdesese, ndihma në rast të fatkeqesive elementare, subvencione në baze të veprimtarisë bujqesore si profesion i vetëm dhe alimentacioni që e jep prindi për mbajtjen e femijes nga shkurorëzimi i martesës.

(4) Gjate percaktimit të së drejtës për shtese për femije, të hyrat e pergjithshme të realizuar në vitin paraprak nga paragrafi (2) alinete 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9, 10 dhe 11 të ketij neni dhe të hyrat e realizuara të pergjithshme nga para vitit paraprak nga paragrafi (2) alinete 6 dhe 7 të ketij neni, të të gjithë anetareve të familjes mblidhen veç e veç dhe pjesetohen me 12, perkatesisht për aq muaj për sa janë realizuar.

(5) Të hyrat mesatare mujore të familjes nga paragrafi (4) i ketij neni, pjesetohen me numrin e anetareve të familjes.

#### Neni 28

(1) Familjen sipas ketij ligji e perbejne bashkeshortet e martuar dhe të pamartuar, femijet e lindur në martesë, jashtë martesë ose të adoptuar, të biësuar, nipër pa prind të marre për mbajtje dhe motra dhe vellezer të mitur (nese nuk kane prinder dhe jane pa mjete për ekzistence), që perbejne një bashkesi të jetesës, ekonomizimit dhe shpenzimit.

(2) Me perjashtim nga paragrafi (1) i ketij neni, anetar i familjes nuk konsiderohen: personat që shteti u ka siguruar mbajtje të plote pa pagese, që qendrojnë së paku gjashtë muaj jashtë vendit ose gjenden në vuajtje të denimit me burg.

#### Neni 29

(1) Të drejte për shtese për femije ka femija në familje, të hyrat e së ciles në të gjitha bazat për anetar të familjes janë deri 2 490 denare, kurse për femije të prindit vetëmbajtes janë deri 4 980 denare.

(2) Shumat nga paragrafi (1) i ketij neni, harmonizohen me rritjen e shpenzimeve për jetesë për vitin paraprak të publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikes, në janar për vitin rrjedhes.

#### Neni 30

Shtesa për femije nuk jepet për:

- femije i cili për shkak të edukimit, shkollimit ose aftesimit është në ent ose institucion në të cilat teresisht falas është perkujdesur gjate kohës në të cilën gjendet në ent apo institucion dhe

- femije shtetas të Republikës së Maqedonisë për të cilin prindi ka realizuar të drejte të shtesës për femije në pajtim me rregullat e shtetit tjetër.

#### Neni 31

(1) Lartesia e shtesës për femije është:

1) për femije të moshës parashkolllore dhe për femije nxenes në shkollë fillore 716 denare dhe

2) për femije nxenes në shkollë të mesme deri në mbushjen e 18 viteve 1 136 denare.

(2) Për femijet e paafte plotesisht dhe pergjithmone për pune, lartesia e shtesës për femije percaktohet në menyrenë vijim:

1) për femije të paafte në teresi dhe pergjithmone për pune deri në 15 vite moshe 716 denare dhe

2) për femije të paafte për pune plotesisht dhe pergjithmone mbi 15 vite jete deri në mbushjen e 18 viteve moshe 1 136 denare.

(3) Shuma e pergjithshme mujore për shtese për femije për femijet për të cilët prindi e ka realizuar të drejten është 1 800 denare.

(4) Shumat nga paragrafet (1) dhe (2) të ketij neni, dhe shumata e pergjithshme mujore nga paragrafi (3) i ketij neni, harmonizohen me rritjen e shpenzimeve për jetesë për vitin e kaluar, të publikuara në Entin Shtetëror të Statistikes, në janar për vitin rrjedhes.

(5) Me kalimin e femijes nga shkolla fillore në shkollë të mesme ndryshohet lartesia e shtesës për femije nga muaji i pare i vitit shkollor.

(6) Me perjashtim nga paragrafi (5) i ketij neni, për femije që plotesisht apo pergjithmone apo për më gjate se një vit do të mbetet i paafte për pune para se t'i mbushë 15 vite ose gjate shkollimit të rregullt, si dhe për femije të cilët i pranohet e drejta e aftesimit për pune, lartesia e shtesës për femije i ndryshohet nga muaji i ardhshëm pas mbushjes së 15 viteve moshe.

## 2. Shtesa e vecante

#### Neni 32

(1) Për femije me nevoja specifike që ka pengesa në zhvillimin trupor ose mental ose pengesa të kombinuara në zhvillim deri në 26 vite moshe sigurohet shtese e vecante si kompensim në para.

(2) Kostatim, vleresim dhe mendim për nevojën për realizim të shtesës së vecante jep organi profesional për vleresimin e llojit dhe shkallës së pengesës së personave në zhvillimin mental ose trupor.

#### Neni 33

Femije me pengesa në zhvillim dhe me nevoja specifike sipas ketij ligji është femija me:

- pengesa të renda, më të renda dhe shume të renda në zhvillimin trupor,

- pengese mentale mesatare, e rende ose e thelle,

- forma shume të renda të semundjeve kronike,

- shkalle shume e larte e demtimit të të parit, degjimit ose të të folurit (person i verber dhe person i verber praktikisht; person i shurdher praktikisht dhe person i shurdher totalisht; person me mungese të plote të të folurit, person me të folur të demtuar për shkak të paralizes për femije, person me autizem, person me të folur të demtuar apo të humbur që e ka pasur më pare) dhe

- më shume lloje të pengesave (të kombinuara) në zhvillim.

#### Neni 34

(1) Të drejte për shtese të vecante ka njeri prej prinderve të femijes ose personi të cilit me aktvendim të qendres kompetente për pune sociale i është besuar femija dhe jeton në familje me të, me vendbanim të perhershëm në Republikën e Maqedonisë, nese femija është shtetas i Republikës së Maqedonisë me vendbanim të perhershëm në Republikën e Maqedonisë deri në mbushjen e 26 viteve moshe, nese nuk është perkujdesur në menyre institucionale në ngarkim të shtetit.

(2) Тë drejte për shtese të vecante ka edhe personi me status të pranuar të refugjatit dhe personi nën mbrojtje subsidiare, që ka femije me pengesa në zhvillim dhe me nevoja specifike në kushte të percaktuara me kete ligj.

#### Neni 35

(1) Lartesia e shteses së vecante është 4 202 denare.  
(2) Shuma nga paragrafi (1) i ketij neni, harmonizohet me rritjen e shpenzimeve për jetese për vitin paraprak të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikes, në janar për vitin rrjedhes.

### 3. Ndhimja e njehershme në para për foshnje të sapolindur

#### Neni 36

(1) Ndhimja e njehershme në para për foshnje të sapolindur i sigurohet familjes për foshnje të pare të sapolindur.  
(2) Foshnje e pare e sapolindur konsiderohet femija që është foshnje e pare e sapolindur me radhe nga nena.  
(3) Foshnje e pare e sapolindur nga paragrafi (2) i ketij neni do të konsiderohen edhe femijet kur nena gjate lindjes së pare do të linte më shumë femije pernjehere (binjake, trinjake e më shumë).  
(4) Foshnje e pare e sapolindur do të konsiderohet edhe femija i pare i adoptuar, si edhe kur do të adoptohen më shumë femije pernjehere (binjake, trinjake e më shumë) gjate adoptimit të pare, në moshe të femijes/femijeve deri në një vit nese nena nuk ka foshnje të pare të sapolindur sipas paragrafeve (2) dhe (3) të ketij neni.

#### Neni 37

(1) Тë drejte të shfrytëzimit të ndihmes së njehershme në para për foshnje të sapolindur ka njeri prej prinderve, shtetas i Republikës së Maqedonise me vendbanim të perhershem në Republikën e Maqedonise për femije të lindur në territorin e Republikës së Maqedonise.  
(2) Lartesia e ndihmes së njehershme në para për foshnje të sapolindur është 4 829 denare.  
(3) Shuma nga paragrafi (2) i ketij neni, harmonizohet me rritjen e shpenzimeve për jetese për vitin paraprak të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikes, në janar për vitin rrjedhes.

### 4. Shtesa të prinderve për femije

#### Neni 38

(1) Shtese të prinderve për femije realizon nena për femijen e vet të trete të lindur të gjalle.  
(2) Тë drejten nga paragrafi (1) i ketij neni, e realizon nena e cila është shtetase e Republikës së Maqedonise me vendbanim të perhershem në Republikën e Maqedonise në tre vitet e fundit para parashtrimit të kerkeses.  
(3) Тë drejten nga paragrafi (1) i ketij neni, e realizon nena e cila kujdeset drejtperdrejt për femijen për të cilin ka paraqitur kerkese, femijet e së ciles nga rendi paraprak i lindjes nuk jane vendosur në institucion për mbrojtje sociale, familje perkujdesese ose nuk jane dhene për adoptim dhe të ciles nuk i është hequr e drejta prinderore mbi femijet nga rendi paraprak i lindjes.  
(4) E drejta nga paragrafi (1) i ketij neni, nuk mund të realizohet nese nena gjate shtatezenise nuk ka bere kontrolle shendetesore dhe kontrolle tek mjeku i zgjedhur-specialist i gjinekologjise dhe akusherise.  
(5) E drejta nga paragrafi (1) i ketij neni, nuk mund të realizohet, perkatesisht do ta humb të drejten tanime të marre, nese:  
- nuk behen vaksinimet e detyrueshme të femijes në pajtim me ligjin dhe

- femija nuk regjistrohet dhe rregullisht nuk e ndjek mesimin në shkolle fillore në pajtim me ligjin.

(6) Me perjashtim nga paragrafi (5) alinete 1 dhe 2 të ketij neni, e drejta e shteses prinderore realizohet edhe për femijen:

- që për shkak të semundjes ose lendimit është i penguar që rregullisht ta ndjek mesimin dhe për shkak të pengese së atille e vazhdon arsimin me korrespondence në pajtim me ligjin dhe

- që për shkak të shkalles së pengeses nuk mund të arsimohet në pajtim me ligjin.

(7) E drejta nga paragrafi (1) i ketij neni, nuk mund të realizohet nese nena në momentin e parashtrimit të kerkeses jeton dhe punon jashte vendit.

(8) Тë drejten nga paragrafi (1) i ketij neni në rast kur nena nuk është gjalle, ta kete braktisur femijen, ose për shkaqe të arsyeshme të jete e penguar që drejtperdrejt të kujdeset për femijen, të drejten në vend të nenes mund ta realizoje babai ose kujdestari nese i ploteson kushtet nga paragrafet (1) deri (7) të ketij neni.

(9) Shkaqe të arsyeshme nga paragrafi (8) i ketij neni, jane:

- mjekimi më i gjate spitalor në vazhdimesi i nenes,  
- gjendja e shendetesore e rrezikuar seriozisht e nenes,  
- qendrimi studimor, persosja dhe specializimi i nenes dhe  
- aftesia e hequr për pune e nenes.

#### Neni 39

(1) Shtesa prinderore për femije të trete nga neni 38 i ketij ligji paguhet në muaj, për periudhe prej dhjete vitesh, në lartesi prej 8 048 denare.

(2) Shuma nga paragrafi (1) i ketij neni, harmonizohet me rritjen e shpenzimeve për jetese për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikes, në janar për vitin rrjedhes.

### 5. Participimi

#### Neni 40

(1) Varesisht nga gjendja materiale e familjes, sigurohet participim në shpenzimet për perkujdesje dhe edukim dhe rekreacion të femijeve në institucion publik për femije  
(2) Participimi nga paragrafi (1) i ketij neni sigurohet në cmimin e sherbimit për femije që e paguan prindi.  
(3) Participimi sigurohet nga Buxheti i Republikës.

### 6. Procedura për realizimin e të drejtave për mbrojtjen e femijeve

#### Neni 41

(1) Procedura për realizimin, perkatesisht vazhdimin e të drejtes për mbrojtjen e femijeve, ngrihet pas kerkeses së parashtruar të prindit, perkatesisht kujdestarit të femijes.

(2) Kerkesa për realizimin e të drejtes për mbrojtjen e femijeve nga neni 6 paragrafi (1) i ketij ligji, pervec për të drejten nga pika 5, me dokumentacionin e nevojshem në shtojce parashtrohet te qendra për pune sociale, kompetente për rajonin në të cilin parashtruesi i kerkeses ka vendbanim, ndersa për ndihme të njehershme në para për foshnje të sapolindur dhe për shtese prinderore për femije te qendra për pune sociale, kompetente për rajonin në të cilin nena ka vendbanim të perhershem.

(3) Qendra për pune sociale do t'i shfrytëzoje të dhenat personale të parashtruesit për nevojat e procedures, në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhenave personale.

(4) Dokumentacionin (certifikatat, vertetimet etj.) për fakte për të cilat organi i administrates shtetërore ose subjekti tjetër kompetent për vendimarrje mban evidence zyrtare, do të konsiderohet se parashtruesi i kërkeses e ka dorezuar me kerkese, nese qendra për pune sociale kompetente mund ta marrë me detyrë zyrtare.

(5) Të dhenat për faktet si dhe dokumentacionin perkaftes për të cilat evidence zyrtare mban qendra për pune sociale, personi zyrtar që e udhëheq procedurën i siguron me detyrë zyrtare dhe konsiderohet se parashtruesi i kërkeses i ka parashtruar me kërkesen.

(6) Menyra e marrjes dhe shkëmbimit të të dhenave personale të parashtruesit të kërkeses, e që janë të nevojshme në procedurën e vendosjes për kërkesen behet në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhenave personale.

(7) Formen dhe përmbajtjen e formularit të kërkeses dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e të drejtës nga paragrafi (2) i ketij neni, i percakton ministri që udhëheq me organin e administrates shtetërore kompetent për mbrojtjen e femijeve (në tekstin e metejme: ministri).

#### Neni 42

(1) Për kerkese për realizimin, perkatesisht vazhdimin e të drejtës për mbrojtje të femijeve nga neni 6 i ketij ligji, pervec për të drejten nga pika 5, vendos qendra për pune sociale kompetente për rajonin në të cilin parashtruesi i kërkeses ka vendbanim, ndersa për ndihme të njehershme në para për foshnje të sapolindur dhe për shtese prinderore për femije vendos qendra për pune sociale, kompetente për rajonin në të cilin nena ka vendbanim të perhershem.

(2) Për ankese kunder aktvendimit të qendres për pune sociale nga paragrafi (1) i ketij neni, vendos ministri.

(3) Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

#### Neni 43

(1) Qendra për pune sociale leshon vertetim dhe certifikate për statusin e shfrytezuesit të të drejtave për mbrojtjen e femijeve nga neni 6 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3 dhe 4 të ketij ligji në pajtim me evidencen zyrtare, në afat prej dhjete diteve nga dita e parashtrimit të kërkeses.

(2) Me kerkese të qendres për pune sociale, personat juridike dhe fizike janë të obliguar që të japin të dhena që paraqesin deshmi për realizimin e të drejtave të femijeve të percaktuara me kete ligj.

#### Neni 44

Realizimi i njerës nga të drejtat për mbrojtjen e femijeve, nuk e perjashton shfrytezimin e të drejtës tjetër në pajtim me kete ligj.

#### Neni 45

Parashtruesi i kërkeses është pergjegjes për vertetesine e të dhenave në kerkese.

#### Neni 46

(1) Nese qendra kompetente për pune sociale nga neni 42 paragrafi (1) i ketij ligji, nuk miraton aktvendim për realizimin e të drejtës, perkatesisht nuk miraton aktvendim për refuzim të kërkeses në afatin e percaktuar prej 60 diteve pervec për të drejten nga neni 6 paragrafi (1) pika 3 e ketij ligji që është 30 dite, parashtruesi i kërkeses ka të drejte që në afat prej tri diteve të punes pas kalimit të atij afati të parashtrroje kerkese te sekretaria e drejtorit të qendres për pune sociale për miratimin e aktvendimit dhe drejtori të miratoje aktvendim.

(2) Formen dhe përmbajtjen e kërkeses nga paragrafi (1) i ketij neni, e percakton ministri.

(3) Me kërkesen për miratimin e aktvendimit nga paragrafi (1) i ketij neni, parashtruesi dorezon kopje nga kerkesa nga neni 42 i ketij ligji.

(4) Drejtori i qendres për pune sociale detyrohet që në afat prej pese diteve të punes nga dita e parashtrimit të kërkeses nga paragrafi (1) i ketij neni te sekretaria e drejtorit, të miratoje aktvendim me të cilin kerkesa për realizimin e të drejtës (shtese për femije, shtese e vecante, ndihme e njehershme në para për foshnje të sapolindur dhe shtese prinderore për femije) pranohet apo refuzohet. Nese drejtori nuk ka sekretari, kerkesa parashtrohet në sekretarine e selise së qendres për pune sociale.

(5) Nese drejtori i qendres për pune sociale nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (4) i ketij neni, parashtruesi i kërkeses mund ta njoftoje Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pese diteve të punes.

(6) Inspektorati Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej dhjete diteve nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (5) i ketij neni, të kryeje mbikeqyrje në qendren për pune sociale nese është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri diteve të punes nga dita e mbikeqyrjes së kryer ta informoje parashtruesin e kërkeses për masat e ndermarra.

(7) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikeqyrjes së kryer në pajtim me ligjin, miraton aktvendim me të cilin e ngarkon drejtorin e qendres për pune sociale që në afat prej dhjete diteve të vendos për kërkesen e parashtruar, perkatesisht ta miratoje ose refuzoje kërkesen dhe ta njoftoje Inspektoratin Shtetëror Administrativ për aktin e miratuar. Me kërkesen dorezohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesen e parashtruar.

(8) Inspektori i qendres për pune sociale nuk vendos në afatin nga paragrafi (7) i ketij neni, inspektori do të parashtrroje kerkese për ngritjen e procedures kundervajtese për kundervajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të caktoje afat plotesues prej pese diteve të punes, në të cilin drejtori i qendres për pune sociale do të vendose për kërkesen e parashtruar për cfare në afatin e njejte do ta njoftoje inspektorin për aktin e miratuar. Me kërkesen dorezohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesen e parashtruar. Inspektori në afat prej tri diteve të punes do ta informoje parashtruesin e kërkeses për masat e ndermarra.

(9) Nese drejtori i qendres për pune sociale nuk vendos as në afatin plotesues nga paragrafi (8) i ketij neni, inspektori në afat prej tri diteve të punes do të paraqese kallezim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat do ta informoje parashtruesin e kërkeses për masat e ndermarra.

(10) Nese inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (6) i ketij neni, parashtruesi i kërkeses në afat prej pese diteve të punes, ka të drejte që të parashtrroje kundershtrim në sekretarine e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nese drejtori nuk ka sekretari, kerkesa parashtrohet në sekretarine e selise së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(11) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej tri diteve të punes nga dita e pranimit ta shqyrtoje kundershtrimin nga paragrafi (10) i ketij neni dhe nese konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga parashtruesi i kërkeses në pajtim me paragrafet (6) dhe (7) i ketij neni, të parashtrroje kerkese për ngritjen e procedures kundervajtese për kundervajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe të caktoje afat plotesues prej pese diteve të punes në të cilin inspektori do të kryeje mbikeqyrje në organin kompetent nese është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri diteve të punes nga dita e mbikeqyrjes së kryer ta informoje parashtruesin e kërkeses për masat e ndermarra.

(12) Nese inspektori nuk vepron as në afatin plotesues nga paragrafi (11) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqese kallezim te prokurori publik kompetent dhe në afat prej tri diteve të punes do ta informoje parashtruesin e kërkeses për masat e ndermarra.

(13) Në rast të paragrafit (12) të ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ menjehere, e më së voni në afat prej një dite pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta zbatojë mbikeqyrjen menjehere.

(14) Në rastet e paragrafi (13) të ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri diteve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndermarra.

(15) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (11) të ketij neni, parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kallezim të prokurori publik kompetent në afat prej tete diteve të punës.

(16) Nëse drejtori i qendres për pune sociale nuk vendos në afatin nga paragrafi (9) i ketij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngreje kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(17) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(18) Pas miratimit të aktit nenligjor nga paragrafi (2) i ketij neni, ai menjehere, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e Ministrisë.

#### Neni 47

Në procedurën e realizimit të të drejtave për mbrojtjen e femijeve nga neni 41 i ketij ligji, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedure të pergjithshme administrative, nëse me këte ligj nuk është rregulluar ndryshe.

#### Neni 48

(1) E drejta për mbrojtjen e femijeve realizohet nga dita e pare e muajit të ardhshëm pas paraqitjes së kërkesës përvec për ndihmen e njehershme në para për foshnje të sapolindur dhe për shtese prinderore për femije

(2) Kërkesa për realizimin e të drejtës për ndihme të njehershme në para për foshnje të sapolindur me dokumentacionin e nevojshëm parashtrohet në qendrën kompetente për pune sociale, më së voni deri tre muaj të mbushura moshe të foshnjës, ndërsa për femije të adoptuar më së voni deri tre muaj nga regjistrimi i femijes së adoptuar në librin e të lindurve.

(3) Kërkesa për realizimin e të drejtës për ndihme prinderore për femije me dokumentacionin e nevojshëm parashtrohet në qendrën kompetente për pune sociale, më së voni deri tre muaj të mbushura moshe të foshnjës, dhe e drejta për shtese prinderore për femije realizohet nga dita e lindjes së femijes.

(4) Rendi i lindjeve të femijeve të drejta prinderore për femije percaktohet sipas numrit të femijeve të gjalle të nenes të percaktuar lidhur me ditën e parashtrimit të kërkesës për realizimin e të drejtës për shtese prinderore për femije, sipas dates dhe ores së lindjeve të regjistruar në librin amë të të lindurve, rend i cili percaktohet në menyre të njejte edhe në rastet kur nena do të lindë më shumë femije menjehere.

(5) Kërkesa për vazhdimin e të drejtës për shtese për femije, shtese të vecante dhe shtese prinderore për femije për vitin e ardhshëm, parashtrohet deri më 31 mars në atë vit.

(6) Nëse kërkesa për vazhdimin e të drejtës për shtese për femije, shtese të vecante dhe shtese prinderore për femije, është parashtruar pas afatit të percaktuar në paragrafin (5) të ketij neni, kerkuesi do ta fitojë të drejtën e vazhdimit, perkatesisht shfrytezimit të së drejtës ditën e pare të muajit të ardhshëm në të cilin është parashtruar kërkesa për vazhdimin e së drejtës.

#### Neni 49

Shfrytëzuesi i së drejtës nga neni 6 paragrafi (1) pikat 1, 2 dhe 4 të ketij ligji, detyrohet që qendrën kompetente për pune sociale ta njoftojë për çdo ndryshim të fakteve dhe rrethanave që kanë qene baze për njohjen e së drejtës për mbrojtjen e femijeve më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita kur kanë ndodhur ato ndryshime.

#### Neni 50

(1) Nëse e drejta është realizuar dhe paguar në kundërshtim me dispozitat e ketij ligji, shumën e pranuar shfrytëzuesi detyrohet që ta kthejë në pajtim me këte ligj.

(2) Shfrytëzuesi, i cili me aktvendim të qendres apo aktvendim të institucionit publik për femije e ka realizuar të drejtën e nga neni 6 i ketij ligji, detyrohet që t'i kthejë mjetet e pranuar dhe ta kompensojë demin, nëse:

- në baze të të dhenave të paplota ose të pasakta, për të cilat ai ka ditur ose është dashur të dije se janë të paplota ose të pasakta, ose në ndonjë menyre tjetër të paligjshme e ka realizuar të drejtën e mbrojtjes së femijeve, për të cilën nuk ka pasur të drejte sipas dispozitave të ketij ligji ose të drejtën e ka realizuar në shumë më të lartë se shumata që i ka takuar për të drejtën konkrete në pajtim me ligjin dhe

- të drejtën e mbrojtjes së femijeve e ka realizuar, për arsye se pa shkaqe të arsyeshme nuk ka paraqitur ndryshim që ndikon në ndërprerjen ose lartësine e të drejtës, dhe e ka ditur apo ka mundur të dije për atë ndryshim.

(3) Kërkesa për kthimin e shumës së mjeteve të paguara dhe kërkesa për kompensim të demit parashkruhet me kalinin e afateve të parapara në Ligjin për marrëdhënie obligative.

(4) Afatet e parashkrimit për kërkesë për kthim të shumës së mjeteve të paguara dhe për kërkesën për kompensim të demit në perputhje me këte ligj, fillojnë të rrjedhin nga dita që është percaktuar me aktvendim perfundimtar se shfrytëzuesi e ka marrë të drejtën e mbrojtjes së femijeve menyre të paligjshme.

(5) Qendra, perkatesisht institucioni publik për femije kur do të konstatojë se shfrytëzuesi e ka realizuar të drejtën për mbrojtje të femijeve në menyre të percaktuar në këte nen, do të miratojë aktvendim me të cilin shfrytëzuesit do të nderpritet e drejta e mbrojtjes së femijeve.

(6) Kur aktvendimi i qendres, perkatesisht i institucionit publik, me të cilin shfrytëzuesit i nderpritet e drejta e mbrojtjes së femijeve, do të behet perfundimtar, qendra, perkatesisht institucioni, do ta fitojë shfrytëzuesin e të drejtës nga mbrojtja e femijeve që të merren vesh për shumën, menyren dhe afatin për kthim të mjeteve të pranuar, si dhe për lartësine e demit të shkaktuar, që ai duhet ta kompensojë.

(7) Nëse shfrytëzuesi i të drejtës nga paragrafi (2) i ketij neni dhe qendra apo institucioni merren vesh, qendra, perkatesisht institucioni do të paraqesë padi në gjykatën kompetente për kthimin e mjeteve të pranuar dhe të drejtë për kompensim të demit.

#### Neni 51

Për femije që është martuar nderpritet e drejta e shfrytezimit të shteses për femije me ditën e pare të muajit të ardhshëm nga muaji i martesës.

#### Neni 52

Qendra kompetente për pune sociale detyrohet që më së voni deri në të 5-tin e muajit, të dorëzojë në Ministrinë raport për shfrytezimin e mjeteve për muajin e fundit dhe kërkesë për mjetet e nevojshme për pagesën e të drejtave nga neni 6 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3 dhe 4 të ketij ligji, për muajin e ardhshëm me numrin e pergjithshëm të femijeve dhe familjeve, perkatesisht shfrytëzuesve për të cilët duhet të paguhet të drejtat.

#### Neni 53

Kushtet e peraferta, kriteret dhe menyren e realizimit të të drejtave për mbrojtjen e femijeve nga neni 6 i ketij ligji, i percakton ministri.

## III. FORMAT E MBROJTJES SË FEMIJEVE

## 1. Perkujesja dhe edukimi i femijeve të moshes parashkollore

Neni 54

Perkujesja dhe edukimi i femijeve të moshes parashkollore është formë e mbrojtjes së femijeve që si veprimtari organizohet për perkujesje, qendrim, perkujesje, ushqim, aktivitete arsimore-edukative, sportive-rekreative, kulturore-argetuese, masa dhe aktivitete për permiresimin dhe ruajtjen e shendetit dhe për nxitjen e zhvillimit intelektual, emocional, fizik, mental dhe social të femijes deri në moshën 6 vjecare, perkatesisht deri në perfshirje në arsimin filor.

## 2. Pushimi dhe rekreacioni i femijeve

Neni 55

Pushimi dhe rekreacioni i femijeve është formë e mbrojtjes së femijeve që si veprimtari organizohet për qendrim, pushim aktiv, socializim i femijeve, aktivitete arsimore-edukative, kulturore-argetuese, sportive-rekreative dhe aktivitete tjera me femijet për zhvillim të zhvillimit psikomotorik të femijeve dhe aftësisë për kontraktim, respektim të dallimeve dhe bashkepunim në grupe, aftesi për pranim të vetvetes dhe të tjeve dhe orientim në hapësirë.

## 3. Forma tjera të mbrojtjes

Neni 56

(1) Për zhvillim të personalitetit të femijes, talentit, aftësi mentale, fizike, kreative e të tjera, pergatitje për jete të pavarur dhe të pergjegjshme sigurohen forma të tjera të mbrojtjes së femijeve si aktivitete programore nga fusha e kultures, veprimtarisë botuese, perkujesesë dhe edukative, ekologjise, artit, aktiviteteve të lira dhe rekreative dhe sportit.

(2) Aktivitetet e programuara nga paragrafi (1) i ketij neni, realizohen në perputhje me programet e vecanta që i perpilon institucioni perkates shkencor, perkatesisht enti ose institucioni i specializuar profesional, e që i miraton ministri.

(3) Për kendellje më të mire fizike dhe psikike, rehabilitim, dhe riintegrim social të femijes i cili është viktime e ndonje forme të anashkalimit, eksploatimit, keqtrajtim, tortures, tregtise apo forme tjetër të veprimit mizor të theksuara në nenin 12 paragrafet (1) dhe (2) të ketij ligji, si dhe nese sjelle pasoja dhe trauma nga konflikte të armatosura, shteti ndermerr programe të vecanta dhe aktiviteteve.

## IV. KOPSHTI PËR FEMIJE

Neni 57

(1) Veprimtaria që kryhet në kuader të perkujesjes dhe edukimit të femijeve të moshes parashkollore mund të realizohet në kopshtin për femije.

(2) Kopshti për femije mund të siguroje qendrim dhe ushqim edhe për femijet mbi gjashtë vjet, perkatesisht nga vajtja në shkolle fillore deri në moshën dhjetevjecare.

Neni 58

Kopshti për femije mund të themelohet si kopsht publik për femije dhe kopsht për femije në pronesi private.

Neni 59

(1) Kopshti publik për femije themelohet nga keshilli i komunes, Keshilli i Komunes në Qytetin e Shkupit dhe Qe-

veria, me vendim për themelim të kopshtit publik për femije pas mendimit të marre paraprakisht nga Ministria, perkatesisht me propozim të Ministrise për kopsht publik për femije të themeluar nga Qeveria.

(2) Kopshti publik për femije themelohet si institucion publik.

(3) Kopshti publik për femije ka statut me të cilin percaktohet organizimi i tij, menyra e punes, menaxhimi dhe udheheqja.

(4) Mjetet për themelimin dhe punen e institucionit nga paragrafi (1) i ketij neni, i siguron themeluesi.

Neni 60

(1) Kopshti për femije regjistron dhe pranon femije në baze të fleteparaqitjeve gjate tere vitit.

(2) Nese në kopshtin për femije nga paragrafi (1) i ketij neni, ka të paraqitur numer më të madh të femijeve sesa që ka vende të lira, për pranimin vendos komisioni për pranim të femijeve.

(3) Perberjen dhe menyren e punes së komisionit nga paragrafi (2) i ketij neni, si dhe kriteret e peraferta për pranimin e femijeve në kopshtin për femije i percakton keshilli drejtues i kopshtit për femije në koordinim me keshillin e komunes dhe keshillin e komunes në Qytetin e Shkupit, ndersa Ministria për kopshtit publik për femije të themeluar nga Qeveria.

(4) Komisionin e emerone drejtori.

(5) Për ankesen kunder aktvendimit të komisionit vendos kryetari i komunes dhe komunes në Qytetin e Shkupit, e ministri për kopshtin publik të themeluar nga Qeveria.

(6) Komisioni nga paragrafi (2) i ketij neni, është kompetent edhe për realizimin e së drejtes së participimit.

(7) Për ankesen kunder aktvendimit të komisionit për participim vendos ministri.

(8) Prinderit obligohen që gjate pranimit të femijes në kopsht të parashtrijne vertetim nga mjeku amë për gjendjen shendetesore të femijes, perkatesisht konstatim dhe mendim nga institucioni perkates profesional për femije me pengesa në zhvillim ose pengesa trupore.

(9) Organi udheheqës i kopshtit të femijeve i kushton kujdes dhe e ndjek gjendjen lidhur me pranimin e femijeve me pengesa në zhvillim, perkatesisht për gjendjen ekonomike sociale në familje.

(10) Të drejtat dhe obligimet e kopshtit dhe shfrytëzuesve të sherbimeve rregullohen me marreveshje, me të cilen vecanerisht rregullohen marredheniet e ndersjella të dhenesit dhe shfrytëzuesit të sherbimit, menyra e pageses, zgjedhja e programit, gjatesia e qendrimit të femijes në institucion dhe ceshtje tjera lidhur me mbrojtjen e femijes dhe veprimtarine e kopshtit.

Neni 61

(1) Kopshti për femije në pronesi private themelohet nga personi vendas ose i huaj fizik ose juridik.

(2) Kopshti për femije në pronesi private themelohet si institucion privat për femije-kopsht për femije.

(3) Themeluesi i kopshtit për femije në pronesi private miraton akt për themelimin në forme dhe permbajtje në pajtim me nenin 109 të ketij ligji.

(4) Mjetet për themelimin dhe punen e institucionit nga paragrafi (1) i ketij neni, i siguron themeluesi.

Neni 62

Personat juridike ose fizike me seli, perkatesisht vendbanim në vendet-anezare të Bashkimit Evropian dhe OECD-së mund të themelojne kopshte për femije në pronesi private si edhe personat vendas juridike dhe fizike.



## Neni 63

(1) Veprimtaria e kopshtit për femije realizohet sipas programeve për realizimin e veprimtarisë në pajtim me nenin 168 të këtij ligji.

(2) Kopshti për femije detyrohet që prindërve t'ua prezantojë programet të cilat i realizon, qëllimet e tyre, përmbajtjet dhe metodat e punës.

(3) Prinderit kanë të drejte që për femijet e tyre në kopshtet për femije të zgjedhin programe për perkujdesje dhe edukim të femijeve.

(4) Kopshti për femije sipas kohezgjatjes realizon programe për

- qendrim tereditor,
- qendrim gjysmeditor,
- programe të shkurtuara,
- pilot programe dhe
- forma jashtinstitucionale për aktivitetet me femije.

(5) Kopshti për femije mund të realizojë edhe program për qendrim të vazhduar për femije sipas nevojave dhe kohës së punës të shfrytëzuesve të këtyre shërbimeve.

(6) Programet për qendrim tereditor zgjasin prej 9 deri 11 orë dhe mund të realizohen paradite, pasdite, tere ditën apo në menyre alternative.

(7) Programet për qendrim gjysmeditor zgjasin prej 4 deri 6 orë dhe mund të realizohen paradite, pasdite, tere ditën apo në menyre alternative.

(8) Programet e shkurtuara zgjasin prej 260 deri 600 orë në vit.

(9) Programet për qendrim tereditor dhe programet për qendrim gjysmeditor dedikohen për femije të moshës deri në vajtje në shkollë fillore dhe përfshijne perkujdesje dhe edukim të femijeve.

(10) Programet e shkurtuara dedikohen për femije të moshës prej tre vjet deri në gjashtë vjet, perkatesisht deri në vajtje në shkollë fillore dhe përfshijne perkujdesje dhe edukim të femijeve me ose pa ushqim të femijeve.

(11) Programet e shkurtuara dedikohen edhe për femije që janë në mjekim spitalor më të gjatë.

(12) Aktivitetet jashtinstitucionale janë programe të shkurtra në kohezgjatje prej tri orësh në dite, që mund të përfshijne: lojera, aktivitetet lojërash, punetori kreative, punetori të femijeve nga sfera e kultures dhe artit, aktivitetet sportive, të dedikuara për femije të moshës prej tri vjet deri në vajtje në shkollë fillore dhe organizohen dhe realizohen nga kopshtet publike për femije pas lejes të marre nga ministri sipas mendimit të Byroës për Zhvillim të Arsimit.

(13) Pilot-programet janë programe me parime të vecanta pedagogjike të cilat realizohen në kopshte publike për femije pas lejes së marre nga ministri sipas mendimit të Byroës për Zhvillim të Arsimit.

## Neni 64

(1) Kopshtet për femije varesisht nga mosha e femijeve dhe kohezgjatja e qendrimit, punën e tyre e organizojnë në grupe.

(2) Puna në kopshtin për femije organizohet varesisht nga mosha e femijeve në grupe homogjene, si vijon:

- 1) deri 12 muaj.....prej gjashtë deri në tete femije;
- 2) mbi 12 muaj deri 18 muaj.....prej tete deri në dhjete femije;
- 3) mbi 18 muaj deri 2 vjet.....prej 10 deri në 12 femije;
- 4) mbi dy vjet në tre vjet.....prej 12 deri në 15 femije;
- 5) mbi tre vjet deri në kater vjet.....prej 15 deri në 18 femije;
- 6) mbi kater vjet deri në pese vjet.....prej 18 deri në 20 femije dhe

7) mbi pese vjet deri në gjashtë vjet.....prej 20 deri në 25 femije.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, varesisht nga mosha e femijeve, mund të organizohet:

- 1) grup heterogjen
  - deri në dy vjet.....prej dhjete deri në 12 femije dhe
  - prej dy vjet deri në vajtje në shkollë fillore .... prej 18 deri në 20 femije;
- 2) grup i kombinuar
  - prej 12 muaj deri në vajtje në shkollë fillore... prej 15 deri në 20 femije;
- 3) grup i femijeve me pengesa në zhvillim..... prej pese deri në tete femije dhe
- 4) grup i femijeve të moshës gjashtëvjeçare perkatesisht nga vajtja në
  - shkollë fillore deri në dhjete vjet..... prej 20 deri në 30 femije.

(4) Në grupet nga paragrafet (2) dhe (3) pikat 1 dhe 2 të këtij neni mund të përfshihet një femije me pengesa të lehta në zhvillimin mental ose pengese trupore, me ç'rast numri i femijeve në grupet zvogelohet për dy femije.

(5) Me përjashtim, varesisht nga kushtet për punë, nevoja e femijeve dhe prindërve ose programeve për realizimin e veprimtarisë, kopshti publik për femije në grupet mund të ketë numer të madh të femijeve, perkatesisht numer më të vogël të femijeve nga numri i femijeve të percaktuar në paragrafet (2) dhe (3) të këtij neni, për çka pelqim jep theme-luesi i institucionit.

(6) Me përjashtim, varesisht nga kushtet për punë, nevoja e femijeve dhe prindërve ose programeve për realizimin e veprimtarisë, kopshti privat për femije në grupet mund të ketë numer më të vogël të femijeve nga numri i femijeve të percaktuar në paragrafet (2) dhe (3) të këtij neni, për çka pelqim jep theme-luesi i institucionit.

(7) Në kopshtin për femije aktivitetet realizohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik.

(8) Për femijet e pjesëtareve të bashkësive tjera aktivitetet edukative - arsimore në kopshte për femije realizohen në gjuhën e bashkësive perkatese, për grup të femijeve, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(9) Nëse ekziston interes për realizimin e aktivitetëve edhe në gjuhë tjera, aktivitetet edukative - arsimore në kopshte për femije mund të realizohen për grup të femijeve në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

## Neni 65

(1) Kopshti për femije organizon perkujdesje dhe edukim të femijeve me pengesa në zhvillimin mental ose pengese trupore, në përputhje me llojin dhe shkallën e pengesës.

(2) Si femije me pengesa në zhvillimin mental ose pengese trupore konsiderohen: femije të verber dhe me shikim të dobët, femije të shurdher dhe më pak të shurdher, femije me pengesa në të folur, femije me invaliditet trupor, si dhe femije me veshitësi në sjellje dhe personalitet.

(3) Perkujdesja dhe edukimi i femijeve me pengesa të lehta trupore në zhvillimin mental dhe pengese trupore nga paragrafi (2) i këtij neni, të cilët kanë nevojë për realizim të pershtatur të programeve për femije parashkollore me ndihmë profesionale plotësuese ose me programe të pershtatura, organizohet në grupet e rregullta.

(4) Perkujdesja dhe edukimi i femijeve me pengesa mesatare në zhvillimin mental ose pengese trupore nga paragrafi (2) i këtij neni, organizohet në grupe të vecanta sipas programeve të vecanta.

## Neni 66

(1) Kopshti publik për femije, sherbime të caktuara nga veprimtaria e vet mund t'i organizoje edhe në kushte tjera hapësinore (shkolle fillore, spital, shtepi e kultures, bashkësi lokale dhe institucione dhe objekte tjera), si dhe ofrim të sherbimeve të caktuara nga veprimtaria e kopshtit për femije femijeve dhe familjeve, në pajtim me kete ligj.

(2) Kur në vendbanimin nuk ka kopsht publik për femije, ndërsa prinderit kanë interes për perfshirje në kopsht për femije të një numri të caktuar të femijeve, sipas të cileve në pajtim me normativat dhe standardet për kryerjen e veprimtarisë mund të formohet një grup, kopshti për femije nga komuna më e afert sherbime të caktuara nga veprimtaria e vet, pas pelqimit të marre paraprakisht nga Ministria mund t'i organizoje në kushte tjera hapësinore.

(3) Kur në kopshtin publik për femije nuk ka vende të lira, ndërsa prinderit kanë interes për perfshirje në kopsht për femije të një numri të caktuar të femijeve, sipas të cileve në pajtim me normativat dhe standardet për kryerjen e veprimtarisë mund të formohet një grup, kopshti për femije sherbime të caktuara nga veprimtaria e vet, mund të organizoje në kushte tjera hapësinore pas pelqimit të marre paraprakisht nga Ministria.

(4) Proceduren për hapjen e grupit në kushte tjera hapësinore në rastin nga paragrafi (2) i ketij neni, kopshti e ngre me kerkese të themeluesit dhe komunes në të cilën nuk ka kopsht për femije.

(5) Në rast kur në komune të caktuara nuk ka kopsht publik për femije ose qender publike për zhvillim të hershem të femijeve të themeluar nga komuna apo ka persona juridike të cilet nuk kanë kapacitet të mjaftueshem, ndërsa prinderit kanë interes të shprehur dhe ka numer të nevojshem të femijeve për themelimin e institucioneve të reja për perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshes parashkollore, komuna ose komuna e Qytetit të Shkupit mundet, në afat prej 30 ditësh nga dokumentimi i nevojës, të filloje procedure për ndarje të koncesionit ose ndarje të marreveshjes për themelim të partneritetit privat-publik me persona juridike në pronesi private, të cilet kryejne veprimtari në kuader të sistemit për perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshes parashkollore, në pajtim me ligjin.

(6) Menyren e ofrimit të sherbimeve nga paragrafi (1) i ketij neni, e percakton ministri.

## Neni 67

(1) Koha e punes së të punesuarve në kopshtin për femije është 40 orë në jave.

(2) Koha e punes e percaktuar në paragrafin (1) të ketij neni, për shkak të natyres së punes, për edukatorin dhe infermierin, ndahet në kohe pune të kaluar me femijet dhe kohe tjetër të punes për aktivitete tjera programore.

(3) Koha e punes e kaluar me femijet, si pjese e aktiviteteve të pergjithshme programore në suaza të kohes së plote të punes nga paragrafi (1) i ketij neni, për edukatorin është 30 orë në jave, ndërsa për infermierin 35 orë në jave.

(4) Rroga themelore, kompensimi i rrogës dhe kompensimi i shpenzimeve lidhur me punen, perllogariten dhe i paguhen të punesuarit në baze të kohes së punes nga paragrafi (1) i ketij neni, si dhe evidences që e mban punedhenesi.

(5) Orarin e kohes së punes të të punesuarve në suaza të javes së punes 40 oreshe në institucionet publike për femije e percakton ministri.

(6) Fillimin dhe perfundimin e kohes së punes në institucionin publik për femije të themeluar nga komuna, komuna e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, e percakton keshilli i themeluesit, ndërsa për institucionin publik për femije të themeluar nga Qeveria, ministri.

## V. QENDRA PËR ZHVILLIM TË HERSHEM

## TË FEMIJEVE

## Neni 68

(1) Veprimtaria e cila kryhet në suaza të perkujdesjes dhe edukimit të femijeve të moshes parashkollore mund të realizohet edhe në qender për zhvillim të hershem të femijeve.

(2) Qendra për zhvillim të hershem të femijeve mund të themelohet nga komuna, komuna në Qytetin e Shkupit, Qeveria dhe personi vendas ose i huaj fizik ose juridik.

(3) Qendra për zhvillim të hershem të femijeve zbaton Program për mesim të hershem dhe zhvillim të femijeve të moshes parashkollore prej tre deri në gjashte vjet, perkatesisht deri në vajtje në shkolle fillore.

(4) Qendra për zhvillim të hershem të femijeve në grupet nga neni 74 paragrafet (1) dhe (2) të ketij ligji, sipas kohezgjatjes, realizon programe të shkurtuara në kohezgjatje deri tri orë në dite me kohe pune fleksibile sipas nevojave të prinderve dhe komunitetit.

## Neni 69

(1) Qender për zhvillim të hershem të femijeve në komunën dhe komunën e Qytetit të Shkupit, themelohet nga keshilli i komunes dhe keshilli i komunes së Qytetit të Shkupit, perkatesisht nga Qeveria, pas mendimit të marre paraprakisht nga Ministria, perkatesisht me propozim të Ministrise.

(2) Qendra për zhvillim të hershem të femijeve nga paragrafi (1) i ketij neni themelohet si institucion publik.

(3) Qendra për zhvillim të hershem të femijeve nga paragrafi (1) i ketij neni, ka statut me të cilin percaktohet organizimi i saj, menyra e punes, menaxhimi dhe udheheqja.

(4) Mjetet për themelimin dhe punen e institucionit nga paragrafi (1) i ketij neni, i siguron themeluesi.

(5) Koha e punes në qendrat për zhvillim të hershem të femijeve organizohet si kohe e plote e punes ose kohe pune në gjysme nga koha e plote e punes në pajtim me marreveshjen për punesim.

## Neni 70

(1) Qendra për zhvillim të hershem të femijeve në pronesi private themelohet nga personi vendas ose i huaj fizik ose juridik.

(2) Qendra për zhvillim të hershem të femijeve në pronesi private themelohet si institucion privat për femije.

(3) Themeluesi i qendres për zhvillim të hershem të femijeve nga paragrafi (1) i ketij neni miraton akt për themelimin në forme dhe permbajtje në pajtim me nenin 109 të ketij ligji.

(4) Mjetet për themelim dhe pune të Qendres për zhvillim të hershem të femijeve nga paragrafi (1) i ketij neni, i siguron themeluesi.

## Neni 71

(1) Kur në vendbanimin nuk ka qender publike për zhvillim të hershem të femijeve, ndërsa prinderit kanë interes për perfshirje në qender publike për zhvillim të hershem të femijeve të një numri të caktuar të femijeve, sipas të cileve në pajtim me normativat dhe standardet për kryerjen e veprimtarisë mund të formohet një grup, qendra publike për zhvillim të hershem të femijeve nga komuna më e afert sherbime të caktuara nga veprimtaria e vet, pas pelqimit të marre paraprakisht nga Ministria mund t'i organizoje në kushte tjera hapësinore.

(2) Kur në qender publike për zhvillim të hershem të femijeve nuk ka vende të lira, ndërsa prinderit kanë interes për perfshirje në qender publike për zhvillim të hershem të femijeve të një numri të caktuar të femijeve, sipas të cileve në pajtim me normativat dhe standardet për kryerjen e ve-

primtarise mund të formohet një grup, qendra publike për zhvillim të hershem të femijeve sherbime të caktuara nga veprimtaria e vet, mund të organizoje në kushte tjera hapësirë pas pelqimit të marre paraprakisht nga Ministria.

(3) Proceduren për hapjen e grupit në kushte tjera hapësirë në rastin nga paragrafi (1) i këtij neni, qendra publike për zhvillim të hershem të femijeve e ngre me kerkese të themeluesit dhe komunes në të cilën nuk ka qender publike për zhvillim të hershem të femijeve.

#### Neni 72

Personat e huaj fizike dhe juridike, me seli, perkatesisht vendbanim në vendet-anetare të Bashkimit Evropian dhe OECD-së mund të themelojnë qendra për zhvillim të hershem të femijeve nga neni 69 i këtij ligji, si edhe personat vendas juridike dhe fizike.

#### Neni 73

(1) Në perberje të kopshtit publik për femije, perkatesisht të kopshtit për femije në pronesi private mund të formohet qender për zhvillim të hershem të femijeve me vendim të themeluesit dhe në kushte të percaktuara në kete ligj.

(2) Kopshti publik për femije mund të transformohet në qender për zhvillim të hershem të femijeve, perkatesisht kopshti për femije në pronesi private mund të transformohet në qender private për zhvillim të hershem të femijeve me vendim të themeluesit dhe në kushtet e percaktuara në kete ligj.

(3) Qendra publike për zhvillim të hershem të femijeve mund të transformohet në kopsht publik për femije, perkatesisht qendra për zhvillim të hershem të femijeve në pronesi private mund të transformohet në kopsht privat për femije me vendim të themeluesit dhe në kushtet e percaktuara në kete ligj.

(4) Ndryshimet statusore të kopshteve për femije dhe qendrave për zhvillim të hershem të femijeve kryhen në pajtim me Ligjin për institucionet dhe me kete ligj, varesisht nga forma e personit juridik.

(5) Gjate ndryshimit statusor nga paragrafi (4) i këtij neni, personat e rinj juridike serish zbatojne procedura për leshtimin e aktvendimit për kryerjen e veprimtarise.

#### Neni 74

(1) Puna në qendren për zhvillim të hershem të femijeve organizohet në grupe heterogjene me numer të femijeve në grup prej dhjete deri në 20 femije.

(2) Nese në grupin nga paragrafi (1) i këtij neni, jane perfshtire femije të moshes prej tre deri në kater vjet, numri maksimal i femijeve eshte 15 femije në grup, e nese në grup ka femije me nevoja të vecanta, por jo më teper se dy femije në grup, numri maksimal i femijeve eshte 12 femije në grup.

(3) Me perjashtim, varesisht nga kushtet për pune, nevoja e femijeve dhe prinderve ose programeve për realizimin e veprimtarise, qendra private për zhvillim të hershem të femijeve mund të kete numer më të vogel të femijeve sesa numri i femijeve të percaktuar në paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni, për çka pelqim jep themeluesi i institucionit.

(4) Në qendren për zhvillim të hershem të femijeve aktivitetet realizohen në gjuhen maqedonase dhe alfabetin cirilik.

(5) Për femijet e pjesetareve të bashkesive tjera aktivitetet edukative - arsimore në qendrat për zhvillim të hershem të femijeve realizohen në gjuhen e bashkesise perkatese, për grup të femijeve, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(6) Nese ekziston interes për realizimin e aktiviteteve edhe në gjuhe tjera, aktivitetet edukative - arsimore në qendrat për zhvillim të hershem të femijeve mund të realizohen për grup të femijeve në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

### VI. AGJENCIA PËR DHENIEN E SHERBIMEVE PËR RUAJTJEN DHE PERKUJDESJEN E FEMIJEVE TË MOSHES PARASHKOLLORE

#### Neni 75

(1) Pune të caktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve si ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore deri në moshen gjashte vjecare, perkatesisht deri në vajtje në shkolle fillore, me ftese mund të kryeje personi juridik i regjistruar në regjistrin perkates në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonise, si Agjenci për dhenien e sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore.

(2) Pervec puneve nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia mund të ofroje pune të caktuara nga veprimtaria e ruajtjes dhe perkujdesjes së femijeve të moshes mbi 6 vjet, perkatesisht nga vajtja në shkolle fillore deri në moshen 10 vjecare me ftese.

(3) Agjencia për dhenien e sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore mund të kryeje pune të caktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit vetem në Republikën e Maqedonise, me kusht që keto pune t'i kryeje si veprimtari të vetme.

#### Neni 76

(1) Agjenci për dhenien e sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore mund të themeloje personi vendas juridik ose fizik.

(2) Nese themelues eshte person juridik duhet:

- të disponoje me hapësire perkatese të zyres dhe pajisje për pune,
- të disponoje me liste të personave të cilet do të angazhohen si kuader profesional,
- të mos i eshte shqiptuar denim ndalim për kryerjen e funksionit, veprimtarise ose detyres,

- personit të autorizuar në personin juridik të mos i jete shqiptuar denim me vendim gjyqesor të plotfuqishem me të cilin eshte denuar për veper penale për dhune familjare, marrje të personit të mitur, neglizhence ose abuzim të personit të mitur ose incest, për veper penale nga grupi i veprave kunder lirise gjinore, pa marre parasysh sanksionin e shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin eshte konstatuar sjellje diskriminuese.

(3) Nese themelues eshte person fizik duhet:

- të jete shtetas i Republikës së Maqedonise,
- të kete së paku arsim të mesem katervjecar,
- të disponoje me hapësire perkatese të zyres dhe pajisje për pune,
- të disponoje me liste të personave të cilet do të jene të angazhuar si staf profesional,
- të mos i eshte shqiptuar denim ndalim për kryerjen e funksionit, veprimtarise ose detyres dhe

- të mos i eshte shqiptuar denim me vendim gjyqesor të plotfuqishem me të cilin eshte denuar për veper penale për dhune familjare, marrje të personit të mitur, neglizhence ose abuzim të personit të mitur ose incest, për veper penale nga grupi i veprave kunder lirise gjinore, pa marre parasysh sanksionin e shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin eshte konstatuar sjellje diskriminuese.

#### Neni 77

Personi i angazhuar nga Agjencia për dhenien e sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore, nevojitet:

- të kete së paku arsim të mesem katervjecar dhe licencë të vlefshme për infermier,
- të mos i jete hequr e drejta prinderore,
- të kete aftesi shendetesore të pergjithshme dhe të vecante,
- të mos i jete hequr ose kufizuar aftesia afariste dhe
- të mos i jete shqiptuar denim me vendim gjyqësor të plotfuqishem me të cilin është denuar për veper penale për dhune familjare, marrje të personit të mitur, neglizhence ose abuzim të personit të mitur ose incest, për veper penale nga grupi i veprave kunder lirise gjinore, pa marre parasysh sanksionin e shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është konstatuar sjellje diskriminuese.

#### Neni 78

- (1) Kerkesen për kryerjen e puneve nga neni 75 të ketij ligji personi juridik ose fizik, e paraqet në Ministri.
- (2) Bashke me kerkesen për leshimin e aktvendimit për kryerjen e puneve nga neni 75 i ketij ligji paraqitet program për menyren e kryerjes së puneve.
- (3) Ministri, pasi do të konstatoje se janë plotësuar kushtet për pune, parashtruesit të kerkeses i leshon aktvendim për kryerjen e puneve nga neni 75 i ketij ligji, në baze të mendimit të komisionit të perbere nga tre anetare, të emruar nga ministri.
- (4) Kunder aktvendimit nga paragrafi (3) i ketij neni, mund të dorezohet ankese në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte.
- (5) Pas miratimit të aktvendimit nga paragrafi (3) i ketij neni, Agjencia për dhenien e sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore regjistruhet në regjistrin perkates në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonise me çka Agjencia për dhenien e sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore e merr cilesine e personit juridik.
- (6) Agjencia për dhenien e sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore nuk mund të filloje punen para marrjes së aktvendimit për kryerjen e puneve nga neni 75 i ketij ligji dhe regjistrimit në regjistrin perkates të Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonise.

#### Neni 79

- (1) Agjencia për dhenien e sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore mban evidence të shfrytezuesve të sherbimeve, si dhe të sherbimeve të dhena.
- (2) Formen, permbajtjen dhe menyren e mbajtjes së evidences nga paragrafi (1) i ketij neni, i percakton ministri.

#### Neni 80

- (1) Aktvendimi për kryerjen e puneve nga neni 75 i ketij ligji, shfuqizohet:
  - me kerkese të personit juridik,
  - në rast të shuarjes së personit juridik në rastet e percaktuara me ligj dhe
  - në raste tjera të percaktuara me ligj.
- (2) Aktvendimi për kryerjen e puneve nga neni 75 i ketij ligji, hiqet:
  - nese personi juridik pushon që t'i plotesoje kushtet e percaktuara me ligj,
  - nese personit juridik i është shqiptuar sanksion kundervajtes për ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarise ose detyres,
  - të mos i jete shqiptuar denim me vendim gjyqësor të plotfuqishem me të cilin është denuar për veper penale për dhune familjare, marrje të personit të mitur, neglizhence ose abuzim të personit të mitur ose incest, për veper penale

nga grupi i veprave kunder lirise gjinore, pa marre parasysh sanksionin e shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është konstatuar sjellje diskriminuese dhe

- në raste tjera të percaktuara me ligj.
- (3) Për shfuqizimin dhe heqjen e aktvendimit nga neni 78 i ketij ligji, ministri miraton aktvendim.

(4) Kunder aktvendimit nga paragrafi (3) i ketij neni, mund të dorezohet ankese në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte.

#### Neni 81

- (1) Dhenia e sherbimeve nga neni 75 i ketij ligji, behet me ftese të kerkuesit (prindit ose kujdestarit të femijes) dhe mund të kryhet në shtepine e kerkuesit ose si shoqerim i shfrytezuesit të sherbimit.
- (2) Koha, vendi dhe menyra e dhenies së sherbimeve percaktohet gjate angazhimit të personit nga kerkuesi që rregullohet me marreveshje të ndersjelle.
- (3) Personat të cilet janë të angazhuar me ftese detyrimisht mbajne legjitimacion zyrtar.
- (4) Formen dhe permbajtjen e legjitimacionit nga paragrafi (3) i ketij neni e percakton ministri, ndersa e leshon personi pergjegjes i Agjencise.

#### Neni 82

Agjencia pergjigjet për demin e krijuar që është shkakuar nga i punesuari i cili jep sherbim me ftese, në pajtim me ligjin.

#### Neni 83

Kushtet e peraferta dhe menyren e kryerjes së puneve nga neni 75 i ketij ligji, i percakton ministri.

### VII. PERSONA FIZIKE QË KRYEJNE PERKUJDESJE SHTEPIAKE TË FEMIJEVE TË MOSHES PARASHKOLLORE

#### Neni 84

Persona fizike mund të kryejne pune të caktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve të moshes parashkollore në kushtet e percaktuara me kete ligj.

#### Neni 85

Personi fizik në shtepine e vet në menyre të mevetesishme mund të kryejne pune të caktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve, si veprimtari profesionale dhe për organizimin dhe realizimin e perkujdesjes ose qendrimit, perkujdesjes dhe ushqimit të femijeve të moshes parashkollore deri në moshen gjashtevjecare, perkatesisht deri në vajtje në shkolle fillore dhe femijeve të moshes deri dhjete vjet, më së shumti deri dhjete femije dhe jo më pak se dy orë në dite.

#### Neni 86

Personi fizik në shtepine e vet në menyre të mevetesishme mund të kryejne pune të caktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve, si veprimtari profesionale dhe për organizimin dhe realizimin e perkujdesjes ose qendrimit, perkujdesjes dhe ushqimit edhe të femijeve me pengesa në zhvillimin mental ose pengesa trupore, deri dy femije të moshes deri dhjete vjet dhe jo më pak se dy orë në dite.

#### Neni 87

(1) Personi fizik në menyre të mevetesishme mund të kryejne pune të caktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve, si veprimtari profesionale nese i ploteson kushtet, si vijojne:

- të kete së paku arsim të mesem,
- të mos i jete hequr kryerja e të drejtes prinderore,

- të kete aftesi shendetesore të pergjithshme dhe të vecante,

- të mos i jete hequr ose kufizuar aftesia afariste,

- të mos i jete shqiptuar denim me vendim gjyqesor të plotfuqishem me të cilin eshte denuar për veper penale për dhune familjare, marrje të personit të mitur, neglizhence ose abuzim të personit të mitur ose incest, për veper penale nga grupi i veprave kunder lirise gjinore, pa marre parasysh sanksionin e shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin eshte konstatuar sjellje diskriminuese dhe

- të disponoje me hapësire perkatese dhe pajisje për pune nese personi fizik punet i kryen në shtepine e vet, me atë që hapësira ku qendrojnë femijet duhet të kete sipërfaqe prej së paku 15 m<sup>2</sup>, hapësirat në të cilat do të zhvillohen aktivitetet me femijet duhet të jete funksionalisht të lidhura dhe të vecuara nga hapësirat të cilat i shfrytëzon familja.

(2) Personi fizik nga paragrafi (1) i ketij neni, nuk mund të kryeje pune të caktuara në shtepine e vet nese në familje ka anetar i cili eshte i semur nga semundje ngjitese e pashrueshme, vartes i droges ose substance tjeter psikotrope apo abuzim me alkool, ose nese ndonje anetari të mos-huar të familjes nuk i eshte hequr ose kufizuar e drejta prinderore.

(3) Çdo person fizik i cili në menyre të mevetesishme kryen pune të caktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve, si veprimtari profesionale detyrimisht duhet të posedoje licence të vlefshme për pune, e nese sherbimet i ofron në shtepine e vet, të marre edhe aktvendim për kryerjen e puneve të caktuara nga veprimtaria.

(4) Kushtet e peraferta, kriteret dhe menyren e kryerjes së puneve nga neni 84 i ketij ligji, i percakton ministri.

#### Neni 88

(1) Kerkesa për kryerjen e puneve nga nenet 85 dhe 86 të ketij ligji, paraqitet në Ministri.

(2) Ministri pasi do të konstatoje se jane plotesuar kushtet për pune, parashtruesit të kerkeses i leshon aktvendim për kryerjen e puneve të caktuara, në baze të mendimit të komisionit të perbere nga tre anetare, të emeruar nga ministri.

(3) Kunder aktvendimit nga paragrafi (2) i ketij neni mund të dorezohet ankese në Komisionin Shteteror për Vendimarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte.

(4) Pas miratimit të aktvendimit nga paragrafi (2) i ketij neni, personi fizik nga neni 84 të ketij ligji regjistrohet në regjistrin perkates të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonise.

#### Neni 89

(1) Personi fizik me kerkuesin e sherbimit lidh marrevshje në forme me shkrim në të cilen rregullohet koha, vendi, menyra, lloji dhe vellimi i sherbimeve të cilat i jep personi fizik.

(2) Në marrevshje percaktohet edhe shumë e fitimit i cili percaktohet varesisht nga koha e angazhimit, që do të paraqese baze për percaktimin e kontributeve për sigurim të detyrueshem social në pajtim me ligjin.

(3) Personi fizik i cili në menyre të mevetesishme kryen pune të caktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve, si veprimtari profesionale, detyrohet që:

- t'i jape sherbimet në pajtim me kete ligj,

- në kryerjen e punes ta respektojë personalitetin e shfrytëzuesit, dinjitetin e tij dhe paprekshmerine e jetes personale dhe familjare, si dhe t'i ruaje si sekret zyrtar të dhe-nat dhe informatat me karakter personal dhe familjar, si dhe ta ruaje sekretin zyrtar dhe profesional,

- të mbaje evidence për shfrytëzuesit dhe sherbimet e ofruara,

- të jape të dhena për punen e vet me kerkese të Ministrise dhe

- të dorezoje raport vjetor për punen e tij në Ministri.

(4) Formen, permbajtjen dhe menyren e mbajtjes së evidences nga paragrafi (3) alineja 3 të ketij neni, i percakton ministri.

#### Neni 90

(1) Vlefshmeria e aktvendimit për kryerjen e puneve të caktuara nga veprimtaria, personit fizik i nderpritet, nese:

- personi vdes,

- personi paraqet kerkese për nderprerje,

- personit me aktvendim të plotfuqishem të gjykates kompetente i eshte hequr ose kufizuar aftesia afariste,

- personi e humb gjendjen shendetesore të pergjithshme ose të vecante për kryerjen e veprimtarise dhe

- në raste tjera të percaktuara me ligj.

(2) Aktvendimi për kryerjen e puneve të caktuara nga veprimtaria personit fizik, i hiqet nese:

- me vendim të plotfuqishem të gjykates kompetente i eshte hequr kryerja e të drejtes prinderore,

- i eshte shqiptuar denim me vendim gjyqesor të plotfuqishem me të cilin eshte denuar për veper penale për dhune familjare, marrje të personit të mitur, neglizhence ose abuzim të personit të mitur ose incest, për veper penale nga grupi i veprave kunder lirise gjinore, pa marre parasysh sanksionin e shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin eshte konstatuar sjellje diskriminuese,

- në afatin e caktuar nuk i manjanon mangesite e konstatuara në kryerjen e punes, të percaktuara me mbikeqyrjen mbi ligshmerine e punes dhe mbikeqyrjen mbi punen profesionale,

- punet nuk i kryen personalisht ose nese shfrytëzon pune të personave tjere në kundërshtim me aktvendimin për kryerjen e puneve të caktuara nga veprimtaria,

- e nderpret punen pa leje të ministrit dhe

- në raste tjera të percaktuara me ligj.

(3) Ministri miraton aktvendim për shfuqizimin ose heqjen e aktvendimit për kryerjen e puneve të caktuara nga veprimtaria e personit fizik në rastet e theksuara në paragrafet (1) dhe (2) të ketij neni.

(4) Kunder aktvendimit nga paragrafi (3) i ketij neni, mund të dorezohet ankese në Komisionin Shteteror për Vendimarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte.

#### Neni 91

(1) Personi fizik të cilit i eshte leshuar aktvendim për kryerjen e puneve të caktuara nga veprimtaria perkohesisht mund ta nderprese kryerjen e puneve për shkak të semundjes, ose shkaqeve tjera të arsyeshme.

(2) Për nderprerjen e perkohshme të kryerjes së puneve, personi doemos duhet menjehere pas krijimit të shkakut me shkrim t'i njoftoje Ministrine dhe prinderit, perkatesisht kujdestaret e femijeve (femijes).

(3) Për nderprerjen e perkohshme të kryerjes së puneve në rastet nga paragrafi (1) i ketij neni, ministri miraton aktvendim.

## VIII. PUSHIMORE PËR FEMIJE

### 1. Veprimtaria

#### Neni 92

(1) Veprimtaria pushim dhe rekreacion sigurohet dhe realizohet në pushimore për femije.

(2) Nese në pushimoren publike për femije jane paraqitur numer më i madh i femijeve sesa që ka vende të lira, për pranimin vendos komisioni për pranim të femijeve.

(3) Perberjen dhe menyren e punes së komisionit nga paragrafi (2) i ketij neni, si dhe kriteret e peraferta për pranimin e femijeve në pushimore i percakton keshilli drejtues i pushimores në pajtim me keshillin e komunes dhe keshillin e Qytetit të Shkupit, për pushimore të themeluar nga komuna dhe Qyteti i Shkupit, ndersa Ministria për pushimore publike për femije të themeluar nga Qeveria.

(4) Komisionin nga paragrafi (2) i ketij neni, e emeron drejtori.

(5) Për ankese kunder aktvendimit të komisionit vendos kryetari i komunes dhe i Qytetit të Shkupit, ndersa ministri për pushimore publike për femije të themeluar nga Qeveria.

(6) Komisioni nga paragrafi (2) i ketij neni, eshte kompetent të vendose edhe për realizimin e të drejtes për participim.

(7) Për ankesen kunder aktvendimit për të drejten për participim të komisionit vendos ministri.

(8) Organi i menaxhimit me pushimoren publike për femije kujdeset lidhur me pranimin e femijeve për kushtet sociale - ekonomike në familje.

(9) Me marreveshje rregullohen të drejtat dhe obligimet e pushimores për femije dhe shfrytezuesve të sherbimeve të pushimit dhe rekreacionit.

#### Neni 93

(1) Pushim dhe rekreacion mund të organizohet edhe për femije me pengesa në zhvillim.

(2) Pushim dhe rekreacion për femije me pengesa në zhvillim, organizohet sipas programeve të vecanta.

#### Neni 94

(1) Prinderit kane të drejte që për femijet e tyre të zgjedhin programe për pushim dhe rekreacion në pushimoret për femije.

(2) Pushimorja për femije detyrohet që prinderve t'ua prezantoje programet të cilat i realizon, qellimet e tyre, permbajtjet dhe metodat e punes.

## 2. Organizimi dhe permbajtja e veprimtarise

#### Neni 95

(1) Pushim dhe rekreacion në pushimore publike për femije realizohet sipas programeve për realizimin e veprimtarise të cilat i perpilon institucioni shkencor ose institucioni i specializuar profesional, perkatesisht organi profesional ose organi tjetër, ndersa i miraton ministri.

(2) Programet për veprimtarine pushim dhe rekreacion të femijeve permbajne vecanerisht: emrin e programit, llojin dhe kohezgjatjen, detyrat themelore dhe aktivitetet.

(3) Programet ndryshohen dhe modernizohen në pajtim me rezultatet e ndjekjes dhe vleresimit të realizimit të programeve dhe të zbatimit të projekteve të cilat realizohen në veprimtarine.

(4) Iniciative për ndryshimin dhe modernizimin e programeve nga paragrafi (1) i ketij neni, mund të japin edhe pushimoret për femije, institucionet dhe personat tjere fizike dhe juridike.

(5) Programin për pushim dhe rekreacion në pushimore private për femije e miraton themeluesi pas mendimit pozitiv të marre paraprakisht nga Ministria.

(6) Mendimin nga paragrafi (5) i ketij neni, e jep ministri me propozim të Byrose për Zhvillim të Arsimit.

(7) Programi nga paragrafi (5) i ketij neni, varesisht nga lloji, vellimi dhe karakteri i veprimtarise, i permban kushtet, kriteret dhe standardet për kryerjen e veprimtarise të percaktuara me kete ligj si dhe kohezgjatjen, qellimet dhe permbajtjet e aktiviteteteve.

(8) Në pushimore private për femije pushimi dhe rekreacioni i femijeve mund të realizohet në pajtim me programet nga paragrafi (1) i ketij neni, për çka vendos organi i pushimores private për femije në pajtim me aktin për themelim.

#### Neni 96

(1) Pushimorja publike për femije organizon dhe zbaton programe për:

- dimerim,

- verim,

- mesim në natyre dhe

- programe tjera (shetitje, kampim, pikniqe, ekspedita, seminare, shkolle e vogel skijimi, shkolle rekreative-ekologjike, ushqim i femijeve e të tjera).

(2) Programi për dimerim dedikohet për femije të moshes shkollore dhe parashkollore gjate pushimit dimeror, ndersa në periudhen tjetër të dimrit pushimorja për femije mund të punoje si institucion, perkatesisht pushimore e llojit të hapur.

(3) Programi për verim dedikohet për femije të moshes parashkollore dhe femije të moshes shkollore gjate pushimit veror.

(4) Programi për mesim në natyre dedikohet për femije të moshes shkollore dhe do të realizohet në pajtim me planet arsimore të shkollave fillore.

(5) Programet tjera nga paragrafi (1) alineja 4 e ketij neni, do të realizohen varesisht nga nevojat e shfrytezuesve dhe terminet e lira në pushimoren për femije.

(6) Pushimorja për femije gjate kohes kur nuk i realizon programet nga paragrafi (1) i ketij neni, mund të punoje si pushimore e tipit të hapur dhe të jape edhe sherbime tjera nga sfera e veprimtarise hotelerike – turistike, marketingut si dhe sherbime tjera, pervec organizimit dhe dhenies së sherbimeve të lojerave të fatit, vende bixhozi, kazino, bare dhe të ngjashme.

#### Neni 97

Puna në pushimoren për femije organizohet në grupe, varesisht nga mosha e femijeve, si vijon:

1) deri në moshen gjashtevjecare.....prej gjashte deri në tete femije;

2) mbi gjashte deri në dhjete vjet deri 10 vjet....prej dhjete deri në 15 femije;

3) mbi dhjete vjet deri në 13 vjet.....prej 15 deri në 18 femije;

4) mbi 13 vjet deri në 15 vjet.....prej 18 deri në 20 femije dhe

5) mbi 15 vjet deri në 18 vjet.....prej 20 deri në 25 femije.

#### Neni 98

(1) Pushimorja publike për femije miraton program vjetor për pune.

(2) Programi vjetor për pune permban vecanerisht: organizimin dhe kohen e punes së pushimores, ushqimin, llojin e programeve të pushimores për femije, kohezgjatjen e nderresave të formave të caktuara të pushimit dhe rekreacionit, punen e drejtorit dhe punetoreve tjere në pushimore, bashkepunimin me institucionet edukative-arsimore, sportive, shendetesore, kulturore, shkencore dhe institucionet tjera, fondacionet dhe shoqatat, punen e organeve profesionale dhe pune tjera për realizimin e veprimtarise.

(3) Programin nga paragrafi (1) i ketij neni, pushimorja për femije detyrohet ta miratoje më së voni deri më 30 shtator në vitin rrjedhes për vitin e ardhshem.

**IX. THEMELIMI DHE PUSHIMI I PUNES SË INSTITUCIONIT PËR PERKUJDESJE DHE EDUKIM TË FEMIJEVE TË MOSHES PARASHKOLLORE DHE PUSHIM DHE REKREACION TË FEMIJEVE**

**Neni 99**

(1) Kopsht për femije/qender për zhvillim të hershem të femijeve të komunes dhe kopsht për femije të komunes në Qytetin e Shkupit/qender për zhvillim të hershem të femijeve themelon komuna dhe komuna e Qytetit të Shkupit.

(2) Keshilli i komunes dhe keshilli i komunes në Qytetin e Shkupit miraton vendim për themelimin e kopshtit publik për femije/qendres publike për zhvillim të hershem të femijeve nga paragrafi (1) i ketij neni, pas mendimit të marre paraprakisht nga Ministria.

(3) Pushimore komunale për femije dhe pushimore për femije në Qytetin e Shkupit themelon komuna dhe Qyteti i Shkupit.

(4) Keshilli i komunes dhe keshilli i komunes së Qytetit të Shkupit miraton vendim për themelimin e kopshtit publik për femije nga paragrafi (3) i ketij neni, pas mendimit të marre paraprakisht nga Ministria.

(5) Pushimore shtetore për femije/kopsht shtetor për femije dhe qender shtetore për zhvillim të hershem të femijeve, themelon Qeveria me propozim të Ministrisë.

(6) Mjetet për themelimin dhe punen e institucionit nga paragrafet (1), (3) dhe (5) të ketij neni, i siguron themeluesi.

**Neni 100**

(1) Institucion për femije mund të themelohet dhe të filloje punen, nese:

- është siguruar numri i nevojshem i femijeve, në pajtim me standardet dhe normativat e percaktuara për kryerjen e veprimtarise,

- janë siguruar kushte adekuate hapësore, pajisje dhe mjete didaktike, në pajtim me standardet dhe normativat e percaktuara për kryerjen e veprimtarise,

- janë miratuar programe për kryerjen e veprimtarise,
- janë siguruar punetore adekuate dhe profesioniste dhe punetore tjere, në pajtim me standardet dhe normativat e percaktuara për kryerjen e veprimtarise dhe
- janë siguruar mjete të nevojshme financiare.

(2) Dispozitat nga paragrafi (1) i ketij neni zbatohen edhe në rastet e zgjerimit të programeve për kryerjen e veprimtarise së kopshtit për femije/qendres për zhvillim të hershem të femijeve dhe të pushimores për femije.

(3) Në standardet dhe normativat për kryerjen e veprimtarise percaktohen edhe normativat për ushqim, standardet për kushte sanitare-higjienike, si dhe standardet për kohën e nevojshme të punes për realizimin e veprimtarise (veprimtaria perkujdesese, edukative dhe veprimtarise tjeter për kopshtet për femije/qendrat për zhvillim të hershem të femijeve) dhe kriteret për zhvillim të institucioneve.

(4) Standardet dhe normativat për kryerjen e veprimtarise nga paragrafi (1) i ketij neni, i percakton ministri.

**Neni 101**

Themeluesi detyrohet që gjate themelimit të institucionit publik për femije të formoje komision i cili në pajtim me kete ligj bën pergatitjen për fillimin e punes së institucionit.

**Neni 102**

(1) Institucioni për femije mund të filloje punen pasi ministri do të konstatoje se janë permbushur kushtet e percaktuara me kete ligj dhe rregullat tjera dhe do të miratoje aktvendim për kryerjen e veprimtarise.

(2) Aktvendimi nga paragrafi (1) i ketij neni, miratohet në baze të mendimit të komisionit, të perbere prej tre anetash, të emeruar nga ministri.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i ketij neni, kryen inspektim të drejtperdrejte me qellim që të konstatoje nese janë permbushur kushtet nga neni 100 i ketij ligji, në baze të të cilave perpilon mendim.

(4) Pas miratimit të aktvendimit nga paragrafi (1) i ketij neni, institucioni për femije regjistrohet në regjistrin perkates në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonise.

(5) Kunder aktvendimit nga paragrafi (1) i ketij neni, mund të paraqitet ankese në Komisionin Shtetor për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure për Marredhenie Pune në Shkalle të Dyte.

**Neni 103**

Aktvendimi për kryerjen e veprimtarise institucionit për femije i hiqet, nese:

- nuk i zbaton dispozitat e ketij ligji, aktet nenligjore dhe rregullat tjera normative,

- nuk i permbush kushtet për kryerjen e veprimtarise, e në afatin e percaktuar nga organi kompetent nuk do t'i permbushë kushtet ose menjanoje parregullsite,

- i është shqiptuar denim me vendim të plotfuqishem gjyqesor personit juridik, është shqiptuar mase ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarise ose detyres,

- themeluesi miraton akt për shuarjen e institucionit për femije nese është nderprere nevoja, perkatesisht kushtet për kryerjen e veprimtarise për të cilen është themeluar institucioni për femije dhe

- nuk i permbush kushtet tjera të percaktuara me ligjin.

**Neni 104**

Vlefshmeria e aktvendimit për kryerjen e puneve të caktuara nga veprimtaria nderpritet, nese:

- me vendim të organit administrativ ose me vendim të plotfuqishem gjyqesor konstatohet pavlefshmeri e regjistrimit të institucionit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonise,

- institucioni bashkengjitet ose bashkohet me institucione tjeter ose ndahet në dy ose më shume institucione,

- me kerkese të themeluesit dhe

- kushte tjera të percaktuara me ligj.

**Neni 105**

(1) Proceduren për nderprerjen e punes së institucionit për femije të themeluar nga Qeveria e ngrit dhe udheheq Ministria.

(2) Propozim për nderprerjen e punes së institucionit publik nga paragrafi (1) i ketij neni, te themeluesi parashtron Ministria.

(3) Vendim për nderprerjen e punes së institucionit nga paragrafi (1) i ketij neni, miraton Qeveria.

(4) Vendimi për nderprerjen e punes botohet në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise".

(5) Proceduren për nderprerjen e punes së kopshtit publik për femije/qendres për zhvillim të hershem të femijeve e ngre dhe udheheq themeluesi.

(6) Vendim për nderprerjen e punes së institucionit nga paragrafi (5) i ketij neni, miraton keshilli i komunes dhe keshilli i komunes në Qytetin e Shkupit, pas mendimit të marre paraprakisht nga Ministria.

(7) Proceduren për nderprerjen e punes së pushimores publike për femije të themeluar nga komuna dhe Qyteti i Shkupit, e ngre dhe udheheq themeluesi.

(8) Vendim për nderprerjen e punes së institucionit nga paragrafi (7) i ketij neni, miraton keshilli i komunes dhe keshilli i komunes së Qytetit të Shkupit, pas mendimit të marre paraprakisht nga Ministria.

(9) Vendimi nga paragrafi (6) i ketij neni, botohet në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise" dhe fletoren zyrtare të komunes dhe të Qytetit në Shkupit, ndersa vendimi nga paragrafi (8) i ketij neni botohet në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise" dhe fletoren zyrtare të komunes dhe të Qytetit të Shkupit.

(10) Themeluesi, ndersa për institucionin nga paragrafi (1) i ketij neni Ministria, pas miratimit të vendimit për nderprerjen e punes së institucionit, në afat prej tri ditesh e njofton Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonise për shlyerje nga regjistri perkates.

#### Neni 106

(1) Institucion privat për femije mund të themeloje personi vendas ose i huaj juridik ose fizik në baze të lejes, në pajtim me kete ligj.

(2) Mjetet për themelim dhe pune të institucionit privat, i siguron themeluesi.

#### Neni 107

(1) Lejen për themelimin e institucionit privat për femije e leshon Qeveria pas mendimit paraprak të Ministrise, nese jane permbushur kushtet e parapara në nenin 100 paragrafi (1) alinete 2, 3, 4 dhe 5 të ketij ligji dhe nese programet i permbushin standardet dhe normativat për kryerjen e veprimtarise.

(2) Leja për themelimin e institucionit privat leshohet në baze të kerkeses së parashtruar të personit juridik, perkatesisht fizik (në tekstin e metutjeshem: themeluesi).

(3) Me kerkesen për marrjen e lejes për themelimin e institucionit parashtrohet elaborat për nevojat e llojit të tille të institucionit dhe dokumentacion për kushtet e nevojshme të parapara në nenin 100 paragrafi (1) alinete 2, 3, 4 dhe 5 të ketij ligji.

(4) Themeluesi me elaboratin për themelimin e institucionit e percakton llojin dhe vellimin e veprimtarise, kushtet hapesinore, pajisjen, numrin e nevojshem të kuadrove profesionale, programin për kryerjen e veprimtarise dhe gjuhen në të cilen realizohen aktivitetet nga programi, menyren e sigurimit të mjeteve për kryerjen e veprimtarise, mbrojtjen gjate punes të të punesuarve dhe mbrojtjen e shfrytezuesve të sherbimit publik.

(5) Kerkesa me dokumentacionin e percaktuar nga paragrafi (3) i ketij neni, dorezohet në Ministrine.

#### Neni 108

Me vendimin e Qeverise për leshimin e lejes për themelimin e institucionit privat, percaktohet:

- lloji i veprimtarise për të cilen themelohet institucioni,
- kuadri i nevojshem, pajisja, hapesira, sipas standardeve dhe normativave për kryerjen e veprimtarise,
- numri i planifikuar i perfshirjes së femijeve,
- programi për kryerjen e veprimtarise,
- gjuha në të cilen realizohen aktivitetet e permbajtura në programin dhe
- fillimi i punes së institucionit privat.

#### Neni 109

(1) Themeluesi i institucionit për femije miraton akt për themelim.

(2) Me aktin për themelim nga paragrafi (1) i ketij neni vecanerisht percaktohet:

- emri i themeluesit,
- emri i firmes së institucionit dhe selia e institucionit për femije,
- lloji i veprimtarise së institucionit për femije,
- mjetet për themelimin dhe fillimin e punes së institucionit për femije dhe menyren e sigurimit të mjeteve,
- koha për të cilen institucioni themelohet,

- të drejtat dhe obligimet e themeluesit në aspekt të kryerjes së veprimtarise dhe të drejtat dhe obligimet e ndersjella të institucionit për femije dhe themeluesit,

- menaxhimi me institucionin për femije,
- të drejtat dhe obligimet e institucionit për femije në qarkullimin juridik,
- ushtruesi i detyres drejtor dhe
- afati për miratimin e statutit.

#### Neni 110

Themeluesi i institucionit privat për femije nuk mund ta zgjeroje ose ndryshoje veprimtarine për të cilen eshte themeluar, pa leje paraprake nga Qeveria.

#### Neni 111

Lejen për themelimin e institucionit privat mund ta heqë Qeveria me propozim të Ministrise, nese:

- themeluesi themelon institucion privat në kundershim me aktin për leje nga neni 106 i ketij ligji dhe
- konstatohet se institucioni privat nuk permbush më disa prej kushteve nga neni 100 paragrafi (1) alinete 2, 3, 4 dhe 5 të ketij ligji, ose nuk i zbaton dispozitat e ketij ligji dhe aktet nenligjore që dalin nga ai.

#### Neni 112

(1) Me ditën e miratimit të aktit për heqjen, perkatesisht nderprerjen e lejes, institucioni privat e nderpret punen.

(2) Në baze të aktit për heqjen, perkatesisht nderprerjen e lejes, institucioni privat shlyhet nga regjistri nga neni 193 i ketij ligji dhe nga regjistri perkates në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonise.

#### Neni 113

Institucioni privat detyrohet së paku gjashte muaj para miratimit të aktit për nderprerjen e punes të institucionit ta njoftoje Ministrine dhe shfrytezuesit e sherbimeve.

## X. MENAXHIMI DHE UDHEHEQJA

### 1. Organi i menaxhimit

#### Neni 114

(1) Organ i menaxhimit në institucionin publik për femije eshte keshilli drejtues.

(2) Keshillin drejtues të institucionit publik për femije të themeluar nga Qeveria e perbejne perfaqesuesit e themeluesit të institucionit publik për femije, të prinderve dhe të komunes dhe të komunes në Qytetin e Shkupit në zonen e të së ciles eshte selia e institucionit, perkatesisht Qyteti i Shkupit për pushimoren për femije.

(3) Në institucionin publik për femije të themeluar nga Qeveria, keshilli drejtues numeron shtate anetare, edhe atë: kater perfaqesues nga themeluesi, një perfaqesues nga institucioni publik për femije, një perfaqesues nga prinderit e femijes dhe një perfaqesues nga komuna dhe komuna në Qytetin e Shkupit, perkatesisht nga Qyteti i Shkupit për pushimoren për femije.

(4) Perfaqesuesit e themeluesit i emerone dhe shkarkone Qeveria me propozim të Ministrise.

(5) Perfaqesuesin e institucionit publik për femije të themeluar nga Qeveria e propozone keshilli profesional i institucionit në baze të profesionalitetit dhe kompetences, ndersa e emerone dhe shkarkone themeluesi pas procedures së percaktuar me statut.

(6) Perfaqesuesin e prinderve e propozone keshilli i prinderve, ndersa e emerone dhe shkarkone themeluesi.



(7) Perfaqesuesin e komunes dhe komunes në Qytetin e Shkupit, perkatesisht Qytetit të Shkupit për pushimore për femije e emerone dhe shkarkon keshilli i komunes në rajonin e së ciles institucioni ka seli dhe keshilli i Qytetit të Shkupit për pushimore për femije.

(8) Keshilli drejtues i kopshtit komunal për femije dhe pushimores komunale për femije, të themeluara nga komuna e perbejne shtate anetare, edhe atë: tre perfaqesues nga themeluesi, një perfaqesues nga institucioni, dy perfaqesues nga prinderit e femijeve dhe një perfaqesues nga Ministria.

(9) Keshilli drejtues të qendres komunale për zhvillim të hershem të femijeve perbehet prej tre anetareve, edhe atë: një perfaqesues nga themeluesi, një perfaqesues nga Ministria dhe një perfaqesues nga prinderit e femijeve.

(10) Keshilli Drejtues i kopshtit për femije të komunes në Qytetin e Shkupit, të themeluar nga komuna në Qytetin e Shkupit perbehet prej shtate anetareve, edhe atë: dy perfaqesues nga themeluesi, një perfaqesues nga Qyteti i Shkupit, një perfaqesues nga institucioni, dy perfaqesues nga prinderit e femijeve dhe një perfaqesues nga Ministria.

(11) Keshilli Drejtues i qendres për zhvillim të hershem të femijeve të themeluar nga komuna në Qytetin e Shkupit, perbehet prej tre anetareve edhe atë: një perfaqesues nga themeluesi, një perfaqesues nga Ministria dhe një perfaqesues nga prinderit e femijeve.

(12) Keshilli Drejtues i pushimores për femije në Qytetin e Shkupit, të themeluar nga Qyteti i Shkupit perbehet prej shtate anetareve, edhe atë: tre perfaqesues nga themeluesi, një perfaqesues nga institucioni, dy perfaqesues nga prinderit e femijeve dhe një perfaqesues nga Ministria.

(13) Perfaqesuesit e themeluesit të kopshtit publik për femije të themeluar nga komuna dhe komuna në Qytetin e Shkupit i emerone dhe shkarkon keshilli i komunes dhe keshilli i komunes në Qytetin e Shkupit, ndersa të pushimores publike për femije të themeluar nga komuna i emerone dhe shkarkon keshilli i komunes.

(14) Perfaqesuesit e themeluesit të pushimores publike për femije të themeluar nga Qyteti i Shkupit i emerone dhe shkarkon keshilli i Qytetit të Shkupit.

(15) Perfaqesuesin e qytetit të Shkupit në keshillin drejtues nga paragrafi (10) i ketij neni, e propozon keshilli i Qytetit të Shkupit, ndersa e emerone dhe shkarkon themeluesin në pajtim me statutin.

(16) Perfaqesuesin e institucionit e propozon keshilli profesional i institucionit në baze të profesionalitetit dhe kompetences, ndersa e zgjedh dhe e shkarkon themeluesin pas procedures së percaktuar me statutin e institucionit.

(17) Perfaqesuesit e prinderve të femijeve i propozon keshilli i prinderve, ndersa i emerone dhe shkarkon themeluesin pas procedures së percaktuar me statutin e institucionit.

(18) Perfaqesuesin e Ministrise e propozon ministri, ndersa e emerone dhe shkarkon themeluesin.

(19) Perfaqesuesit nga themeluesi, Qyteti i Shkupit, nga Ministria dhe nga prinderit nuk mund të emerohen nga radhet e të punesuarve në institucionin.

#### Neni 115

(1) Anetaret e Keshillit Drejtues emerohen për periudhe prej kater vitesh.

(2) Keshilli Drejtues miraton vendim me shumice votash nga numri i pergjithshem i anetareve të keshillit.

(3) Me Keshillin Drejtues udheheq kryetari i cili zgjidhet nga radhet e anetareve të keshillit.

(4) Menyra e punes së Keshillit Drejtues rregullohet me statut.

#### Neni 116

Keshilli Drejtues i kopshtit publik për femije/qendres publike për zhvillim të hershem të femijeve:

- miraton statut të kopshtit publik për femije/qendres publike për zhvillim të hershem të femijeve,
- propozon program vjetor për pune dhe raport për pune të keshilli i komunes dhe i komunes në Qytetin e Shkupit,
- propozon plan financiar te keshilli i komunes dhe i komunes në Qytetin e Shkupit,
- propozon plan financiar te keshilli i komunes dhe i komunes në Qytetin e Shkupit,
- shpall konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit të kopshtit publik për femije/qendres publike për zhvillim të hershem të femijeve,
- kryen interviste me kandidatet për drejtor,
- i propozon kryetarit të komunes dhe kryetarit të komunes në Qytetin e Shkupit një kandidat nga kandidatet e paraqitur në konkursin e shpallur publik për zgjedhjen e drejtorit,
- miraton akt për organizimin e brendshem dhe sistematizimin e vendeve të punes në institucionin për të cilin pelqim jep keshilli i komunes dhe i komunes në Qytetin e Shkupit,
- vendos për kundershimitet dhe ankesat e të punesuarve,
- vendos për ankesat e shfrytezuesve të sherbimeve dhe shqyrton dhe vendos edhe për pune tjera të percaktuara me ligj dhe statut.

#### Neni 117

Keshilli Drejtues i pushimores publike për femije të themeluar nga komuna dhe Qyteti i Shkupit:

- miraton statut të pushimores publike për femije,
- propozon program vjetor për pune dhe raport për pune të keshilli i komunes dhe i Qytetit të Shkupit,
- propozon plan financiar te keshilli i komunes dhe i Qytetit të Shkupit,
- propozon llogari vjetore te keshilli i komunes dhe i Qytetit të Shkupit,
- shpall konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit të pushimores publike për femije,
- kryen interviste me kandidatet për drejtor,
- i propozon kryetarit të komunes dhe të Qytetit të Shkupit një kandidat nga kandidatet e paraqitur në konkursin e shpallur publik për zgjedhjen e drejtorit,
- miraton akt për organizimin e brendshem dhe sistematizimin e vendeve të punes në institucionin për të cilin jep pelqim keshilli i komunes dhe i Qytetit të Shkupit,
- vendos për kundershimitet dhe ankesat e të punesuarve,
- vendos për ankesat e shfrytezuesve të sherbimeve dhe shqyrton dhe vendos edhe për pune tjera të percaktuara me ligj dhe statut.

#### Neni 118

Keshilli Drejtues i institucionit publik për femije të themeluar nga Qeveria:

- miraton statut të institucionit publik për femije,
- propozon program vjetor për pune dhe raport për pune në Ministrine,
- propozon plan financiar në Ministrine,
- propozon llogari vjetore në Ministrine,
- shpall konkurs publik për emerimin e drejtorit të institucionit publik për femije,
- miraton akt për organizimin e brendshem dhe sistematizimin e vendeve të punes në institucionin për të cilin jep pelqim Ministria,
- vendos për kundershimitet dhe ankesat e të punesuarve,
- vendos për ankesat e shfrytezuesve të sherbimeve dhe shqyrton dhe vendos edhe për pune tjera të percaktuara me ligj dhe statut.

## Neni 119

Menaxhimin në institucionin privat e percakton themelesi në pajtim me ligjin.

## 2. Organi udheheqes

## Neni 120

(1) Me institucionin publik për femije udheheq drejtori i institucionit, si organ udheheqes.

(2) Drejtor i kopshtit publik për femije/qendres për zhvillim të hershem të femijeve mund të emerohet, perkatesisht zgjidhet personi i cili pervec kushteve të pergjithshme të percaktuara me ligj dhe kushteve të percaktuara në nenin 142 të ketij ligji eshte me arsim të larte (me 240 kredi të marra sipas SETK ose shkalle VII/1 të kryer) dhe i ploteson kushtet e percaktuara në nenin 135 të ketij ligji për edukator, për punetor profesional, për bashkepunetor profesional, person me fakultet të kryer filologjik - programi studimor mesimor dhe studime specialistike për pedagoge parashkollore, jurist dhe ekonomist me arsim të larte (me 240 kredi të marra sipas SETK ose shkalle VII/1 të kryer) dhe mbi kater vjet pervoje pune pas diplomimit dhe posedon licence të vlefshme për drejtor për institucion për femije.

(3) Drejtor i pushimores publike për femije mund të emerohet, perkatesisht zgjidhet personi i cili pervec kushteve të pergjithshme të percaktuara me ligj dhe kushteve të percaktuara në nenin 142 të ketij ligji, ka të kryer arsim të larte (me 240 kredi të marra sipas SETK ose shkalle të kryer VII/1) dhe mbi kater vjet pervoje pune pas diplomimit dhe posedon licence të vlefshme për drejtor për institucion për femije.

(4) Kandidati për drejtor i institucionit publik për femije detyrimisht dorezon edhe program për pune të institucionit publik.

(5) Drejtorin e institucionit publik për femije të themeluar nga Qeveria e emerohet dhe shkarkon ministri.

(6) Drejtori nga paragrafi (5) i ketij neni emerohet në baze të konkursit publik.

(7) Konkursi publik shpallet më së voni 30 dite para kalimit të mandatit të drejtorit të institucionit publik për femije të themeluar nga Qeveria.

(8) Nese konkursi publik nuk shpallet në afatin e percaktuar në paragrafin (7) të ketij neni, konkursin publik e shpall Ministria.

(9) Drejtorin e kopshtit publik për femije/qendren publike për zhvillim të hershem të femijeve e zgjedh dhe shkarkon kryetari i komunes dhe i komunes në Qytetin e Shkupit.

(10) Drejtorin e pushimores publike për femije të themeluar nga komuna dhe Qyteti i Shkupit e zgjedh dhe shkarkon kryetari i komunes dhe i Qytetit të Shkupit.

(11) Drejtori i institucionit publik për femije zgjidhet, perkatesisht emerohet për periudhe prej kater vitesh.

(12) Pas kalimit të afatit nga paragrafi (11) i ketij neni, personi i njejte ka të drejte edhe për një mandat të njeplasnjeshem, ndersa mundesi për rizgjedhje, perkatesisht riemirim personi i njejte ka pas kalimit të kater viteve nga zgjedhja, perkatesisht emerimi i tij i fundit.

## Neni 121

(1) Drejtori i kopshtit publik për femije/qendres publike për zhvillim të hershem të femijeve, perkatesisht i pushimores publike për femije të themeluar nga komuna dhe Qyteti i Shkupit, e organizon dhe udheheq me punen e institucionit, në menyre të mevetesishme miraton vendime nga fusheveprimi i kompetences së tij dhe aktet e institucionit, e perfaqeson institucionin para personave të trete dhe eshte pergjegjes për ligjshmerine dhe punen në institucionin.

(2) Në realizimin e obligimeve dhe udheheqjen nga paragrafi (1) i ketij neni, drejtori:

- e propozon propozim-programin vjetor për punen e keshillit drejtues dhe ndermerr masa për realizimin e programit vjetor për pune,
- i zbaton vendimet e keshillit drejtues,
- vendos për themelimin dhe nderprerjen e marredhenies së punes të të punesuarve për kryerjen e veprimtarise, në pajtim me ligjin, aktet e institucionit dhe marreveshje kolektive,
- bën sistemimin e punetoreve,
- parashtron raport për punen e institucionit gjate vitit në keshillin drejtues dhe te themeluesi,
- parashtron raport për realizimin e programit vjetor për pune në keshillin drejtues, te themeluesi dhe në Ministrine,
- parashtron raport për realizimin e punes materiale-financiare të institucionit te keshilli drejtues dhe te themeluesi dhe eshte pergjegjes për punen materiale-financiare,
- parashtron raport për realizimin e programeve te keshilli drejtues, themeluesi dhe Ministria dhe
- kryen pune tjera të parapara me ligj, statutin dhe aktet tjera të institucionit.

## Neni 122

(1) Drejtori i institucionit publik për femije të themeluar nga Qeveria e organizon dhe udheheq punen e institucionit, në menyre të mevetesishme miraton vendime nga fusheveprimi i kompetences se tij dhe aktet e institucionit, e perfaqeson institucionin para personave të trete dhe eshte pergjegjes për ligjshmerine dhe punen në institucionin.

(2) Në realizimin e obligimeve dhe udheheqjen nga paragrafi (1) i ketij neni drejtori:

- e propozon propozim-programin vjetor për punen te keshilli drejtues dhe ndermerr masa për realizimin e programit vjetor për pune,
- i zbaton vendimet e keshillit drejtues,
- vendos për themelimin dhe nderprerjen e marredhenies së punes së të punesuarve për kryerjen e veprimtarise në pajtim me ligjin, aktet e institucionit dhe marreveshje kolektive,
- bën sistemimin e punetoreve,
- parashtron raport për punen e institucionit gjate vitit te keshilli drejtues dhe te Ministria,
- parashtron raport për realizimin e programit vjetor për pune te keshilli drejtues dhe Ministria,
- parashtron raport për realizimin e punes materiale-financiare të institucionit te keshilli drejtues dhe Ministria dhe eshte pergjegjes për punen materiale-financiare,
- parashtron raport për realizimin e programeve te Keshilli Drejtues dhe Ministria dhe
- kryen pune tjera të parapara me ligjin, statutin dhe aktet tjera të institucionit.

## Neni 123

(1) Kryetari i komunes, tre muaj para kalimit të mandatit të drejtorit ekzistues, miraton vendim që Keshilli Drejtues të shpalle konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit.

(2) Në konkursin e shpallur publik percaktohen kushtet të cilat duhet t'i permbushe kandidati për drejtor, dokumentacioni i nevojshem, kohezgjatja e konkursit publik dhe afati në të cilin do të behet zgjedhja.

(3) Kandidatet e paraqitur i dorezojne dokumentet e nevojshme në pajtim me shpalljen te Keshilli Drejtues.

(4) Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni tre anetaresh i zgjedhur nga Keshilli Drejtues perberja dhe kompetenca e të cilit percaktohet me statut të institucionit publik.

(5) Komisioni detyrohet që në afat prej pese ditesh pas perfundimit të konkursit t'i shqyrtoje dokumentet e arritura.

(6) Kandidateve të cilet nuk i permbushin kushtet e parapara me konkursin u kthehen dokumentet me arsytim.

(7) Keshilli Drejtues mund të kerkoje dokumente plotesuese nga kandidatet të cilet i permbushin kushtet, në pajtim me dispozitat në statutin e institucionit.

(8) Keshilli Drejtues i interviston kandidatet të cilet i permbushin kushtet.

(9) Keshilli Drejtues në afat prej shtate ditesh nga biseda e realizuar me kandidatet kryetarit të komunes i propozon një kandidat për zgjedhje të drejtorit.

(10) Kryetari i komunes në afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes së propozimit, bën zgjedhjen e drejtorit.

(11) Nese kryetari i komunes në afatin e percaktuar në paragrafin (10) të ketij neni nuk zgjedh drejtor, detyrohet që në afat prej tri ditesh ta njoftoje Keshillin Drejtues.

(12) Keshilli Drejtues në afat prej shtate ditesh nga dita e pranimit të njoftimit kryetarit të komunes i propozon një kandidat për zgjedhje të drejtorit.

(13) Kryetari i komunes është i detyruar që në afat prej pese ditesh nga dita e marrjes së propozimit ta zgjedhe kandidatit e propozuar nga Keshilli Drejtues.

(14) Kandidatet të cilet nuk jane zgjedhur, në afat prej tete ditesh nga dita e pranimit të vendimit të kryetarit të komunes kane të drejte ankese lidhur me zbatimin e procedures së zgjedhjes në Komisionin Shteteror për Vendimmarrje Në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte.

(15) Kunder vendimit të Komisionit nga paragrafi (14) i ketij neni, kandidati ka të drejte të ngreje kontest administrativ.

#### Neni 124

Drejtori i institucionit publik për femije mund të shkarohet:

- me kerkesen e tij,
- nese nuk e zbaton ligjin dhe aktet e pergjithshme të miratuara në pajtim me ligjin,
- nese nuk e realizon programin vjetor për punen e institucionit,
- nese me fajin e tij u është shkaktuar dëm femijeve, prinderve të tyre ose kujdestareve, institucionit, themeluesit ose shtetit,
- nese lejon pagesen e mjeteve të cilat nuk jane percaktuar në planin financiar vjetor të institucionit,
- nese lejon organizimin e veprimtarise, në kundërshtim me ligjin, aktet e pergjithshme të miratuara në pajtim me ligjin dhe programin vjetor për pune dhe
- në raste tjera të percaktuara me ligj.

#### Neni 125

(1) Nese ekzistojne njohuri të caktuara për veprimin e drejtorit në pajtim me dispozitat nga neni 124 alinete 2, 3, 4, 5 dhe 6 të ketij ligji, Keshilli Drejtues i institucionit publik i themeluar nga komuna dhe qyteti i Shkupit, perkatesisht Keshilli Drejtues i kopshtit publik për femije/qendra publike për zhvillim të hershem të femijeve, konvokon mbledhje në të cilen miraton konkluzion me shkrim i cili i dorezohet drejtorit.

(2) Drejtori ka të drejte që në afat prej shtate ditesh nga dita e pranimit të prononcohet për pohimet në konkluzion.

(3) Nese Keshilli Drejtues i institucionit nga paragrafi (1) i ketij neni nuk e pranon prononcimin e drejtorit, konvokon mbledhje në afat prej tri ditesh dhe në prezence të perfaqesuesit nga institucioni profesional i specializuar ose shkencor, perkatesisht organi tjetër të cilin e percakton ministri varesisht nga lloji i veprimit nga neni 124 alinete 2, 3, 4, 5 dhe 6 të ketij ligji, kryen degjim të drejtorit. Perfaqe-

suesi jep mendim për arsyeshmerine për shkarkimin e drejtorit.

(4) Nese Keshilli Drejtues vlereson se është e domoshme, në afat prej shtate ditesh kryetarit të komunes i dorezon propozim për shkarkimin e drejtorit.

(5) Kryetari i komunes është i detyruar që në afat prej pese ditesh nga dita e marrjes së propozimit nga Keshilli Drejtues ta zgjedhe drejtorin.

(6) Drejtori i shkarkuar, në afat prej 15 ditesh nga dita e pranimit të vendimit të kryetarit të komunes ka të drejte ankese për zbatimin e procedures te Komisioni Shteteror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte.

(7) Kunder vendimit të Komisionit nga paragrafi (6) i ketij neni, drejtori i shkarkuar ka të drejte padie në gjykatën themelore kompetente.

#### Neni 126

Kryetari i komunes, në afat prej tri ditesh nga dita e shkarkimit të drejtorit, emeron ushtrues detyre drejtor nga radhet e të punesuarve në institucionin i cili i permbush kushtet për drejtor dhe i cili i kryen punet e drejtorit deri në emerimin e drejtorit të ri, më së shumti deri në gjashte muaj nga dita e emerimit të tij.

#### Neni 127

Nese drejtori i institucionit publik për femije i themeluar nga Qeveria shkarkohet para kalimit të mandatit ose para kohe do t'i nderpritet mandati, si dhe në rast kur nuk është zgjedhur drejtor, ministri emeron ushtrues detyre drejtor nga radhet e të punesuarve në institucionin i cili i permbush kushtet për drejtor dhe i cili i kryen punet e drejtorit deri në emerimin e drejtorit të ri, jo më gjate se gjashte muaj nga dita e emerimit të tij.

#### Neni 128

Nese drejtori është shkarkuar në baze të veprimeve të theksuara në nenin 124 alinete 2, 3, 4, 5 dhe 6 të ketij ligji, drejtorit i nderpritet marredhenia e punes.

#### Neni 129

Udheheqjen në institucionin privat e rregullon themeluesi në pajtim me ligjin duke u nisur nga principet dhe nevojat e institucionit për femije dhe shfrytezuesve të sherbimeve.

### 3. Organet profesionale

#### Neni 130

(1) Organ profesional në institucionin publik për femije është Keshilli Profesional.

(2) Keshillin Profesional e perbejne të punesuarit të cilet kryejne pune profesionale dhe e realizojne veprimtarine në institucion dhe drejtori.

(3) Me Keshillin Profesional udheheq drejtori.

(4) Keshilli Profesional:

- percakton baza profesionale për realizimin e programit për pune,
- drejtorit i jep mendim dhe propozime në aspekt të organizimit të punes dhe kushteve për pune,
- emeron dhe shkarkon perfaqesues të institucionit publik për femije në Keshillin Drejtues të institucionit publik për femije nga radhet e të punesuarve të cilet kryejne pune profesionale dhe

- kryen edhe pune tjera të percaktuara me statutin.

(5) Në institucionin publik për femije mund të formohen edhe trupa tjere profesionale të percaktuar me statutin e institucionit.

#### 4. Organi për kontroll të brendshem

## Neni 131

(1) Për kryerjen e kontrollit të brendshëm të punës së institucioneve për fëmijë themeluesi formon organ mbikeqyres.

(2) Organin mbikeqyres e perbejne tre deri në pese anetare të emeruar nga themeluesi.

(3) Anetaret e organit mbikeqyres zgjidhen me mandat në kohezgjatje prej kater vitesh.

(4) Për anetare të organit mbikeqyres mund të zgjidhen personat që nuk kane themeluar marrëdhënie pune në institucion, që kane arsim të lartë dhe posedojne njohuri dhe pervoja nga veprimtaria e institucionit.

(5) Organin mbikeqyres e konvokon dhe me punën e tij udheheq kryetari, të cilin e zgjedhin anetaret e organit mbikeqyres nga radhet e tyre.

(6) Organi mbikeqyres vendimet e tij i miraton me shumice votash nga numri i pergjithshëm i anetareve.

## Neni 132

(1) Organi mbikeqyres kryen kontroll mbi punën materiale-financiare të institucionit, shfrytezimin dhe disponimin e mjeteve të institucionit dhe për argumentet dorezon raport të themeluesi, Ministria, Keshilli Drejtues dhe drejtori i institucionit.

(2) Numri i anetareve të organit mbikeqyres, menyra e punës, kushtet dhe menyra e nderprerjes së mandatit të anetareve të organit mbikeqyres para skadimit të mandatit, percaktohen me statutin e institucionit.

## 5. Organe tjera

## Neni 133

(1) Në institucionin për fëmijë detyrimisht formohet keshill prinderor.

(2) Keshilli prinderor e percjell, shqyrton dhe jep mendim për realizimin e veprimtarisë në institucionin.

(3) Puna, numri i anetareve, menyra e zgjedhjes dhe organizimi i keshillit prinderor, percaktohen me statut.

#### XI. PERSONAT PROFESIONALE PËR PERKUJDESJE DHE EDUKIM TË FEMIJEVE TË MOSHES PARASHKOLLORE DHE PËR PUSHIM DHE REKREACION TË FEMIJEVE

## Neni 134

(1) Punet profesionale në veprimtarinë perkujdesje dhe edukim të fëmijeve të moshës parashkollore i kryejne personat profesionale, si vijojne:

- punetoret profesionale (pedagog, psikolog, punetor social, defektolog/edukator special dhe rehabilitues, logoped, doktor i mjekesise dhe doktor i stomatologjise),

- edukatore,

- infermiere dhe

- bashkepunetore profesionale (pedagog muzikor, pedagog i artit figurativ, pedagog i edukates fizike, profesor i gjuheve të huaja dhe letersise, infermiere e larte medicinale, punetor social).

(2) Punetore profesionale mund të jene: pedagog i diplomuar, psikolog i diplomuar, punetor i diplomuar social, defektolog/edukator dhe rehabilitues i diplomuar, doktor i mjekesise dhe doktor i stomatologjise - me 240 kredi të marra sipas SETK ose shkalle të kryer VII/1 dhe licence të vlefshme për punetor

(3) Edukatore mund të jene: profesor i diplomuar i edukates parashkollore, edukator i diplomuar i fëmijeve të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të marra sipas SETK ose arsim

të lartë të kryer shkalla VII/1 ose me arsim sipëror perkates të kryer dhe licence të vlefshme për edukator.

(4) Edukator në grup me fëmije me pengesa në zhvillimin mental ose pengesa trupore mund të jene: defektolog i diplomuar/edukator i specializuar dhe rehabilitues me 240 kredi të marra sipas SETK ose studime të mbaruara adekuatë për punë me fëmije me pengesa në zhvillimin mental ose pengesa trupore - shkalla VII/1 dhe licence të vlefshme për edukator dhe person që i ploteson kushtet për edukator dhe studime të mbaruara për specializim për defektologji.

(5) Edukator për qëndrim të fëmijeve në moshe prej gjashtë vjet, perkatesisht prej vajtjes në shkollë fillore deri në moshën dhjetë vjet mund të jene personi i cili i ploteson kushtet për edukator, ndërsa mund të jene edhe personi me studime të mbaruara për mesim klasor dhe studime të mbaruara për specializim me 240 kredi të marra sipas SETK ose arsim të lartë të mbaruar shkalla VII/1 dhe licence të vlefshme për edukator.

(6) Infermier mund të jene personi me arsim të mesëm katërvjecar të kryer dhe licence të vlefshme për infermier.

(7) Bashkepunetore profesionale mund të jene: pedagogu i muzikes, pedagogu i diplomuar i artit figurativ, pedagogu i diplomuar për edukate fizike, profesori i diplomuar për gjuhe të huaja dhe letersi – me 240 kredi të marra sipas SETK ose shkalle VII/1 të mbaruar dhe licence të vlefshme për bashkepunetor profesional; infermiere e larte medicinale, infermiere e pergjithshme e diplomuar medicinale /teknik medicinal, infermiere medicinale e diplomuar/ teknik medicinal – me 180 kredi të marra sipas SETK ose shkalle VI/1 të mbaruar dhe licence të vlefshme për bashkepunetor profesional; punetor social dhe logoped – me 180 kredi të marra sipas SETK ose shkalle VI/1 të mbaruar dhe licence për bashkepunetor profesional.

(8) Pune të caktuara me vëllim të vogël që jane në funksion të perkujdesjes dhe edukimit të fëmijeve, perkatesisht të pushimit dhe rekreacionit në institucion publik për fëmije, me autorizim të drejtorit të institucionit publik për fëmije, pa kompensim mund t'i kryejne vullnetare të cilet jane të kualifikuar për atë lloj të punës ose kane kaluar trajnim për kryerjen e asaj pune.

(9) Punet të cilat mund të kryhen me punë vullnetare, menyren e kryerjes së tyre, mbulimin e shpenzimeve reale, si dhe kualifikimet reale ose trajnimin i cakton institucioni publik për fëmije.

## Neni 135

Punë profesionale në kopsht për fëmije mund të kryejne juristi dhe ekonomisti me 240 kredi të marra sipas sistemit SETK ose arsim të lartë të kryer shkalla VII/1 ose arsim sipëror.

## Neni 136

Kujdes dhe perkujdesje me fëmijet me nevoja specifike të penguar në zhvillimin mental ose pengesa trupore mund të kryejne edhe asistente - edukatore me arsim të mesëm katërvjecar ose me arsim sipëror të cilet posedojne licence të vlefshme për infermier.

## Neni 137

Punet profesionale në pushimorën për fëmije varesisht nga lloji i punëve i kryejne të punësuarit me arsim të lartë VII/1 ose me 240 kredi të marra sipas SETK ose me arsim sipëror.

## Neni 138

Punet administrative, të gatimit dhe punet teknike në institucion për fëmije i kryejne të punësuar me shkalle adekuatë të pergatitjes profesionale.

## Neni 139

Lloji dhe shkalla e përgatitjes profesionale për të punësuarit nga nenet 137 dhe 138 të këtij ligji, përcaktohen me aktin për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në institucion.

Neni 140

(1) Të punësuarit në institucion publik për femije të cilët kryejnë punë me interes publik në pajtim me kete ligj kanë status të nepunesve publike.

(2) Punë me interes publik të cilat do t'i kryejnë të punësuarit në institucionet publike për femije (kopshte për femije dhe qendra për femije për zhvillim të hershëm të femijeve) janë: punë edukative-perkujdesese; punë edukative-arsimore; punë pedagogjike dhe psikologjike; punë të mbrojtjes sociale të femijeve; punë të mbrojtjes shëndetësore preventive për femije; punë profesionale për mbrojtje të femijeve, si dhe punë juridike-profesionale, administrative, financiare-të kontabilitetit, punë analitike të planit dhe informative.

(3) Punë me interes publik të cilat do t'i kryejnë të punësuarit në institucionet publike për femije pushimore për femije janë: punë profesionale për pushim dhe rekreacion; punë juridike-profesionale, administrative, financiare-të kontabilitetit, analitike të planit dhe informative.

(4) Të punësuarit në institucion publik për femije të cilët kryejnë punë të gatimit, ndihmese dhe teknike nuk kanë status të nepunesve publike dhe në lidhje me të drejtat e tyre, obligimet dhe përgjegjësitë e marrëdhënies së punës zbatohen dispozitat e rregullave të përgjithshme të marrëdhënies të punës.

Neni 141

Për të punësuarit në institucionin publik për femije të cilët kanë status të nepunesve publike për ceshtjet që kanë të bëjnë me punësimin, të drejtat dhe obligimet, përgjegjësinë, vlerësimin, pushimin e punësimit, mbrojtjen dhe vendosjen për të drejtat e nepunesit publik zbatohen dispozitat e këtij ligji, ligji të vecantë nga sfera perkatese adekuate dhe dispozitat që kanë të bëjnë me nepunesit publike.

Neni 142

(1) I punësuar në institucion për femije, mund të jete personi i cili krahas kushteve të caktuara nga nenet 134 deri 138 të këtij ligji, duhet t'i plotesoje edhe kushtet në vijim:

- të jete shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të jete fizikisht dhe psikikisht i shëndoshe,
- të flase gjuhen maqedonase dhe të njohe alfabetin cirilik,
- të mos i jete kumtuar denim ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyres,
- të mos i jete kumtuar vendim gjyqësor i plotfuqishëm me të cilin është denuar për veper penale për dhune familjare, marrje të personit të mitur, neglizhence ose abuzim të personit të mitur ose incest, për veper penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pa marrë parasysh sanksionin e shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është konstatuar sjellje diskriminuese dhe
- të plotesoje edhe kushte tjera të caktuara në aktin për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës.

(2) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni, të cilët janë të inkuadruar në grupet në të cilat aktivitetet edukativo-arsimore i kryejnë në gjuhen e pjesëtareve të bashkësive duhet ta njohin gjuhen dhe alfabetin në të cilin realizohet veprimtaria.

Neni 143

(1) Për plotësimin e vendit të lire të punës për kryerje të punëve me interes publik në institucionet publike për femije, drejtori i institucionit merr vendim për nevojë për punësim të nepunesit publik.

(2) Me vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohet nese plotësimi i vendit të lire të punës në institucion kryhet nepermjet punësimit të personit nepermjet shpalljes së konkursit publik, shpalljes së konkursit të brendshëm, sistemit të nepunesve publike të punësuar në institucion ose me marrjen e nepunesit publik nga institucioni tjetër perkatesisht me marrjen edhe të punësuarit nga shkolla fillore me Fakultet pedagogjik të kryer-profesor për mesim klasor.

(3) Para miratimit të vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, për punësim të edukatorit institucioni publik për femije detyrohet që paraprakisht të përcaktojë nese sigurimi i nevojës për të punësuarin (edukator) mund të sigurohet me marrjen e të punësuarit nga shkolla fillore në komune dhe komunën e Qytetit të Shkupit, në kushtet e miratuara me kete ligj.

(4) Marrja nga paragrafi (3) i këtij neni kryhet pa shpallje me marreveshje për marrje ndërmjet shkolles fillore dhe institucionit publik për femije në baze të së ciles lidhet marreveshje për punësim për kryerjen e punëve si edukator.

(5) Punetori i marrë nga paragrafi (4) i këtij neni, detyrohet që më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga dita e marrjes të jape provim për nepunes publik.

(6) Nese plotësimi i vendit të lire të punës kryhet nepermjet konkursit publik, drejtori i institucionit dorezon kerkese të Agjencia për Administratë për shpallje të konkursit publik për punësim.

(7) Shpallja e konkursit nga paragrafi (6) i këtij neni dhe zbatimi i procedurës për zgjedhje kryhet në pajtim me rregullat që kanë të bëjnë me nepunesit publike.

(8) Në rastet kur plotësimi i vendit të punës kryhet nepermjet shpalljes së konkursit intern, konkursi intern shpallet në ueb faqen dhe në tabelen për shpallje të institucionit. Konkursi përmban të dhëna për vendin e punës që duhet të plotësohet dhe për kushtet e nevojshme të cilat duhet t'i plotësojë nepunesi publik në pajtim me kete ligj, aktin për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës të institucionit si dhe kushtet e vecantë të përcaktuara me rregullat që kanë të bëjnë me nepunesit publike.

(9) Afati për paraqitje në konkurs intern nuk mund të jete më i shkurtër se pesë dite pune nga dita e shpalljes së tij.

(10) Për punë urgjente dhe të paprolongueshme kryerja e të cilave nuk duron prolongim, marrëdhënia e punës mund të themelohet për kohe të caktuar edhe pa shpallje publike, por më së shumti deri në 90 dite.

Neni 144

(1) Nepunesi publik i punësuar në institucionin publik për femije, i cili ka arsim perkates, përvije pune të nevojshme në profesion dhe i plotëson edhe kushtet tjera të përcaktuara në aktin për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në institucion, sipas nevojës së institucionit apo me kerkese të tij mund të sistemohet në vend tjetër pune në pajtim me aktin për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës ose të merret në institucion tjetër, nese për kete e ka pelqimin e personeve udheheqes të institucioneve.

(2) I punësuar i cili nuk e ka statusin e nepunesit publik, ndërsa ka arsim perkates, përvije pune të nevojshme dhe i plotëson edhe kushtet tjera të përcaktuara me aktet për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës të institucionit, sipas nevojës ose me kerkese të tij mund të merret ose sistemohet në vendin e punës me titull

perkates në institucion, dhe të marre statusin e nepunesit publik.

(3) I punesuari nga paragrafi (2) i ketij neni, detyrohet që në afat prej gjashte muajsh nga dita e marrjes ose sistemit të tij të jape provim për nepunes publik.

(4) Personat të cilet për here të pare punesohen në institucionin publik për femije për kryerje të puneve me interes publik dhe personat të cilet punesohen në vend më të larte të punes nga vendi i meparshem në institucion, detyrimisht kryejne pune provuese. Puna provuese për kandidatin e zgjedhur për nepunes publik me arsim të larte dhe sipëror zgjat 12 muaj, nderkaq për kandidatin e zgjedhur me arsim të mesëm dhe personin i cili punesohet në vend më të larte të punes nga vendi i meparshem, puna provuese zgjat gjashte muaj.

(5) Në menyren e kryerjes së punes provuese dhe punesimit të personave të zgjedhur nga paragrafi (4) i ketij neni, zbatohen dispozitat e caktuara në dispozitat që kane të bejne me nepunesit publike.

#### Neni 145

(1) Të punesuarit në institucion për femije, personi fizik i cili kryen veprimtari profesionale dhe personat e punesuar në agjencite për dhenie të shërbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore të cilet janë në kontakt të drejtperdrejte me femijet ose ushqimin, domos duhet të kontrollohen permes kontrolleve sistematike një here në vit.

(2) Të punesuarit, i cili është në kontakt të drejtperdrejte me femijet dhe ushqimin, ndërsa gjate marrëdhënies së punes konstatohet se është i semure me semundje ngjitesë, semundje psikike, semundje vartese (alkoolizem, narkomani dhe shfrytezim të substancave tjera psikotrope dhe prekursive), i nderpritet marrëdhënia e punes.

(3) Percaktimi i aftësive psikofizike të të punesuarve nga paragrafi (2) i ketij neni, perkatesisht të të qenit të semure nga semundje të caktuara, semundje psikike, semundje vartese (alkoolizem, narkomani dhe shfrytezim të substancave psikotrope dhe prekursive) behet në pajtim me Ligjin për mbrojtje shëndetësore.

#### Neni 146

(1) Të punesuarit në institucion për femije gjate mandatit të punes së tyre, detyrohen në menyre permanente të persosen profesionalisht në pajtim me nevojat e institucionit për femije.

(2) Menyren e persosjes profesionale të të punesuarve në institucionet për femije, e percakton ministri.

#### Neni 147

(1) Punetoret profesionale, edukatoret dhe bashkepunetoret profesionale në kopshtet publike për femije avancohen në tituj.

(2) Kuadrot profesionale nga paragrafi (1) i ketij neni, të cilet për here të pare punesohen në kopsht publik për femije janë me titull punetor profesional, edukator dhe bashkepunetor profesional.

(3) Punetori profesional në kopsht publik për femije mund të avancohet në titujt punetor profesional-mentor dhe punetor profesional-keshilltar.

(4) Edukatori në kopsht publik për femije mund të avancohet në titujt edukator-mentor dhe edukator-keshilltar.

(5) Bashkepunetori profesional në kopsht publik për femije mund të avancohet në titujt bashkepunetor profesional-mentor dhe bashkepunetor profesional-keshilltar.

#### Neni 148

(1) Për infermieret, edukatoret, punetoret profesionale dhe bashkepunetoret profesionale të cilet në realizimin e pu-

nes perkujdesese, edukativo-arsimore, shëndetësore dhe sociale nuk tregojne rezultate të mjaftueshme, organi perkatesisht institucioni ose institucioni i cili kryen mbikeqyrje në pajtim me kete ligj dhe keshilli i prinderve të kopshtit publik për femije/qendres publike për zhvillim të hershem të femijeve mund të ngrene iniciative te Keshilli drejtues për rishqyrtimin e aftësise së tyre për realizimin e obligimeve të punes.

(2) Iniciativa nga paragrafi (1) në kete nen, doemos duhet të permbaje arsyetim të shkaqeve për të cilat ngrihet.

(3) Nese e pranon iniciativen nga paragrafi (1) i ketij neni, keshilli drejtues te drejtori parashtron propozim për ngritje të procedures për konstatim të pergjegjesise disiplinore të personave nga paragrafi (1) i ketij neni.

(4) Procedura disiplinore në rastet nga paragrafi (3) i ketij neni, realizohet në pajtim me dispozitat e rregullave që kane të bejne me nepunesit publike.

#### Neni 149

(1) Gjate ndryshimit të vellimit të punes në institucion publik për femije që paraqiten për shkak të ndryshimeve në programe, organizimin e punes, numrin e grupeve dhe ndryshimeve tjera, marrëdhënia e punes e të punesuarve mund të ndryshohet nga marrëdhënie pune me kohe të pacaktuar me kohe të plote pune në marrëdhënie pune me kohe të pacaktuar me kohe më të shkurter se koha e plote e punes dhe anasjelltas.

(2) Të punesuarit e punesuar me kohe të pacaktuar pune në rast të ndryshimit të vellimit të punes në institucionin për femije për arsytet nga paragrafi (1) i ketij neni, prej një institucioni për femije mund të sistemohet në institucion tjetër për femije.

(3) Në rastet nga paragrafet (1) dhe (2) të ketij neni, institucioni lidh marrëveshje të re për punesim me të punesuarin.

#### Neni 150

Nepunesi publik në institucionin publik për femije është personalisht pergjegjes për kryerjen e puneve dhe detyrave të punes nga vendi i punes.

#### Neni 151

(1) Secili nepunes publik dhe person tjetër, në pajtim me ligj, ka të drejte të parashtraje iniciative për ngritje të procedures disiplinore kunder nepunesit publik në institucion publik për femije, e cila duhet të arsyetohet.

(2) Propozim për ngritje të procedures disiplinore kunder nepunesit publik parashtron nepunesi publik epror i drejtperdrejte, perkatesisht nepunesi pergjegjes ose drejtori i institucionit publik për femije.

#### Neni 152

(1) Propozimi për ngritje të procedures për konstatim të pergjegjesise disiplinore sipas rregulles i permban elementet në vijim:

- emrin personal të nepunesit publik me të cilin ka të beje propozimi për ngritje të procedures për konstatim të pergjegjesise disiplinore,

- vendin e punes në të cilin është i sistemuar nepunesi publik për të cilin është parashtruar propozimi,

- pershkrimin e veprimit/eve me të cilin është kryer shkelja e rendit të punes dhe disciplines ose mospermbushja e obligimeve të punes,

- shenimin e kualifikimit të veprimit nga alineja 3 me shenim konkret nese kjo sipas vleresimit paraqet shkelje më të lehte, perkatesisht më të rende të rendit të punes dhe disciplines ose mospermbushje të obligimeve të punes,

- kohen, menyren dhe vendin e kryerjes së veprimit me të cilin është kryer shkelja e rendit të punes dhe disciplines dhe mospermbushja e obligimeve të punes,

- pasojat që janë shkaktuar në rendin e punes dhe disiplinës dhe mospermbushja e obligimeve të punes,

- shenimin e deshmise/ve prej të cilave vertetohet sjellja e tille, perkatesisht deshmise që është plotesim i faktit se është kryer veprim i plote (shenim zyrtar, raport me shkrim, informacion, deklarata të deshmitareve etj.),

- theksim i emrit personal dhe emrit të personit i cili mund të fitohet në çilesi të deshmitarit,

- të dhena nese nepunesi publik për të cilin parashtrohet propozimi deri atehere është pergjigjur për shkelje të rendit të punes dhe disiplinës ose mospermbushje të obligimeve të punes në institucionin publik për femije dhe

- të dhena në lidhje me shperblime të meparshme të nepunesit publik.

(2) Në shtojce të propozimit të paragrafit (1) të ketij neni, parashtrohen deshmite që janë shenuar dhe dokumente tjera që sipas vleresimit të propozuesit janë me rendesi për rastin konkret.

#### Neni 153

(1) Drejtori i institucionit publik për femije formon komision për udheheqje të procedurës për shkelje disiplinore në afat prej tete ditësh nga dita e parashtrimit të propozimit për ngritje të procedurës disiplinore.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i ketij neni, perbehet prej tre anetareve edhe atë një nepunes publik epror i drejtperdrejt dhe dy nepunes publike prej të cileve njeri me grup të njejte të titujve si nepunesi publik kunder të cilit udhehiqet procedure disiplinore. Anetaret e Komisionit kane zevendes.

(3) Kryetari i komisionit nga paragrafi (1) i ketij neni, është nga rendi i nepunesve publike epror të drejtperdrejte, perkatesisht nepunesve publike pergjegjes.

(4) Komisioni nga paragrafi (1) i ketij neni, pas perfundimit të procedurës disiplinore i propozon mase disiplinore perkatese drejtorit të institucionit publik për femije.

(5) Nese komisioni nga paragrafi (1) i ketij neni, konstaton se nepunesi publik nuk është pergjegjes ose nuk janë permbushur kushtet për miratim të aktvendimeve për shqiptim të mases disiplinore i propozon drejtorit ta refuzoje propozimin, perkatesisht ta nderprese proceduren.

#### Neni 154

(1) Masat disiplinore kunder nepunesit publik në institucionin publik për femije i shqipton drejtori i institucionit, e pas raportit paraprak me shkrim nga nepunesi publik epror i drejtperdrejte.

(2) Para shqiptimit të mases disiplinore nepunesi publik njoftohet me shkrim për provat e raportit nga paragrafi (1) i ketij neni, që ekzistojne kunder tij dhe ai ka të drejte të jape pergjigje me goje ose me shkrim në afat që nuk mund të jete më i shkurter se tete dite.

(3) Nese nepunesi publik nuk deshiron ta pranoje njoftimin për provat në raportin nga paragrafi (1) i ketij neni, në afat prej tri ditësh, i njejt i do të publikohet në tabelen e shpalljeve në seline e institucionit publik për femije.

(4) Drejtori i institucionit publik për femije në afat prej 60 ditësh nga dita e fillimit të procedurës miraton aktvendim për shqiptim të mases disiplinore.

#### Neni 155

Kunder aktvendimit për shqiptim të mases disiplinore, nepunesi publik në institucionin publik për femije ka të drejte ankese në afat prej tete ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit te Agjencia për Administrate.

#### Neni 156

(1) Nepunesi publik në institucionin publik për femije është pergjegjes për demin të cilin në pune ose në lidhje me punen me qellim ose nga pakujdesia e skajshme ia ka shkaktuar institucionit.

(2) Drejtori i institucionit formon komision për percaktimin e pergjegjesine materiale të nepunesit publik.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i ketij neni, perbehet prej kryetarit dhe dy anetareve prej të cileve një është nepunes publik, ndersa një është perfaqesues i sindikates dhe zevendesit e tyre. Kryetari i komisionit është nepunes publik epror i drejtperdrejte ose nepunes publik i cili nuk është me titull më të ulet se titulli i nepunesit publik kunder të cilit udhehiqet procedure për pergjegjesi materiale.

(4) Komisioni nga paragrafi (2) i ketij neni, e percakton pergjegjesine materiale për dem material të shkaktuar, lartesine e tij dhe menyren e shkaktimit, kush e ka shkaktuar demin dhe kush do ta kompensoje.

(5) Komisioni nga paragrafi (2) i ketij neni, parashtron raport për situaten e konstatuar faktike në baze të të cilit drejtori i institucionit publik miraton aktvendim për kompsim të demit.

#### Neni 157

Propozim për ngritje të procedurës për percaktimin e pergjegjesise materiale kunder nepunesit publik në institucionin publik për femije parashtron nepunesi publik epror i drejtperdrejte ose drejtori i institucionit.

#### Neni 158

Kunder aktvendimit nga neni 156 paragrafi (5) i ketij ligji, nepunesi publik në institucionin publik për femije ka të drejte të paraqese ankese te Agjencia për Administrate në afat prej tete ditësh nga dita e dorezimit të aktvendimit.

#### Neni 159

Nepunesi publik në institucionin publik për femije në baze të percjelljes së vazhdueshme të punes vleresohet nga nepunesi publik epror i drejtperdrejte në institucion, perkatesisht nga nepunesi publik pergjegjes.

#### Neni 160

Vleresimi i nepunesit publik në institucionin publik për femije behet me qellim që të fitohet pasqyre reale për profesionalitetin, kualitetin, efikasitetin dhe efektivitetin në kryerjen e puneve me interes publik të percaktuara me ligj.

#### Neni 161

Vleresimi i nepunesit publik në institucionin publik për femije behet në baze të të dhenave për rezultatet e punes dhe kualiteteve personale duke i pasur parasysht të dhenat për trajnimet, shperblimet, masat disiplinore dhe mungesat gjate vitit paraprak.

#### Neni 162

Gjate vleresimit të rezultateve të punes, behet vleresimi i njohurive dhe zbatimi i rregullave dhe praktikave, permbushja e qellimeve të punes, kryerja me kohe e punes, kryerja kualitative e punes dhe organizimi i punes në institucionin publik për femije.

#### Neni 163

Gjate vleresimit të kualiteteve personale behet vleresimi i kreativitetit, iniciatives, interesimit për punen, aftesise për pune ekipore, aftesise për punen nën presion dhe shkathtesite komunikuese.

#### Neni 164

Vleresimi behet në menyre objektive dhe të paanshme, pa ndikim dhe pa presion nga nepunesit publike eprorë të drejtperdrejte në institucionin publik për femije mbi vleresuesin.

## Neni 165

Vleresimi realizohet si proces i vazhdueshëm gjashtëmujor i vleresimit të rezultateve të punës dhe kualiteteve personale të personit të vlerësuar, i cili përfshin:

- përcaktim të qëllimeve të punës dhe aktiviteteve,
- përcjellje dhe grumbullim të të dhënave në punën e nepunesit publik në institucionin publik,
- dhenie të instruksioneve dhe keshillave për përmirësim të punës dhe
- interviste me nepunesin publik.

## Neni 166

(1) Vlerësuesi gjatë periudhës për vlerësim, rregullisht e përcjelle punën e nepunesit publik në institucion dhe grumbullon të dhëna që janë me rëndësi thelbësore për vlerësimin.

(2) Përcjellja dhe grumbullimi i të dhënave nenkupton kontroll dhe evidentim të kualitetit dhe kuantitetit në realizimin e detyrave të punës.

(3) Gjate përcjelljes së punës, vlerësuesi rregullisht e motivon nepunesin publik në institucion dhe i jep instruksione dhe keshilla për përmirësim të punës, i sugjeron për detaje konkrete në punë, procedurat që çojnë drejt punës së suksesshme dhe mangësitë në punën e tij.

## Neni 167

Gjate vlerësimit të punës së nepunesit publik në institucion zbatohet formular për vlerësim të nepunesit publik në pajtim me rregullat që kanë të bëjnë me nepunesit publike.

## XII. ORGANIZIMI DHE PERMBAJTJA E VEPRIMTARISE SË INSTITUCIONEVE PËR PERKUJDESJE DHE EDUKIM TË FEMIJEVE TË MOSHES PARASHKOLLORE

## Neni 168

(1) Edukimi parashkollor si pjesë integrale e sistemit për perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshës parashkollore realizohet nëpërmjet Programit vjetor për punën e institucioneve për femije që kryejnë punë në lidhje me perkujdesjen dhe edukimin e femijeve të moshës parashkollore.

(2) Programi vjetor për punë përmban vecanerisht: organizimin dhe kohën e punës së kopshtit për femije, perkatesisht qendres për zhvillim të hershem të femijeve, programet e kopshtit për femije, perkatesisht qendres për zhvillim të hershem të femijeve, sistemin e femijeve në grupe, punën e drejtorit dhe punetoreve profesionale dhe të tjera, bashkëpunimin me prinderit, bashkëpunimin me institucione edukative – arsimore, sportive, shëndetësore, kulturore, shkencore dhe të tjera, fondacione, shoqata, aktivitete për përfshirjen e femijeve në kopshtin për femije, perkatesisht në qendrën për zhvillim të hershem të femijeve, trajnimin permanent profesional të të punësuarve, punën e organeve profesionale dhe punë tjera për realizimin e veprimtarisë.

(3) Programi vjetor për punë miratohet më së voni deri më 30 shtator në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(4) Programin vjetor për punë e përpilojnë organet profesionale të personave juridike që kryejnë veprimtari në suaza të sistemit për perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshës parashkollore, në baze të mendimit nga keshilli prinderor.

(5) Puna edukativo-arsimore në kopsht për femije, perkatesisht në qendër për zhvillim të hershem të femijeve kryhet sipas Programit për mesim të hershem dhe zhvillim që bazohet në Standarde për mesim të hershem dhe zhvillim, të cilin e përpilon Byroja për Zhvillim të Arsimit, ndërsa e miraton ministri.

(6) Me Programin për mesim të hershem dhe zhvillim nga paragrafi (5) i këtij neni, përcaktohen vecanerisht bazat teorike dhe principet, qëllimet e programit, shembuj të aktiviteteve, rezultatet e pritura dhe bashkëpunimi me prinderit.

(7) Programi për mesim të hershem dhe zhvillim nga paragrafi (5) i këtij neni, duhet të jetë në pajtim me kapacitetet zhvillimore të femijeve të moshës parashkollore, të bazohet në nevojat dhe interesat për mesim të hershem dhe zhvillim të femijeve dhe të jetë i orientuar drejt arritjes së plote të potencialeve zhvillimore të secilit femije, duke përfshirë edhe femijet me nevoja të vecanta për mesim të hershem në pajtim me Standardet për mesim të hershem dhe zhvillim.

(8) Programi nga paragrafi (5) i këtij neni, ndryshohet në pajtim me rezultatet e përcjelljes dhe vlerësimit të arritjeve zhvillimore të femijet të bazuara në Standardet për mesim të hershem dhe zhvillim.

(9) Në kopsht për femije dhe qendër për zhvillim të hershem të femijeve organizohen edhe aktivitete tjera institucionale për përmbushjen e interesave specifike të femijes në drejtim të forçimit të personalitetit të femijes me zhvillimin e aftësive të tij trupore, intelektuale, kulturore e të tjera, të cilat realizohen në pajtim me programe të vecanta të cilat i miraton drejtori i kopshtit për femije sipas propozimit të ekipit të ekspertëve, ndërsa i miraton keshilli drejtues i kopshtit për femije, perkatesisht i qendres për zhvillim të hershem të femijeve.

(10) Aktivitete institucionale nga paragrafi (9) i këtij neni, janë programe të specializuara dhe realizohen në pajtim me mundësitë e institucioneve për femije që kryejnë veprimtari në suaza të sistemit për perkujdesje dhe edukim të femijeve dhe prinderve, si dhe njesive të vetadministrimit lokal.

(11) Themeluesi i kopshtit privat për femije mund të përpilojë edhe program të vet për perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshës parashkollore, i cili miratohet nga ministri, pas marrjes paraprake të mendimit nga Byroja për Zhvillim të Arsimit.

(12) Kur puna edukativo-arsimore në kopsht për femije/qendër private për zhvillim të hershem të femijeve zhvillohet sipas principeve dhe parimeve Steiner, Decroly, Montessori etj., ministri jep mendim pozitiv, pas konstatimit paraprak të pranueshmërisë së programit të organizatës perkatese ndërkombetare nga Byroja për Zhvillim të Arsimit.

## Neni 169

(1) Në përberje të kopshtit për femije/qendres publike për zhvillim të hershem të femijeve mund të formohet keshillimorë për femije dhe prinder.

(2) Kriteret e përafërta për formim dhe punë të keshillimorës, i përcakton ministri.

## Neni 170

(1) Praktika pedagogjike-metodike e studenteve realizohet në kopsht për femije/qendër publike për zhvillim të hershem të femijeve si dhe në kopsht për femije në kuader të institucionit të lartë arsimor për arsimimin e kuadrit profesional për arsim parashkollor në funksion të realizimit sa më të suksesshem të veprimtarisë praktike të fakultetit.



(2) Menyren e punes dhe sigurimin e kushteve për realizimin e praktikës pedagogjike metodike të studenteve nga studimet perkatese për arsim parashkollor dhe fakultete të tjera perkatese nga paragrafi (1) të ketij neni, i percakton ministri.

Neni 171

(1) Në kopsht publik për femije/qender publike për zhvillim të hershem të femijeve mund të parashikohen mundesi për zbatim të permbytjeve të reja edukative-arsimore, formave, metodave dhe mjeteve të reja.

(2) Kopshtin publik për femije/qendren publike për zhvillim të hershem të femijeve ku do të shihen mundesite nga paragrafi (1) i ketij neni, e percakton ministri.

Neni 172

(1) Kopshti për femije/qendra për zhvillim të hershem të femijeve me qellim të ruajtjes dhe perparimit të shendetit të femijeve e percjelle gjendjen shendetesore të perditshme të femijeve, bashkepunon me institucione perkatese për mbrojtje shendetesore të femijeve dhe realizon masa parandaluese për mbrojtjen e shendetit të femijeve.

(2) Kopshti për femije/qendra për zhvillim të hershem të femijeve e ka për obligim që në rast se paraqitet crregullim i gjendjes shendetesore normale ta njoftoje prindin e femijes, ndersa në rast të numrit më të madh të femijeve të semur, menjehere t'i njoftoje institucionin shendetesor kompetent dhe Ministrine.

Neni 173

(1) Në institucion për femije perdoren doracake si materiale edukative-arsimore për realizimin e aktiviteteve nga kuadri edukativ perkujdeses, si dhe revista për femije të cilat jane në funksion të aktiviteteve të njejta.

(2) Pjesetaret e bashkesive të cilet aktivitetet edukative-arsimore i realizojne në gjuhen e pjesetareve të bashkesive tjera, shfrytezojne doracake dhe revista për femije në gjuhen e bashkesive perkatese.

(3) Aktvendim për miratim dhe perdorim të doracakeve dhe revistave për femije miraton ministri, pas mendimit paraprak të Sherbimit pedagogjik.

Neni 174

(1) Institucioni i cili kryen veprimtari në kuader të sistemit për perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshes parashkollore ka plan zhvillimor.

(2) Planin zhvillimor i institucionit eshte plan strategjik për zhvillim i cili i permban prioritete për realizimin e veprimtarise së institucionit i cili kryen veprimtari në sistemin e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve të moshes parashkollore, planin dhe bartesit e aktiviteteve.

(3) Planin zhvillimor e perpilon organi udheheqes për periudhe prej tre deri në pese vjet, ndersa e miraton keshilli drejtues.

(4) Indikatorët për vleresimin e suksesit të aktiviteteve të planifikuara nga plani zhvillimor nga paragrafi (1) i ketij neni, i percakton ministri.

**XIII. KOMISIONI PËR LICENCIM TË PERSONAVE PROFESIONALE NË SISTEMIN PËR PERKUJDESJE DHE EDUKIM TË FEMIJEVE TË MOSHES PARASHKOLLORE DHE TË DREJTOREVE TË INSTITUCIONEVE PËR FEMIJE**

Neni 175

Ministria formon komision për leshimin, perteritjen, vazhdimin dhe heqjen e licencave për pune të personave të cilet jane të perfshire në sistemin e perkujdesjes dhe eduki-

mit të femijeve të moshes parashkollore, të drejtoreve të institucioneve si dhe personave të cilet jane të interesuar të perfshihen në sistemin e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve të moshes parashkollore.

Neni 176

Komisioni nga neni 175 i ketij ligji, perbehet prej trembejhete anetaresh edhe atë nga: Ministria e Punes dhe Politikes Sociale-kater anetare, Ministria e Arsimit dhe Shkences-dy anetare, Ministria e Financave-një anetar, Fakulteti i Mjekesise-një anetar, Byroja për Zhvillim të Arsimit-dy anetare dhe nga fakultetet e institutet e shkencave shoqerore humanitare-tre anetare.

Neni 177

(1) Komisioni nga neni 175 i ketij ligji, kryen licencimin e: drejtoreve të institucioneve për femije; punetoreve profesionale, bashkepunetoreve profesionale, edukatoreve dhe infermiereve në institucione për perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshes parashkollore; personave fizike të cilet kryejne pune të caktuara nga veprimtaria për perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshes parashkollore; personave të punesuar në agjencite për dhenie të sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore, si dhe personave të cilet jane të interesuar të inkuadrohen në sistemin e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve të moshes parashkollore.

(2) Komisioni për licencim e bën kontrollimin e zbatimit të njohurive profesionale.

(3) Ministri me propozim të Komisionit për licencim ua leshon, perterin, vazhdon dhe heq licencat për pune personave nga paragrafi (1) i ketij neni.

(4) Kunder vendimit të ministrit për licence të punes të leshuar, të vazhduar, të perterire dhe të hequr mund të parashtrahet ankese te Komisioni Shtetror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte.

Neni 178

(1) Ministri i leshon llojet e licencave për pune, si vijojne:

- licence për punetor profesional,
- licence për bashkepunetor profesional,
- licence për edukator,
- licence për infermier dhe
- licence për drejtor.

(2) Personat nga neni 177 paragrafi (1) i ketij ligji, mund të marrin licence perkatese për pune nga paragrafi (1) i ketij ligji, nese kane:

1) licence për punetor profesional diplome për arsim të kryer perkates nga neni 134 paragrafi (2) i ketij ligji dhe nese me sukses e kane kaluar kontrollin e zbatimit të njohurise profesionale nga Komisioni për Licencim;

2) licence për bashkepunetor profesional diplome për arsim të kryer perkates nga neni 134 paragrafi (7) i ketij ligji dhe nese me sukses e kane kaluar kontrollin e zbatimit të njohurise profesionale nga Komisioni për Licencim;

3) licence për edukator diplome për arsim të kryer perkates nga neni 132 paragrafet (3), (4) dhe (5) të ketij ligji dhe nese me sukses e kane kaluar kontrollin e zbatimit të njohurise profesionale nga Komisioni për Licencim dhe

4) licence për infermier diplome për arsim të kryer kattervjecar dhe nese me sukses e kane kaluar kontrollin e zbatimit të njohurise profesionale nga Komisioni për Licencim.

(3) Licence për infermier nga paragrafi (1) alineja 4 e ketij neni, marrin personat fizike për kryerje të puneve të caktuara nga veprimtaria perkujdesje dhe edukim të femijeve

ve si veprimtari profesionale nga neni 87 paragrafi (3) i ketij ligji, nese me sukses e kane kaluar kontrollin e zbatimit të njohurise profesionale nga Komisioni për licencim, si dhe për persona të punesuar, perkatesisht të angazhuar në agjenci për dhenie të sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore, nese kane të kryer së paku arsim të mesem dhe nese me sukses e kane kaluar kontrollin për zbatim të njohurise profesionale nga Komisioni për Licencim.

(4) Drejtoret e institucioneve për femije, si dhe personat e interesuar për të marre licence për drejtor të institucionit për femije mund të marrin licence për pune nese kane:

- diplome për arsim të larte të kryer perkates nga neni 120 paragrafi (2), perkatesisht neni 120 paragrafi (3) të ketij ligj, varesisht nga lloji i veprimtarise së institucionit për femije dhe

- trajnim për drejtor prej së paku 40 oreve të realizuar në pajtim me Programin për pune të Komisionit për Licencim.

(5) Licencat nga paragrafet (2), (3) dhe (4) të ketij neni, leshohen për periudhe prej pese vitesh.

#### Neni 179

Personit nga neni 177 paragrafi (1) të ketij ligji, mund t'i vazhdohet (perterihet) licenca për pune nese në periudhen e vlefshmerise së licences ka ndjekur së paku: 40 orë edukim për drejtor të institucionit për femije; 20 orë edukim për punetor profesional, bashkepunetor profesional dhe edukator; 10 orë edukim për infermier, për person fizik i cili kryen pune të caktuara nga veprimtaria perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshes parashkollore në shtepine e vet dhe në shtepine e prinderve të femijes dhe person i punesuar, perkatesisht i angazhuar në agjenci për dhenie të sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore, të realizuar në pajtim me Programin për pune të Komisionit për licencim, dhe nese pas kontrollit të kryer Komisioni për licencim konstaton se personi me sukses e zbaton njohurine profesionale.

#### Neni 180

Personit nga neni 177 paragrafi (1) i ketij ligji, i hiqet licenca për pune, nese:

- Komisioni për Licencim pas kontrollit të kryer konstaton se personi nuk e zbaton njohurine profesionale,

- i eshte hequr ose kufizuar aftesia afariste,

- i eshte shqiptuar denim ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarise ose detyres dhe

- i eshte shqiptuar denim me vendim të plotfuqishem gjyqesor me të cilin eshte denuar për veper penale për dhune familjare, marrje të personit të mitur, neglizhence ose abuzim të personit të mitur ose incest, për veper penale nga grupi i veprave kunder lirise gjinore, pa marre parasysh sanksionin e shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin eshte konstatuar sjellje diskriminuese.

#### Neni 181

Personi profesionist së paku tre muaj para kalimit të vlefshmerise së licences për pune paraqet kerkese te Komisioni për licencim për perteritjen, perkatesisht vazhdimin e licences për pune.

#### Neni 182

(1) Komisioni për licencim miraton program dhe rregullore për pune.

(2) Komisioni për licencim miraton kodeks për persona profesioniste në sistemin e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve të moshes parashkollore.

(3) Shpenzimi për leshimin, vazhdimin dhe perteritjen e licences për pune eshte në barre të personit profesional dhe eshte në lartesi prej 1 400 denare për drejtor, 950 denare për punetor profesional, bashkepunetor profesional dhe edukator; 450 denare për infermier, për person fizik i cili kryen pune të caktuara nga veprimtaria perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshes parashkollore në shtepine e vet dhe në shtepine e prinderve të femijes dhe person të punesuar, perkatesisht të angazhuar në agjencite për dhenien e sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore, të harmonizuara me rritjen e harxhimeve për jete për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shteteror i Statistikes në janar për vitin rrjedhes.

(4) Shpenzimi për leshimin, vazhdimin dhe perteritjen e licencave për pune të personave të cilet jane të interesuar që të perfshihen në sistemin për perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshes parashkollore eshte në perputhje me lartesine e percaktuar në paragrafin (3) të ketij neni varesisht nga lloji i licences.

(5) Menyren e leshimit, vazhdimit, perteritjes dhe heqjes së licences për pune të personave nga neni 177 paragrafi (1) i ketij ligji, menyren e zbatimit të trajnimeve, si dhe formen dhe permbajtjen e formularit, i percakton ministri.

### XIV. FINANCIMI I SISTEMIT PËR MBROJTJEN E FEMIJEVE

#### Neni 183

(1) Mjetet për financimin e mbrojtjes së femijeve sigurohen nga Buxheti i Republikes së Maqedonise.

(2) Me mjetet nga paragrafi (1) i ketij neni, financohen:

- të drejtat për mbrojtjen e femijeve,

- veprimtaria e institucioneve publike për femije të themeluara nga Qeveria,

- ndertimi, mirembajtja dhe pajisja e objekteve të institucioneve publike për femije të themeluara nga Qeveria dhe

- aktivitete programore në forma të caktuara të perparimit dhe zhvillimit të veprimtarise e të tjera.

(3) Me mjetet për financimin dhe mbrojtjen e femijeve menaxhon dhe disponon Ministria.

(4) Shperndarjen e mjeteve në institucione publike për femije të themeluara nga Qeveria i kryen ministri me aktvendim.

(5) Kriteret më të peraferta dhe menyren e shperndarjes së mjeteve sipas shfrytzesve nga paragrafi (4) i ketij neni i percakton ministri.

(6) Ministri me aktvendim mund ta nderprese dhe të kerkoje kthim të mjeteve të ndara nese ato shfrytzezohen në kundershmit me dedikimin për të cilin jane dhene.

(7) Mjetet për financim të mbrojtjes së femijeve sigurohen edhe nga buxheti i komunes, buxhetet e komunave të Qytetit të Shkupit dhe buxheti i Qytetit të Shkupit në pajtim me dispozitat e ketij ligji.

(8) Me mjetet nga buxheti i komunes dhe buxheti i Qytetit të Shkupit, financohen:

- veprimtaria e pushimoreve publike për femije të themeluara nga komuna dhe Qyteti i Shkupit,

- ndertimi, mirembajtja dhe pajisja e objekteve të pushimoreve publike për femije dhe

- aktivitete programore në forma të caktuara për perparimin dhe zhvillimin e veprimtarise e të tjera.

(9) Me mjetet nga buxheti i komunes dhe buxhetet e komunave të Qytetit të Shkupit financohen:

- veprimtaria e kopshteve publike për femije/qendrave publike për zhvillim të hershem të femijeve,

- ndertimi, mirembajtja dhe pajisja e objekteve të pushimoreve publike për femije dhe

- aktivitete programore në forma të caktuara për perparimin dhe zhvillimin e veprimtarise e të tjera.

## Neni 184

(1) Mjetet nga Buxheti i i Republikes së Maqedonise për financimin për mbrojtjen e femijeve sigurohen në baze të Programit për zhvillim të veprimtarise për mbrojtjen e femijeve.

(2) Mjetet nga Buxheti i Komunes, buxhetet e komunave të Qytetit të Shkupit dhe buxheti i Qytetit të Shkupit për financimin e mbeshtetjes së femijeve sigurohen në baze të programit zhvillimor për mbrojtjen e femijeve të komunës, të komunave të Qytetit të Shkupit në procedurën e percaktuar me Ligjin për financimin e njesive të vetadministrimit lokal dhe me kete ligj.

(3) Mjetet për financimin e kopshteve publike për femije sigurohen nga Buxheti i Republikes së Maqedonise në menyren dhe procedurën e percaktuar me ligj.

(4) Mjetet nga paragrafi (3) i ketij neni, u shperndahen komunave dhe komunave të Qytetit të Shkupit nepermjet bllok dotacioneve në pajtim me ligjin.

(5) Komuna dhe komuna e Qytetit të Shkupit mjetet nga paragrafi (4) i ketij neni, ua shperndan kopshteve publike për femije në rajonin e tyre për sigurim të realizimit të perkujdesjes dhe edukimit të femijeve të moshes parashkollore në pajtim me standardet dhe normativat e percaktuara për kryerjen e veprimtarise në pajtim me kete ligj.

(6) Komuna dhe komunat e Qytetit të Shkupit mund ta plotesoje bllok dotacionin e marre, për ngritjen e standardit dhe kualitetit të subjekteve dhe sherbimeve të kopshteve publike për femije me mjete nga burime personale të buxhetit të komunës dhe buxhetit të komunës së Qytetit të Shkupit.

## Neni 185

(1) Mjetet për financimin e mbrojtjes së femijeve mund të sigurohen edhe nga fondacione, dhurata, legate, testamente, mjete në baze të solidaritetit të ndryshem në para dhe nature dhe burime tjera në pajtim me ligjin.

(2) Mjetet nga paragrafi (1) i ketij neni, shfrytezojen me dedikim.

## Neni 186

(1) Institucioni publik për femije mund të siguroje mjete edhe nga:

- shfrytezesit,
- shitja e prodhimeve personale dhe sherbimeve dhe
- burime të tjera në pajtim me ligjin.

(2) Institucioni publik për femije mund të realizoje mjete edhe në baze të kryerjes së llojeve dhe formave tjera, perkatesisht me kryerjen e sherbimeve me kualitet më të larte nga ai i percaktuar me standardet dhe normativat nga neni 100 paragrafi (3) i ketij ligji.

(3) Dallimi në cmimin e sherbimit me kualitet më të larte i percaktuar në paragrafin (2) të ketij neni, eshte në barre të prindit - shfrytezes të sherbimit.

## Neni 187

(1) Institucioni publik për femije me akt të pergjithshem e rregullon menyren e marrjes dhe shperndarjes së mjeteve në baze të kryerjes së sherbimeve me kualitet më të larte dhe shitjes së prodhimeve personale.

(2) Institucioni publik për femije, mjetet e marra në baze të paragrafit (1) të ketij neni, i vecon në llogari të vecante për të hyra personale.

(3) Për aktin e paragrafit (1) të ketij neni pelqim jep Ministria për institucion publik për femije të themeluar nga Qeveria, ndersa keshilli i komunës dhe i Qytetit të Shkupit për institucionin publik për femije të themeluar nga komunat dhe Qyteti i Shkupit, perkatesisht keshilli i komunës dhe komunës së Qytetit të Shkupit për kopsht publik për femije.

## Neni 188

Institucioni privat për femije realizon të hyra nga:  
- arketimi i sherbimeve nga shfrytezesit dhe  
- burime të tjera në pajtim me ligjin.

## Neni 189

Personi fizik i cili në menyre të pavarur kryen pune të caktuara nga veprimtaria perkujdesje dhe edukim të femijeve, si dhe veprimtaria profesionale dhe agjencia për dhenen e sherbimeve për ruajtjen dhe perkujdesjen e femijeve të moshes parashkollore në pajtim me nenet 75 dhe 84 të ketij ligji, realizojne të hyra nga arketimi i sherbimeve nga shfrytezesit.

## Neni 190

Institucioni publik për femije merr mjete për pune me realizimin e programit vjetor për pune në të cilin eshte percaktuar lloji, vellimi, permbajtja dhe kualiteti i sherbimeve, si dhe në baze të cmimeve të percaktuara të vecanta.

## Neni 191

(1) Cmimet e sherbimeve që i jep institucioni publik për femije i themeluar nga Qeveria dhe shumen e kompensimit të shpenzimeve për qendrim në institucionin për femije që eshte në barre të prinderve, femijet e të cileve i shfrytezojne sherbimet e tyre, i percakton ministri.

(2) Cmimet e sherbimeve që i jep institucioni publik për femije të themeluar nga komuna dhe Qyteti i Shkupit, perkatesisht nga komuna dhe komuna e Qytetit të Shkupit dhe shumen e kompensimit të shpenzimeve për qendrim në institucionin publik për femije që eshte në barre të prinderve, femijet e të cileve i shfrytezojne sherbimet e tyre, i percakton keshilli i themeluesit me propozim të keshillit drejtuës në institucionin publik për femije.

(3) Baze për pagim të prinderve eshte cmimi i programit në të cilin eshte i perfshire femija.

(4) Me standardet dhe normativat për kryerjen e veprimtarise do të percaktohen normativat, matesit dhe kriteret për percaktimin e kompensimit - cmimi i sherbimeve të institucionit publik për femije.

(5) Cmimet e sherbimeve për kualitet më të larte sesa ai i percaktuar me standardet dhe normativat i percakton institucioni për femije me pelqim paraprak të ministrit për institucion publik për femije të themeluar nga Qeveria, ndersa keshilli i komunës dhe i Qytetit të Shkupit për institucion publik për femije të themeluar nga komuna dhe Qyteti i Shkupit, perkatesisht keshilli i komunës dhe i komunës në Qytetin e Shkupit.

(6) Cmimet e sherbimeve në institucionet private për femije i percakton themeluesi.

(7) Cmimet e sherbimeve të cilat i japin personat fizike të cilet kryejne pune nga veprimtaria perkujdesje dhe edukim i femijeve si veprimtari profesionale, i percakton personi fizik.

(8) Cmimet e sherbimeve të cilat i jep agjencia për dhenen e sherbimeve për ruajtjen dhe perkujdesjen e femijeve të moshes parashkollore, i percakton themeluesi.

## Neni 192

(1) Ministria në institucionin publik për femije kryen kontroll të të dhenave të cilat institucioni publik i dorezon në ministri, si dhe të ligjshmerise dhe rregullshmerise së shfrytezimit të mjeteve nga Buxheti i Republikes së Maqedonise dhe mjeteve të siguruar nga burime të tjera.

(2) Keshilli i komunës dhe keshilli i Qytetit të Shkupit, perkatesisht keshilli i komunave dhe keshilli i komunave të Qytetit të Shkupit kryen kontroll të ligjshmerise dhe rregullshmerise së shfrytezimit të mjeteve nga buxheti i themelesit të institucionit publik për femije dhe mjeteve të siguruar nga burime të tjera.

XV. REGJISTRI I PERSONAVE JURIDIKE DHE PERSONAVE FIZIKE, QË KRYEJNE VEPRIMTARI NË KUADER TË SISTEMIT PËR PERKUJDESJE DHE EDUKIM TË FEMIJEVE TË MOSHES PARASHKOLLORE, INSTITUCIONEVE PËR PUSHIM DHE REKREACION TË FEMIJEVE DHE LICENCAVE PËR PUNE DHE EVIDENCA TJERA

## Neni 193

(1) Ministria i mban keto lloje të regjistrave:  
1) Regjistrin qendror të institucioneve për femije,  
2) Regjistrin e agjencive për dhenien e sherbimeve për ruajtjen dhe perkujdesjen e femijeve të moshes parashkollore,

3) Regjistrin e personave fizike të cilet në menyre të pavarur kryejne pune të percaktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve si veprimtari profesionale dhe

4) Regjistrin e licencave për pune të leshuara, të pertertura, të vazhduara dhe të hequra.

(2) Regjistrat nga paragrafi (1) i ketij neni, paraqesin baze unike të të dhenave të personave juridike dhe personave fizike të cilet kryejne veprimtari në kuader të sistemit për perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshes parashkollore, dhe të institucioneve për pushim dhe rekreacion të femijeve dhe të të dhenave për licenca për pune.

(3) Komuna dhe komuna e Qytetit të Shkupit, për rajonin e tyre mbajne regjister për institucionet publike për femije të themeluar nga komuna dhe komunat e Qytetit të Shkupit dhe të dhenat nga regjistrimi i kryer në regjister i dorezojne në Ministri.

(4) Komuna dhe Qyteti i Shkupit, për rajonin e tyre mbajne regjister për institucionet publike për femije të themeluara nga komuna dhe Qyteti i Shkupit dhe të dhenat nga regjistrimi i kryer në regjister i dorezojne në Ministri.

(5) Agjencite për dhenien e sherbimeve për ruajtjen dhe perkujdesjen e femijeve të moshes parashkollore dhe personat fizike të cilet në menyre të pavarur kryejne pune të caktuara nga veprimtaria perkujdesje dhe edukim të femijeve si veprimtari profesionale dorezojne të dhena perkatese dhe dokumentacion për regjistrim në regjistrat nga paragrafi (1) pikat 2 dhe 3 të ketij neni.

(6) Formen, permbajtjen dhe menyren e mbajtjes së regjistrave nga paragrafet (1), (3), (4) dhe (5) të ketij neni, i percakton ministri.

## Neni 194

(1) Të dhenat që futen në regjister paraqesin informata të kualifikuara me shkalle të konfidences të percaktuar në pajtim me ligjin.

(2) Si informata të klasifikuara me shkalle të konfidences të percaktuar në pajtimin me ligjin, sipas ketij ligji, llogariten të dhenat e vecanta për persona juridike dhe fizike të cilet kryejne veprimtari në kuader të sistemit për perkujdesjen dhe edukimin e femijeve të moshes parashkollore që futen në regjister.

## Neni 195

(1) Në institucion për femije mbahet evidenca dhe dokumentacioni.

(2) Evidenca dhe dokumentacioni mbahet edhe për të drejtat për mbrojtje të femijeve.

(3) Menyren dhe mbajtjen e evidences dhe dokumentacionit, si dhe permbajtjen dhe formen e evidences dhe dokumentacionit, e percakton ministri.

(4) Në kopshtin për femije/qender për zhvillim të hershem të femijeve mbahet dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike për aktivitete edukative arsimore.

(5) Dokumentacioni pedagogjik sipas ketij ligji e perfshein librin kryesor të femijeve dhe paraqet dokument me vlerë të perhershme.

(6) Evidenca pedagogjike perfshein: ditarin për pune të kopshtit për femije/ qendres për zhvillim të hershem të femijeve, ditarin për pune të grupit edukues, planifikimin dhe pergatitjen e punes edukative arsimore dhe dosjen e femijes dhe ata mbahen në forme në leter dhe elektronike.

(7) Dokumentacioni pedagogjik në kopshtin për femije mbahet në gjuhen maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

(8) Për pjesetaret e bashkesive të cilet aktivitetet edukative-arsimore i realizojne në gjuhen e bashkesise perkatese, dokumentacioni pedagogjik mbahet në gjuhen maqedonase me perdorimin e alfabetit të saj cirilik dhe në alfabetin në të cilin realizohet aktiviteti edukativ-arsimor.

(9) Ditari për pune mbahet në gjuhen dhe alfabetin në të cilin realizohen aktivitetet edukative-arsimore.

(10) Formen, permbajtjen dhe menyren e mbajtjes së dokumentacionit pedagogjik dhe evidences, i percakton ministri.

## Neni 196

(1) Objekti ose pjesa e objektit të institucionit për femije me ose pa pajisje mund të jepet me qira në pajtim me ligjin, me ç'rast nuk guxon të rrezikohet dedikimi themelor dhe funksioni i objektit në periudhen e kohezgjatjes së qirase.

(2) Marreveshjen për qira e lidh ministri për institucionin publik për femije të themeluar nga Qeveria, kryetari i komunes ose kryetari i Qytetit të Shkupit për pushimore publike për femije të themeluar nga komuna dhe Qyteti i Shkupit, ndersa kryetari i komunes dhe kryetari i komunes në Qytetin e Shkupit për kopshtin publik për femije/qendren publike për zhvillim të hershem të femijes.

(3) Për marreveshjen nga paragrafi (2) i ketij neni, ministri e njofton Qeverine, ndersa kryetari i komunes dhe kryetari i Qytetit të Shkupit e njofton keshillin e komunes dhe Keshillin e Qytetit të Shkupit.

(4) Objekti ose pjesa e objektit të institucionit publik për femije me ose pa pajisje, që eshte dhene me qira nuk mund të jepet me nenqira.

## XVI. MBIKEQYRJA

## Neni 197

(1) Ministria kryen mbikeqyrje mbi zbatimin e ketij ligji.

(2) Ministria mund ta nderprese realizimin e aktit të pergjithshem të institucionit për femije nese nuk eshte në pajtim me Kushtetuten e Republikës së Maqedonise dhe ligjin dhe në afat prej 15 ditesh do të ngreje procedure në Gjykaten Kushtetuese të Republikës së Maqedonise për vleresim të kushtetutshmerise dhe ligjshmerise së tij.

(3) Ministria sipas të drejtes së mbikeqyrjes mund të shfuqizoje aktvendim perfundimtar për të drejtat për mbrojtje të femijeve të percaktuara me kete ligj, nese konstaton se me të eshte shkelur ky ligj.

(4) Pas shfuqizimit të aktvendimit nga paragrafi (3) i ketij neni, organi cili e ka miratuar aktvendimin, detyrohet që menjehere ta nderprese realizimin e tij.

## Neni 198

(1) Ministria ka të drejte dhe detyrim t'ia ndaloje personit juridik dhe fizik kryerjen e veprimtarise, nese në baze të mbikeqyrjes së realizuar, percakton se nuk plotesohen më kushtet e percaktuara për kryerjen e veprimtarise dhe veprimtaria kryhet në dëm të shfrytezuesve, ndersa mangesite e konstatuara personat juridike dhe fizike nuk i menjanon në afatin e percaktuar nga Ministria.

(2) Kunder aktvendimit për ndalim të kryerjes së veprimtarisë mund të dorezohet ankese në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

#### Neni 199

Pas plotfuqishmerise së aktvendimit nga neni 198 i ketij ligji, Ministria do t'i propozojë Qeverisë që ta heq lejen nga neni 107 paragrafi (1) i ketij ligji, ndërsa kur behet fjale për institucion publik të themeluar nga Qeveria do t'i propozojë miratim të vendimit për shuarje të institucionit publik për fëmijë, perkatesisht do t'i propozojë keshillit të komunes dhe Qytetit të Shkupit, miratim të vendimit për shuarje të pushimores publike për fëmijë të themeluar nga komunat ose Qyteti i Shkupit, perkatesisht keshillit të komunes dhe keshillit të Qytetit të Shkupit kur behet fjale për kopsht për fëmijë/qender publike për zhvillim të hershem të fëmijeve.

#### Neni 200

(1) Gjate kryerjes së mbikeqyrjes mbi punen e organeve të komunes, komunes së Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, Ministria në kuader të realizimit të mbikeqyrjes mbi zbatimin e ligjeve dhe rregullave nga mbrojtja e fëmijeve i kryen punet në vijim:

- e percjelle ligjshmerine e punes së organeve të komunes, komunes së Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit dhe merr masa dhe aktivite dhe ngre iniciative për realizimin e kompetencave të komunes dhe të Qytetit të Shkupit në pajtim me kete ligj,

- vlereson nese organet e komunes, komunes në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit sigurojne që kompetencat e komunes, komunave të Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, të realizohen në pajtim me standardet dhe procedurat e percaktuara me kete ligj,

- u sugjeron organeve të komunes, komunes së Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit për tejkalimin e kompetencave të tyre të percaktuara me kete ligj dhe me rregulle tjeter dhe u propozon masa perkatese për tejkalimin e gjendjes së tille,

- sugjeron për mangesi të caktuara materiale dhe procedurale në punen e organeve të komunes, komunes së Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, që do të mund ta pengojne kryerjen e puneve me interes publik nga sfera e mbrojtjes së fëmijeve me rendesi lokale,

- jep rekomandime për zbatimin konsekuent të kompetencave të komunes, komunes së Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit në kuader të ketij ligji me kerkese të organeve të komunes, komunes së Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit,

- e percjell miratimin në kohe të rregullave të komunes, komunes së Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit,

- miraton iniciative dhe propozime për komunën, komunën në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit nese konstaton moszbatim të ketij ligji si ndeshje e kompetencave ndermjet organeve të komunes, komunes së Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit,

- e percjelle ligjshmerine e aktvendimeve që kryetari i komunes i miraton në zgjidhjen e të drejtave të vecanta, obligimeve dhe interesave të personave fizike dhe juridike dhe merr masa në pajtim me kete ligj,

- jep mendim dhe ndihme profesionale me propozim të rregullave të komunes, komunes së Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit me kerkese të organeve të komunes, komunes së Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit,

- e percjelle realizimin e transparences në punen e organeve të komunes, të komunes së Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit në realizimin e kompetencave të tyre të percaktuara me kete ligj, në vecanti nga aspekti i njoftimit të rregullt, në kohe, të vertete dhe të plote të qytetareve,

- e percjelle realizimin e mbikeqyrjes paraprake të rregullave të komunes, të komunes së Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit dhe

- në kohe i njofton organet e komunes, të komunes së Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit për gjendjet e konstatuara në punen e tyre edhe për marrjen e masave gjate kryerjes së mbikeqyrjes.

#### Neni 201

(1) Nese edhe krahas sugjerimeve dhe masave dhe aktiviteve të ndermarra, organet e komunes, komunes së Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit nuk e sigurojne realizimin e puneve të cilat me kete ligj jane percaktuar si kompetence e saj edhe për realizimin e të cilave eshte pergjegjese komuna, komuna e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, me fuqi të ketij ligji i hiqet kryerja e kompetences perkatese.

(2) Kryerjen e puneve të hequra e merr Ministria, por më së shumti deri në një vit nga dita e marrjes së tyre.

(3) Ministria, kryerjen e puneve nga kompetenca e komunes, komunes së Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit i kryen në emer dhe për llogari të komunes dhe të Qytetit të Shkupit.

(4) Për kryerjen e puneve në kompetence të komunes, të komunes së Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit nga paragrafi (1) i ketij neni, njoftohet organi i administrates shtetërore kompetent për kryerjen e puneve në sferen e vetadministrimit lokal dhe organi i administrates shtetërore kompetent për kryerjen e puneve në sferen e financave.

#### Neni 202

(1) Mbi realizimin e puneve profesionale në veprimtari-n mbrojtje e fëmijeve behet mbikeqyrje profesionale.

(2) Me mbikeqyrjen e punes profesionale percaktohet nese puna profesionale për realizimin e mbrojtjes së fëmijeve bazohet në metoda bashkekohore, shkencore dhe profesionale dhe të arriturat e atij lloji të veprimtarise dhe nese ajo organizohet në menyre më të pershtatshme dhe më efikase.

(3) Me mbikeqyrjen e punes profesionale jepet edhe ndihme profesionale e drejtperdrejte.

#### Neni 203

(1) Mbikeqyrje mbi punen profesionale në realizimin, perkujdesjen, edukimin, qendrimin, kujdesin, ushqimin si dhe të masave dhe aktiviteve të percaktuara në kete ligj dhe pushimin dhe rekreacionin, kryen Ministria e Punes dhe Politikës Sociale, mbi realizimin e punes arsimore, Ministria e Arsimit dhe Shkences, ndërsa mbi mbrojtjen shendetesore, Ministria e Shendetesise.

(2) Mbikeqyrja mbi punen profesionale kryhet së paku një here në vit.

(3) Raporti për mbikeqyrjen e kryer për institucionin publik për fëmijë mbi punen profesionale dorezohet në afat prej 15 ditësh pas mbikeqyrjes së realizuar në institucionin në të cilin eshte kryer mbikeqyrja, në Ministrine dhe organin i cili ka dhene pelqim për udheheqjen e mbikeqyrjes, perkatesisht edhe themeluesit nese institucioni eshte privat ose i themeluar nga komuna dhe Qyteti i Shkupit, perkatesisht nga komuna dhe komuna në Qytetin e Shkupit, si dhe personit fizik dhe juridik i cili kryen pune të caktuara të veprimtarise perkujdesje dhe edukim të fëmijeve.

## XVII. MBIKEQYRJA INSPEKTUESE

#### Neni 204

Ministria kryen mbikeqyrje inspektuese mbi realizimin dhe zbatimin e ketij ligji dhe rregullat tjera që kane të bejne me mbrojtjen e fëmijeve, mbi institucionet për fëmijë, si dhe mbi personat tjere juridike dhe fizike të cilet kryejne

pune të caktuar nga veprimtaria perkujdesje dhe edukim të femijeve (në tekstin e metejme: veprimtaria).

## Neni 205

Mbikeqyrja inspektuese, perfshin:

- mbikeqyrje të zbatimit dhe realizimit të ketij ligji, si dhe të rregullave tjera dhe akteve të miratuara në baze të ketij ligji,

- mbikeqyrje të zbatimit të të drejtave për mbrojtjen e femijeve në qendrat për pune sociale dhe plotesimin e obligimeve të shfrytëzuesve, të percaktuara me kete ligj,

- mbikeqyrje të evidences, dokumentacionit dhe raporteve për pune për të drejtat për mbrojtjen e femijeve,

- mbikeqyrje të vlefshmerise së licencave për pune të personave të cilet jane perfshire në sistemin e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve të moshes parashkollore si dhe për vlefshmerine e licencave për pune të drejtoreve të institucioneve për mbrojtjen e femijeve,

- mbikeqyrje të plotesimit të kushteve të cilat kane të bejne me hapësirat, pajisjet, kuadrat, grupet, femijet, institucionet për femije, në kushte tjera hapësimore, në kushte shtepiake, në agjencite për dhenien e sherbimeve për ruajtjen dhe perkujdesjen e femijeve të moshes parashkollore si dhe të personave fizike të cilet kryejne pune të caktuara nga veprimtaria,

- mbikeqyrje të menaxhimit dhe udheheqjes me institucionin për femije të themeluar nga Qeveria dhe institucionet private për femije,

- mbikeqyrje të evidences, dokumentacionit dhe raporteve për pune të institucioneve, agjencive për dhenien e sherbimeve për ruajtjen dhe perkujdesjen e femijeve të moshes parashkollore, personave fizike të cilet kryejne pune të caktuara të veprimtarise dhe të kryeresve në veprimtarine për mbrojtjen e femijeve, pervec të evidences pedagogjike dhe dokumentacionit pedagogjik,

- realizim të programeve dhe standardeve të tjera të percaktuara dhe normativa me të cilat rregullohet veprimtaria në institucionet për femije, pervec në veprimtarine edukative-arsimore,

- kontroll të mjeteve të marra nga burime personale në institucionet për femije, të themeluara nga Qeveria,

- percjellje të perkujdesjes, qendrimit, kujdesit dhe ushqimit të femijeve gjate kohes së greves dhe

- mbikeqyrje të zbatimit të masave të shqiptuara gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese.

## Neni 206

(1) Mbikeqyrjen inspektuese e kryejne inspektore dhe nepunes tjere shtetore të autorizuar nga radhet e nepunesve shtetore në Ministri, të autorizuar për zbatimin e mbikeqyrjes inspektuese, me arsim të larte me shkalle VII/1 ose 240 kredi sipas SETK dhe së paku tre vjet pervoje pune, dhe t'i plotesojne kushtet e pergjithshme në pajtim me Ligjin për nepunes shtetore.

(2) Ministri e emerone inspektorin dhe autorizon nepunes tjetere shtetore në pajtim me kete ligj.

(3) Inspektori posedon legjitimacion zyrtar, si dhe dokument zyrtar me të cilin e deshmon cilesine zyrtare, identitetin dhe autorizimin për marrjen e puneve nga mbikeqyrja inspektuese.

(4) Formen dhe permbajtjen e formularit të legjitimacionit nga paragrafi (3) i ketij neni, menyren dhe leshimin e tyre, perdorimin, heqjen dhe evidencen për legjitimacionet e leshuara dhe të hequra, i percakton ministri.

(5) Gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese, inspektori detyrohet që ta tregojte legjitimacionin zyrtar.

## Neni 207

(1) Kryetari i komunes, i komunes së Qytetit të Shkupit, perkatesisht i Qytetit të Shkupit mund të autorizojte person nga administrata e komunes, perkatesisht e Qytetit të Shkupit për kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese, që i ploteson kushtet nga neni 206 i ketij ligji (në tekstin e metejme: person i autorizuar).

(2) Personi i autorizuar kryen mbikeqyrje të:

- procedures për themelimin dhe nderprerjen e punes së institucioneve publike për femije të themeluara nga komuna, komuna e Qytetit të Shkupit, perkatesisht Qyteti i Shkupit,

- kushteve të punes së institucioneve për femije të themeluara nga komuna, komuna e Qytetit të Shkupit, perkatesisht Qyteti i Shkupit,

- procedures për formimin e organeve administrative dhe të tjera në institucionet publike për femije, të themeluara nga komuna, komuna e Qytetit të Shkupit, perkatesisht Qyteti i Shkupit dhe

- kontrollit të mjeteve të marra nga burimet personale në institucione publike për femije të themeluara nga komuna, komuna e Qytetit të Shkupit, perkatesisht Qyteti i Shkupit.

(3) Nese kryetari i komunes, i komunes së Qytetit të Shkupit, perkatesisht i Qytetit të Shkupit nuk ka autorizuar person për kryerjen e puneve të percaktuara me kete ligj, ato i kryejne inspektore dhe nepunes të autorizuar shtetore nga Ministria në emer dhe për llogari të komunes, të komunes së Qytetit të Shkupit, perkatesisht të Qytetit të Shkupit, deri në autorizimin e personit nga administrata e komunes.

(4) Nese kryetari i komunes, i komunes së Qytetit të Shkupit, perkatesisht i Qytetit të Shkupit ka autorizuar person për kryerjen e puneve të percaktuara me kete ligj, e i njejti nuk i kryen, në atë rast ato i kryejne inspektore dhe nepunes të autorizuar shtetore nga Ministria në emer dhe për llogari të komunes, të komunes së Qytetit të Shkupit, perkatesisht të Qytetit të Shkupit.

(5) Personi i autorizuar posedon legjitimacion zyrtar, të cilin e leshon kryetari i komunes.

(6) Formen dhe permbajtjen e formularit të legjitimacionit nga paragrafi (5) i ketij neni, menyren dhe leshimin e tij, perdorimin, heqjen dhe evidencen për legjitimacionet e leshuara dhe të hequra, i percakton ministri.

## Neni 208

Proceduren e mbikeqyrjes inspektuese, inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetore, perkatesisht personi i autorizuar nga neni 207 i ketij ligji, e ngre dhe udheheq me detyre zyrtare, sipas dispozitave të ketij ligji, Ligjit për mbikeqyrje inspektuese dhe Ligjit për procedure të pergjithshme administrative.

## Neni 209

(1) Mbikeqyrja inspektuese kryhet permes mbikeqyrjes së rregullt, kontrolluese dhe të jashtezakonshme.

(2) Mbikeqyrja e rregullt inspektuese eshte mbikeqyrje e paralajmeruar që zbatohet në baze të programit vjetor, që e miraton Ministria, perkatesisht komuna / komuna e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, më së voni deri më 31 dhjetor në vitin rrjedhes, ndersa për vitin e ardhshem.

(3) Mbikeqyrja e jashtezakonshme inspektuese eshte mbikeqyrje e paparalajmeruar dhe zbatohet me detyre zyrtare, initiative të shfrytëzuesit të sherbimit, prindit, kujdestarit, keshillit prinderor, qytetarit, organit kompetent, organeve tjera dhe organizatave dhe personave të tjere juridike kur ka interes për femijet, qytetarin, interes të personave të trete ose interes të pergjithshem.

(4) Mbikeqyrja kontrolluese inspektuese realizohet pas kalimit të afatit të percaktuar nga inspektori dhe nepunesi i autorizuar zyrtar, perkatesisht personi i autorizuar për menjanimin e parregullsisve.

(5) Mbikeqyrja inspektuese mund të kryhet edhe nga më shumë sherbime inspektuese, njekohesisht si mbikeqyrje e perbashket inspektuese nese:

- kjo eshte e domosdoshme për menjanimin e rrezikut të drejtperdrejte mbi jeten ose shendetin e njerezve ose prones me vlere më të larte,

- kjo eshte e domosdoshme për marrjen e masave urgjente të cilat nuk durojne prolongim,

- kjo eshte e domosdoshme për nderlikueshmerine e mbikeqyrjes ose rendesine për menjanimin e parregullsisve,

- vleresohet se mbikeqyrja në kete menyre mund të kryhet më shpejte dhe me më pak shpenzime dhe humbje të kohes së subjektit të mbikeqyrjes dhe inspektoreve,

- kjo eshte e domosdoshme për shqyrtimin e provave në iniciativen ose ankesen, e kjo eshte në kompetence të dy ose më shumë organeve të administrates shtetore dhe

- në raste të tjera të percaktuara me ligj.

#### Neni 210

Mbikeqyrja e jashtezakonshme inspektuese nuk do të zbatohet nese nga iniciativa konstatohet se:

- procedura nuk ka perfunduar në menyre të plotfuqishme,

- paraprakisht për punen e njejte eshte kryer mbikeqyrje inspektuese,

- nga dokumentacioni i parashtruar eshte evidente se procedura eshte udhehequr në pajtim me ligjin dhe rregullat tjera dhe

- zbatimi i mbikeqyrjes inspektuese eshte në kompetence të organit tjetër.

#### Neni 211

Para se të filloje zbatimi i mbikeqyrjes së jashtezakonshme inspektuese, inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetor, perkatesisht personi i autorizuar në kuader të kompetencave të percaktuara me kete ligj, i merr keto aktivitete:

- sipas nevojës e therret propozuesin e kerkeses, perkatesisht iniciatives që t'i plotesoje me dokumentet e nevojshme ose më hollesisht t'i arsyetoje dhe

- bën vleresim profesional dhe kontroll të kompetences, obligimeve dhe pergjegjesive të institucionit, agjencise për dhenien e sherbimeve për ruajtjen dhe perkujdesjen e femijeve të moshes parashkollore dhe personave fizike të cilet kryejne pune të caktuara nga veprimtaria e mbrojtjes së femijeve.

#### Neni 212

(1) Inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetor, perkatesisht personi i autorizuar në kuader të kompetencave të percaktuara me kete ligj, e njofton personin udheheqes ose personin tjetër zyrtar për ardhjen e tij në institucion (qender për pune sociale, institucion për femije), agjencine për dhenien e sherbimeve për ruajtjen dhe perkujdesjen e femijeve dhe personat fizike që kryejne pune të percaktuar të veprimtarise.

(2) Me perjashtim nga paragrafi (1) i ketij neni, inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetor, perkatesisht personi i autorizuar në kuader të kompetencave të percaktuara me kete ligj në zbatimin e mbikeqyrjes inspektuese ka të drejte në çdo kohe, pa paralajmerim dhe leje të personit udheheqes të hyje në lokalet e institucionit (qender për pune sociale, institucion për femije), agjencise për dhenien e sherbimeve për ruajtjen dhe perkujdesje të femijeve dhe personave fizike të cilet kryejne pune të caktuara të veprimtarise.

(3) Gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese, inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetor, perkatesisht personi i autorizuar në kuader të kompetencave të percaktuara me kete ligj ka të drejte ta shqyrtoje objektin, lokalin (lokalet e punes dhe të tjera), librat afariste, regjistrat, evidencat, dokumentacionin, dokumentet dhe shkresat, t'i degjoje shfrytëzuesit, të punesuarit, si dhe personat tjere, ta percaktoje identitetin e personit me kontroll të dokumentit personal, perkohesisht ta konfiskoje dokumentacionin, lendet dhe shkresat tjera, ta percjelle zbatimin e masave të percaktuara për tejkalimin e parregullsisve të percaktuara, si dhe të marre masa tjera të percaktuara me kete ligj dhe në pajtim me kete ligj.

(4) Inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetor, perkatesisht personi i autorizuar e ka për obligim të veproje sipas ligjit, në kohe dhe në pajtim me Kodeksin etik të nepunesve shtetore dhe Kodeksin etik të sherbimit inspektues dhe ta ruaje sekretin e të dhenave të klasifikuara.

(5) Personi udheheqes ose personi tjetër i autorizuar i institucionit (qender për pune sociale, institucion për femije, agjenci për dhenien e sherbimeve për ruajte dhe perkujdesje të femijeve dhe persona fizike të cilet kryejne pune të caktuara nga veprimtaria, detyrohen që inspektorit dhe nepunesit të autorizuar shtetor, perkatesisht personit të autorizuar në kuader të kompetencave të percaktuara me kete ligj t'i sigurojne realizimin pa pengese të mbikeqyrjes inspektuese dhe t'i sigurojne dispozicion dhe kontroll të të gjitha mjeteve dhe dokumentacionit të nevojshem.

#### Neni 213

Për mbikeqyrjen e kryer inspektuese, gjendjen e konstatuar dhe masat e marra, perkatesisht të percaktuara dhe afatet për menjanimin e parregullsisve të percaktuara, inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetor, perkatesisht personi i autorizuar perpilon procesverbal.

#### Neni 214

(1) Nese gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetor, perkatesisht personi i autorizuar percakton se eshte kryer parregullsi nga nenet 225 dhe 228 të ketij ligji, inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetor, perkatesisht personi i autorizuar, detyrohet që të perpiloje procesverbal në të cilin do të percaktohet parregullsia e bere nga i punesuari i cili drejtperdrejt i kryen punet në zbatimin dhe implementimin e ligjeve dhe rregullave në sferen e mbrojtjes së femijeve me sugjerim për menjanimin e parregullsisve së konstatuar në afat prej te-te ditesh dhe dorezim të njekohshem të fteses për realizimin e edukimit për të punesuarin dhe subjektin ku eshte konstatuar parregullsia gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese.

(2) Formen dhe permbajtjen e fteses për edukim, si dhe menyren e zbatimit të edukimit, i percakton ministri.

(3) Edukimin e organizon dhe zbaton Ministria, perkatesisht komuna, komuna e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, në kuader të kompetencave të percaktuara me kete ligj, në afat jo më të gjate se 15 dite nga dita e zbatimit të mbikeqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të zbatohet për parregullsi të percaktuara të njejtja ose të ngjashme për një ose më shumë të punesuar të cilet drejtperdrejt i kryejne punet dhe persona fizike.

(5) Nese në terminin e caktuar i punesuari ose subjekti i cili zbaton edukim nuk paraqitet në edukim, do të llogaritet se edukimi eshte zbatuar.

(6) Nese i punesuari ose subjekti për të cilin zbatohet edukimi nuk paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen atë, do të llogaritet se eshte edukuar lidhur me parregullsinen e percaktuar.

(7) Nese inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetëror, perkatesisht personi i autorizuar gjate zbatimit të mbikeqyrjes kontrolluese konstato se jane menjanuar parregullsite e konstatuara nga paragrafi (1) i ketij neni, miraton konkluzion me të cilin e nderpret proceduren e mbikeqyrjes inspektuese.

(8) Nese inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetëror, perkatesisht personi i autorizuar gjate zbatimit të mbikeqyrjes kontrolluese konstato se nuk jane menjanuar parregullsite e konstatuara nga paragrafi (1) i ketij neni, parashtron kerkese për zbatimin e procedures kundervajtese në gjykatën kompetente.

(9) Ministria, perkatesisht komuna, komuna e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit mban evidence për edukimin e zbatuar.

(10) Permbajtjen dhe menyren e udheheqjes së evidence nga paragrafi (9) i ketij neni, e percakton ministri.

(11) Ministria ose komuna, perkatesisht komuna e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit për kontrollin e kryera nga inspektorët dhe nepunesit e autorizuar shtetërorë, perkatesisht personat e autorizuar dhe edukimet e realizuara, në kuader të kompetencave të percaktuara me kete ligj, perpijon raporte tremujore dhe i shpall në ueb faqen e Ministrise ose komunes, perkatesisht komunes së Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit në pasqyre të unifikuar tremujore.

#### Neni 215

(1) Në zbatimin e mbikeqyrjes inspektuese, inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetëror, perkatesisht personi i autorizuar në kuader të kompetencave të percaktuara me kete ligj eshte i autorizuar që t'i percaktoje keto masa:

- të urdheroje menjanimin e mangesive dhe parregullsite të konstatuara në afat të caktuar dhe

- të urdheroje që pruresi i aktvendimit, të njejtin ta rishqyrtoje dhe të miratoje aktvendim të ri me të cilin do ta zevendesojë aktvendimin paraprak të miratuar në kundërshtim me ligjin ose me rregulle tjeter.

(2) Në aktvendimin me të cilin percaktohet masa, percaktohet edhe afati për zbatimin e saj.

(3) Në rast të ekzistimit të rrezikut të drejtperdrejte për shendetin ose jeten e qytetareve, inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetëror, perkatesisht personi i autorizuar, në kuader të kompetencave të percaktuara me kete ligj do të miratoje aktvendim me goje dhe menjehere do të urdheroje zbatimin e tij.

(4) Aktvendimi me goje nga paragrafi (3) i ketij neni, futet në procesverbalin nga neni 213 i ketij ligji, ndërsa aktvendimi me shkrim miratohet në afat prej tete ditësh nga dita e shqiptimit të aktvendimit me goje.

#### Neni 216

(1) Inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetëror, perkatesisht personi i autorizuar, në kuader të kompetencave të percaktuara me kete ligj gjate zbatimit të mbikeqyrjes inspektuese i ka të drejtat dhe obligimet, si vijojne:

- me aktvendim të ndaloje që institucioni për femije, agjencia për dhenie të sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve, personat fizike që kryejne pune të caktuara nga veprimtaria, si dhe qendra për pune sociale të zbatojne masa dhe të ndermarrin pune që jane në kundërshtim me ligjin dhe rregullat tjera dhe

- të parashtrroje kallezim penal për kryerje të vepres penale, kerkese për ngritje të procedures për kundervajtje apo initiative për ngritje të procedures disiplinore, nese gjen deshmi se me shkeljen e rregullave eshte kryer veper penale, kundervajtje apo shkelje më e rende e disiplinës së punes, moskryerje, kryerje e pandërgjegjshme dhe jo me kohe e puneve dhe detyrave të punes.

(2) Organi të cilit i eshte parashtruar kerkesa apo kallezimi nga paragrafi (1) alineja 2 të ketij neni, detyrohet që vendimin e vet t'ia dorezoje inspektorit dhe nepunesit të autorizuar shtetëror, perkatesisht personit të autorizuar në afat prej 15 ditësh pas miratimit të vendimit.

#### Neni 217

(1) Për ankesen kunder konkluzionit nga neni 214 paragrafi (7) i ketij ligji dhe aktvendimit të inspektorit dhe nepunesit të autorizuar shtetëror, perkatesisht personit të autorizuar nga neni 207 i ketij ligj vendos komisioni i perbere nga tre anetare dhe zevendes të tyre të emeruar nga ministri, perkatesisht kryetari i komunes, i komunes së Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit.

(2) Kryetari dhe zevendes kryetari i komisionit emerohen nga radhet e nepunesve shtetërorë udheheqes, kurse të dy anetarët dhe zevendesit e tyre, nga radhet e nepunesve shtetërorë profesionale të cilet nuk jane perfshire në kryerje të mbikeqyrjes inspektuese, nga njësia organizative për mbrojtje të femijeve.

(3) Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

(4) Me perjashtim, zbatimi i aktvendimit mund të prolongohet deri në vendimin perfundimtar për ankesën nese kete natyra e marrëdhënieve e lejon, nese prolongimi nuk eshte në kundërshtim me interesin publik dhe nese me zbatimin e aktvendimit do të shkaktohet dëm mbi subjektin e mbikeqyrjes apo shfrytëzuesit e sherbimeve të tij.

(5) Propozimi për prolongimin e zbatimit të aktvendimit deklarohet në ankese.

#### Neni 218

(1) Nese gjate mbikeqyrjes së kryer inspektuese percaktohet se institucioni, agjencia për dhenie të sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore dhe personi fizik që kryen pune të caktuara nga veprimtaria nuk i plotesojne kushtet e percaktuara, bejne shkelje më të rende të ligjit apo rregulles tjeter apo më rende i shkelin të drejtat e shfrytëzuesve, inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetëror, perkatesisht personi i autorizuar, në kuader të kompetencave të percaktuara me kete ligj pa prolongim e njofton ministrin/kryetarin e komunes.

(2) Nese inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetëror percakton se institucioni, perkatesisht agjencia për dhenie të sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore dhe personi fizik që kryen pune të caktuara nga veprimtaria në afatin e caktuar nuk i menjanon parregullsite e percaktuara me aktvendimin nga neni 214 i ketij ligji detyrohet pa prolongim me shkrim ta njoftoje ministrin.

(3) Nese personi i autorizuar percakton se institucioni publik për femije në afatin e percaktuar nuk i ka menjanuar parregullsite e percaktuara me aktvendimin nga neni 216 i ketij ligji detyrohet pa prolongim me shkrim ta njoftoje kryetarin e komunes, keshillin drejtues të institucionit dhe Ministrine.

#### Neni 219

(1) Ministri në baze të njoftimit nga neni 218 i ketij ligji, do të miratoje aktvendim për:

- ndalim për pune të institucionit për femije, të agjencise për dhenie të sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshes parashkollore dhe të personit fizik që kryen pune të caktuara nga veprimtaria, nese nuk kane marrë aktvendim për kryerje të veprimtarise nga neni 102 paragrafi (1) të ketij ligji, perkatesisht aktvendim për kryerje të puneve të caktuara nga veprimtaria nga nenet 78 paragrafi (3) dhe 88 paragrafi (2) të ketij ligji, si dhe nese nuk i ploteson më kushtet në aspekt të hapësires, pajisjes dhe kuadrove profesionale dhe kuadrove tjera të percaktuara me kete ligj dhe



- marrje të masave tjera për të cilat është i autorizuar me kete ligj apo ligj tjetër.

(2) Kunder aktvendimit nga paragrafi (1) alineja 1 e ketij neni mund të parashtrohet ankese në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurën e Marredhenies së Punes në Shkallë të Dytë në afat prej tete ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

#### Neni 220

(1) Inspektori dhe nepunesi i autorizuar shtetëror për zbatim të mbikeqyrjes inspektuese kontrollon nese personat që janë perfshire në sistemin e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve të moshës parashkollore kane licence të vlefshme për pune.

(2) Nese gjate kryerjes së mbikeqyrjes konstatohet se personi punon pa licence për pune, pa licence perkatese për pune, me licence që është e paparteritur, me licence e cila nuk është e vazhduar ndermerr masa në pajtim me kompetencen e tij dhe menjehere e njofton komisionin për licencim.

### XVIII. MANIFESTIME KUSHTUAR FEMIJEVE

#### Neni 221

(1) Manifestimet kushtuar femijeve jane: "Dita boterore e femijes", "Java e femijeve" dhe "Dita e femijes".

(2) "Dita boterore e femijes" është e hena e pare në muajin tetor.

(3) "Java e femijeve" mbahet çdo vit në javen e plote të pare të muajit tetor dhe zgjate shtate dite.

(4) "Dita e femijes" është dita e fundit e "Javes së femijeve".

(5) Gjate kohezgjatjes së manifestimeve kushtuar femijeve organizohen aktivitete kulturore, argetuese, arsimore, sportive - rekreative nga sfera e ekologjise dhe aktivitete tjera kushtuar femijeve.

(6) Aktivitetet e manifestimeve kushtuar femijeve financohen nga mjetet që grumbullohen gjate kohezgjatjes së manifestimit.

#### Neni 222

(1) Gjate kohezgjatjes së "Javes së femijeve" paguhet shume e posacme e:

- çdo bilete hyrese të shitur për teater, kinema, ekspozite artistike dhe manifestime tjera kulturore,

- çdo dergese postare në komunikacionin e brendshem, pervec gjerave të shtypura,

- çdo bilete hyrese në ndeshje sportive dhe manifestime tjera sportive,

- çdo bilete të shitur udhëtimi në komunikacionin hekurudhor, automobilistik, nderkombetar, nderurban dhe ajror dhe

- çdo forme të shitur të incizimit video dhe muzikor elektronik, video kasete e të tjera.

(2) Nga pagesa e shumes nga paragrafi (1) alineja 1 të ketij neni, perjashtohen ekspozitat, organizimet dhe manifestimet tjera kulturore të organizuara nga nxenesit dhe studentet në institucionet publike.

#### Neni 223

Qeveria me vendim çdo vit e percakton menyren e arketimit të shumes për "Javen e femijeve" nga neni 222 të ketij ligji.

### XIX. DISPOZITA PËR KUNDERVAJTJE

#### Neni 224

(1) Gjobe në shume prej 500 deri në 1 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje punedhenesit, nese në kundershtim me dispozitat e ketij ligji nuk

jep të dhena apo jep të dhena të paverteta nga të cilat varet realizimi i të drejtes nga mbrojtja e femijeve apo shfrytëzimi i sherbimeve në institucione.

(2) Gjobe në shume prej 200 deri në 400 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet edhe personit pergjegjes në personin juridik për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni.

#### Neni 225

Gjobe në shume prej 200 deri në 400 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje prindit apo kujdestarit të femijes, shfrytëzues i të drejtes për mbrojtje të femijeve, perkatesisht shfrytëzues i sherbimeve në institucione, nese deklarata apo kerkesa që ka dhene permban të dhena të paverteta apo të pasakta, kurse ka sherbyer si deshmi për realizimin e të drejtes nga mbrojtja e femijeve apo për shfrytëzim të sherbimit në institucionin për femije.

#### Neni 226

(1) Gjobe në shume prej 500 deri në 1 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje edhe personit pergjegjes në qendren për pune sociale, perkatesisht institucionin për femije që në kundershtim me dispozitat e ketij ligji, do të miratoje të drejten nga mbrojtja e femijeve.

(2) Gjobe në shume prej 500 deri në 1 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje drejtorit të qendres për pune sociale, sepse nuk vepron në pajtim me nenin 46 të ketij ligji.

(3) Gjobe në shume prej 200 deri në 400 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet personit pergjegjes në qendren për pune sociale për mosmbajtje apo mbajtje joadekuate të evidences dhe dokumentacionit të percaktuar, si dhe për mosveprim sipas aktvendimit për menjanim të mangesive dhe parregullsive të konstatuara në afatin e caktuar (nenet 195 paragrafi (2) dhe 215 paragrafi (1) alineja 1).

(4) Gjobe në shume prej 500 deri në 1 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet personit pergjegjes në qendren për pune sociale për mosparashtrim të raportit për shfrytëzim të mjeteve dhe kerkese për mjetet e nevojshme për të drejtat (neni 52).

#### Neni 227

(1) Gjobe në shume prej 500 deri në 1 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje personit që bën drejtperdrejte apo terthorazi diskriminim dhe keqtrajtim në realizimin e të drejtave dhe formave të mbrojtjes së femijeve të percaktuara me kete ligj (neni 13).

(2) Gjobe nga paragrafi (1) i ketij neni, do të shqiptohet edhe për institucionin për mbrojtje sociale dhe siguri sociale që vendosin për të drejtat e percaktuara me ligj, si dhe për institucionet publike për femije të themeluar nga Qeveria, komuna, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit dhe institucionet private për femije që jane themeeluar nga personi juridik dhe fizik, agjencia për dhenie të sherbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve të moshës parashkollore.

(3) Gjobe nga paragrafi (1) i ketij neni, do t'i shqiptohet për kundervajtje edhe personit fizik që kryen pune të caktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve si veprimtari profesionale nese bën diskriminim të drejtperdrejte.

#### Neni 228

(1) Gjobe në shume prej 500 deri në 1 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje institucionit për femije, perkatesisht personit fizik që në menyre të mevetesishme kryen pune të caktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve si veprimtari profesionale.

onale, agjencise për dhenie të shërbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve nga mosha parashkollë, nese:

- organizon organizim ose veprim politik dhe fetar edhe në institucionin për femije, perkatesisht të personi fizik apo tek agjencia behet keqperdorimi i femijeve nga nxitjet e njejtë, si dhe behet keqtrajtim psikik dhe fizik, denim apo veprim tjetër jonjerezor apo keqperdorim i femijeve (neni 12 paragrafi (2) dhe (4)),

- realizon programe që nuk janë miratuar nga organi kompetent (neni 168),

- realizon programe pa marrje të mendimit pozitiv (neni 168 paragrafi (12) dhe 95 paragrafi (5)),

- realizon program që nuk është miratuar nga ministri (neni 168 paragrafi (11)),

- nuk bashkepunon me institucionet nga veprimtaria shëndetësore, perkatesisht nuk vepron sipas nenit 172 paragrafi (1) të këtij ligji,

- vepron në kundërshtim me dispoziten nga neni 172 paragrafi (2) të këtij ligji,

- nuk dërgon apo nuk miraton program vjetor për punë (nenet 168 dhe 95),

- nuk i realizon standardet dhe normativat për kryerje të veprimtarisë (neni 100 paragrafi (3)),

- themelon institucion për femije pa leje (neni 106),

- e prish dedikimin dhe funksionin themelor të objektit në periudhën e kohezgjatjes së qirase (196),

- fillon me punë dhe kryen veprimtari, e nuk i plotëson kushtet e percaktuara, perkatesisht nese kryen veprimtari pa aktvendim të organit kompetent (neni 102),

- fillon me punë pa marrje të aktvendimit për kryerje të punëve të caktuara nga veprimtaria (nenet 78 paragrafi (3) dhe 88 paragrafi (2)),

- nuk njofton për pushim të punës së institucionit privat (neni 113),

- personi fizik që në mënyrë të mevetëshme kryen punë të caktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve dhe agjencia për dhenie të shërbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve nga mosha parashkollë nuk mban evidence për shfrytëzuesit dhe shërbimet e dhe-na (nenet 89 paragrafi (5) alinete 3 dhe 79 paragrafi (1)),

- bën zgjedhje të të punësuarve në kundërshtim me kushtet e percaktuara me kete ligj,

- nuk e mban evidencën dhe dokumentacionin e percaktuar apo e mban në kundërshtim me atë të percaktuar (neni 195),

- shfrytëzon doracake dhe revista të femijeve për të cilat nuk ka aktvendim për leje dhe perdorim (neni 173 paragrafi (3)),

- nuk i zbaton cmimet e percaktuara të shërbimeve nga organi kompetent (neni 191),

- dërgon të dhëna të pavërteta, si dhe në mënyrë të paligjshme dhe të padrejte i shfrytëzon mjetet (neni 192),

- nuk mundeson kryerje të mbikeqyrjes (212 paragrafi (5)),

- nuk i kryen masat dhe veprimet e urdheruara (neni 215) dhe

- nuk e respekton ndalimin për punë të institucionit për femije, agjencise për dhenie të shërbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve nga mosha parashkollë dhe personi fizik që në mënyrë të mevetëshme kryen punë të caktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve si veprimtari profesionale dhe mosndermarrjen e masa-ve tjera (neni 219).

(2) Gjore në shume prej 500 deri në 1 000 euro në kundërvlere me denare do t'i shqiptohet edhe personit udhëheqës në institucion, perkatesisht tek agjencia për dhenie të shërbimeve për ruajtje dhe perkujdesje të femijeve nga mosha parashkollë dhe personit fizik që në mënyrë të mevetëshme kryen punë të caktuara nga veprimtaria e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve si veprimtari profesionale, nese:

- kryen dhune psikike dhe fizike dhe keqtrajtim apo veprim tjetër jonjerezor apo keqperdorim të femijeve (neni 12),

- e mban evidencën dhe dokumentacionin në kundërshtim me nenet 79, 89 dhe 195 të këtij ligji dhe
- shfrytëzon doracake dhe revista të femijeve për të cilat nuk ka aktvendim për leje dhe perdorim (neni 173).

(4) Gjore në shume prej 500 deri në 1 000 euro në kundërvlere me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje edhe drejtorit të institucionit publik për femije nese lejon pagëse të mjeteve që nuk janë percaktuar me planin financiar vjetor të institucionit (neni 124).

#### Neni 229

(1) Gjore në shume prej 500 deri në 1 000 euro në kundërvlere me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje institucionit për femije që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji në aspekt të fillimit, kohezgjatjes dhe mbarimit të kohës së punës të të punësuarve (nenet 67 dhe 69 paragrafi (5)).

(2) Gjore në shume prej 500 deri në 1 000 euro në kundërvlere me denare do t'i shqiptohet edhe personit pergjegjes në institucionin për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

#### Neni 230

(1) Gjore në shume prej 200 deri në 400 euro në kundërvlere me denare do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili nuk arketon mjete për "Javen e femijeve" perkatesisht i cili nuk e paguan shumën e arketuar (neni 222).

(2) Gjore në shume prej 200 deri në 400 euro në kundërvlere me denare do t'i shqiptohet edhe personit pergjegjes në personin juridik, për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

#### Neni 231

(1) Procedurën e kundërvajtjes për kundërvajtje të parapara në kete ligj e udhëheq gjykata kompetente.

(2) Para parashtrim të kërkesës për ngritje të procedurës së kundërvajtjes për kundërvajtje të parapara me kete ligj, Ministria udhëheq procedure për barazim në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

### XX. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

#### Neni 232

(1) Institucionet publike për femije ekzistuese – kopshet për femije të themeluara nga komuna dhe komuna në Qytetin e Shkupit dhe të regjistruara në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë e perbejne rrjetin e institucioneve publike për femije - kopshtet e femijeve dhe me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë të punojnë dhe ta organizojnë dhe realizojnë veprimtarinë e perkujdesjes dhe edukimit të femijeve të moshës parashkollë në pajtim me kete ligj si institucione publike për femije - kopshte për femije të themeluara nga komuna dhe komuna në Qytetin e Shkupit.

(2) Institucioni publik për femije ekzistues - pushimorja për femije "Ilinden" - Gostivar do të vazhdojë të punojë si

institucion publik për femije - pushimore për femije e themeluar nga Qeveria.

(3) Institucionet private për femije ekzistuese - kopshtet për femije do të vazhdojnë të punojnë si institucione private për femije – kopshte për femije të themeluara në baze të lejes së Qeverisë dhe regjistrimit të bere në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë pas aktvendimit të marre për kryerje të veprimtarisë nga ministri.

#### Neni 233

(1) Procedurat për themelim dhe marrje të aktvendimit për kryerje të veprimtarisë së institucioneve private për femije - kopshteve për femije të filluara sipas Ligjit për mbrojtje të femijeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 98/2000, 17/2003, 65/2004, 113/2005, 98/2008, 107/2008, 83/2009, 156./2009, 51/11 dhe 157/11) dhe rregullat e miratuara në baze të tij deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të perfundohen në pajtim me ato rregulla.

(2) Procedurat për transformim të personit juridik të filluara sipas nenit 3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit për mbrojtje të femijeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 157/11) deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të perfundohen në pajtim me Ligjin për mbrojtje të femijeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 98/2000, 17/2003, 65/2004, 113/2005, 98/2008, 107/2008, 83/2009, 156./2009, 51/11 dhe 157/11) dhe rregullat e miratuara në baze të tij.

#### Neni 234

(1) Aktet nenligjore të parapara me kete ligj do të miratohen në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

(2) Deri në miratimin e rregullave të këtij ligji do të zbatohen rregullat në fuqi para dites së hyrjes në fuqi të këtij ligji, porveç dispozitave të Rregullores për kushtet e përferta, kriteret dhe menyren e realizimit të së drejtës së ndihmes së njehershme në para për foshnje të sapolindur dhe të drejtës së shteses prinderore për femije ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 168/2008 dhe 34/2009) që kanë të bëjnë me shtese prinderore për femije (për femijen e trete dhe të katert), që do të vazhdojnë të zbatohen deri në perfundim të periudhës së shfrytezimit të shteses prinderore për femije (për femijen e trete dhe të katert) për të drejtën e fituar të shteses prinderore për femije (për femijen e trete dhe të katert) në procedurën e shfrytezimit të tyre.

#### Neni 235

(1) Institucionet ekzistuese për femije detyrohen të harmonizohen me kushtet e parapara për pune nga ky ligj në afat prej një viti nga dita e miratimit të rregullave miratimi i të cilave është percaktuar me kete ligj.

(2) Të punesuarit me arsim të larte, siperor dhe të mesem të cilet në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk kanë lloj dhe shkallë perkatese të arsimit dhe kanë së paku pese vjet pervoje pune në vendin e punes perkatese, munden edhe më tutje ta kryejnë punën në vendin e punes në të cilën janë gjendur me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

(3) Të punesuarit me arsim të larte, siperor dhe të mesem të cilet në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk kanë lloj dhe shkallë perkatese të arsimit dhe nuk kanë së paku pese vjet pervoje pune në vendin e punes perkatese detyrohen që në afat prej tete vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji ta marrin llojin dhe shkallën e nevojshme të arsimit.

(4) Nese në afatin e parapare në paragrafin (3) të këtij neni, të punesuarit nuk e mbarojnë arsimin e tyre, marrëdhënia e punes do t'u pushoje.

(5) Komisioni për Licencim të personave profesionale në sistemin për perkujdesje, edukim dhe arsim të femijeve të moshes parashkollore dhe drejtoresh të institucioneve për femije formohet në afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(6) Në institucionet për femije - kopshte për femijeve, punetoret profesionale (pedagog, punetor social, defektolog, logoped, mjek, pediater dhe stomatolog), bashkepunetoret profesionale (pedagog i muzikes, pedagog i artit figurativ, pedagog i edukates fizike, infermiere e larte medicinale dhe punetor social), edukatoret dhe infermieret detyrohen më së voni në afat prej 12 muajsh nga themelimi i Komisionit për licencim të personave profesionale në sistemin për perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshes parashkollore dhe të drejtoresh të institucioneve për femije, ta marrin licencën perkatese për punë për të cilën nuk duhet ta paguajnë shpenzimin për leshim.

(7) Personat profesionale të cilet punojnë në institucionet për femije - kopshte për femije dhe të cilet në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë pese vjet deri në pensionim nuk sigurojnë licence për punë.

#### Neni 236

(1) Drejtoret e institucioneve publike për femije (kopshte për femije dhe pushimoret për femije) të zgjedhur, perkatesisht të emeruar para dites së hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë t'i kryejnë funksionet e tyre deri në zgjedhjen, perkatesisht emerimin e organit të ri të udheheqjes, në pajtim me kete ligj dhe detyrohen më së voni në afat prej 12 muajsh nga themelimi i Komisionit për licencim të personave profesionale në sistemin për perkujdesje dhe edukim të femijeve të moshes parashkollore dhe të drejtoresh të institucioneve për femije ta marrin licencën për drejtor për të cilën nuk duhet ta paguajnë shpenzimin për leshim.

(2) Organet e menaxhimit të institucioneve publike për femije (kopshte për femije dhe pushimoret për femije) të zgjedhura para dites së hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë ta kryejnë funksionin e tyre deri në zgjedhjen e organit të ri të menaxhimit, në pajtim me kete ligj.

(3) Kopshtet për femije/pushimoret për femije do ta harmonizojnë punën e tyre dhe aktet e tyre me dispozitat e këtij ligji në afat prej një viti nga dita e miratimit të rregullave miratimi i të cilave është percaktuar me kete ligj.

#### Neni 237

Kerkesat për realizim perkatesisht vazhdim të së drejtës së shteses për femije, shteses së vecante dhe shteses prinderore për femije si dhe për realizim të së drejtës së ndihmes së njehershme në para për foshnje të sapolindur të parashtruara para dites së hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe të cilat nuk janë zgjidhur deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zgjidhen sipas dispozitave të rregullave në fuqi deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 238

(1) Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të realizohet e drejta e marre e shteses prinderore për femije (për femijen e trete dhe të katert) në pajtim me dispozitat e neneve 30-a dhe 30-b të Ligjit për mbrojtje të femijeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 98/2000, 17/2003, 65/2004, 113/2005, 98/2008 dhe 107/2008), dispozitat e neneve 98 dhe 99 të Ligjit për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit për mbrojtje të femijeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 83/2009) dhe rregullat në fuqi deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji në lartesi të percaktuar me nenin 9 të Ligjit për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit për mbrojtje të femijeve

("Gazeta Zyrtare e Republikes së Maqedonise" numer 156/2009).

(2) E drejta e marre për shtese prinderore për femije (për femijen e trete dhe të katert) nga paragrafi (1) i ketij neni, do të vazhdoje të realizohet, perkatesisht vazhdon deri në perfundim të periudhes së shfrytezimit të së drejtes së realizuar perkatesisht të drejtes së vazhduar të shteses prinderore për femije (për femijen e trete deri në perfundim të periudhes prej dhjete vjetesh, kurse për femijen e katert edhe te shtesa prinderore unike deri në perfundim të periudhes prej 15 vjetesh), në pajtim me nenin 30-a të Ligjit për mbrojtje të femijeve ("Gazeta Zyrtare e Republikes së Maqedonise" numer 98/2000, 17/2003, 65/2004, 113/2005, 98/2008, 107/2008) dispozitat e neneve 98 dhe 99 të Ligjit për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit për mbrojtje të femijeve ("Gazeta Zyrtare e Republikes së Maqedonise" numer 83/2009) dhe rregullat në fuqi deri në ditën e hyrjes në fuqi të ketij ligji në lartesi prej 8 048 denare për femijen e trete, 11 267 denare për femijen e katert dhe 16 096 denare për shtesen prinderore unike për femije, shuma do të harmonizohen me rritjen e shpenzimeve për jetese për vitin paraqar, të publikuara nga Enti Shtetëror për Statistike në janar për vitin rrjedhes.

(3) Vazhdimi i shfrytezimit të së drejtes së marre të shteses prinderore për femije (për femijen e trete dhe të katert) nga paragrafi (1) i ketij neni do të realizohen në formularët e percaktuar të kerkeses dhe dokumentacionit të nevojshem, në procedure në pajtim me dispoziten e ketij ligji.

Neni 239

Në rast kur rritja e shpenzimeve për jetese për vitin paraqar janë më të uleta nga viti i fundit të harmonizimit, apo janë me shenje negative, nuk behet harmonizimi i lartesisë së të drejtave dhe lartesisë së të hyrave mujore mesatare për anetar të familjes për realizimin e të drejtes së shteses për femije (shume kufizuese) perkatesisht të njejtat do të sigurohen me vitin e fundit të harmonizuar si më e volitshme për shfrytezesin.

Neni 240

Nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji deri në fillimin e zbatimit të nenit 22 të ketij ligji, do të vazhdoje të zbatohet dispozita e nenit 16 të Ligjit për mbrojtjen e femijeve ("Gazeta Zyrtare e Republikes së Maqedonise" numer 98/2000, 17/2003, 65/2004, 113/2005, 98/2008 dhe 107/2008).

Neni 241

Dispozitat e neneve 22 dhe 24 paragrafi (2) të ketij ligji do të fillojnë të zbatohen pas aderimit të Republikes së Maqedonise në Bashkimin Evropian.

Neni 242

(1) Programi për mesim dhe zhvillim të hershem nga neni 168 paragrafi (5) të ketij ligji, do të miratohet në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

(2) Deri në miratimin e programit nga paragrafi (1) i ketij neni, në institucionet publike për femije - kopshtet për femije do të zbatohen Bazat e programit për pune edukative arsimore me femije të moshes parashkollore në kopshtet publike për femije.

Neni 243

Me ditën e hyrjes në fuqi të ketij ligji shfuqizohet Ligji për mbrojtje të femijeve ("Gazeta Zyrtare e Republikes së Maqedonise" numer 98/2000, 17/2003, 65/2004, 113/2005, 98/2008, 107/2008, 83/2009, 156/2009, 51/11 dhe 157/11).

Neni 244

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikes së Maqedonise".

717.

Vрз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

**У К А З**

**ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА БЕЗБЕДНОСТ И ЗДРАВЈЕ ПРИ РАБОТА**

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за безбедност и здравје при работа, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 12 февруари 2013 година.

Бр. 07-827/1  
12 февруари 2013 година  
Скопје

Претседател  
на Република Македонија,  
**Горге Иванов, с.р.**

Претседател  
на Собранието на Република  
Македонија,  
**Трајко Вељаноски, с.р.**

**ЗАКОН**

**ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА БЕЗБЕДНОСТ И ЗДРАВЈЕ ПРИ РАБОТА**

Член 1

Во Законот за безбедност и здравје при работа („Службен весник на Република Македонија” број 92/2007 и 136/11), по членот 18 се додаваат четири нови члена 18-а, 18-б, 18-в и 18-г, кои гласат:

„Член 18-а

(1) Стручното усовршување на стручни лица за безбедност при работа се врши преку учество на обуки за стручно усовршување.

(2) Стручното усовршување го организираат и спроведуваат наставно-научни установи, државни органи, правни лица од областа на безбедноста и здравјето при работа (во натамошниот текст: организатор), кои ги исполнуват следниве услови да:

- имаат најмалку две лица кои спровеле и одржале најмалку три обуки од областа на безбедноста при работа на национално и меѓународно ниво,

- имаат најмалку три години искуство во организирање на меѓународни и национални конференции од областа на безбедноста при работа,

- имаат донесено годишна програма за спроведување на обуки од областа на безбедноста при работа, која особено содржи облици на стручно усовршување, критериуми за утврдување на бодови според видот на обуките и времетраењето на обуките и

- имаат обезбедено просторија за одржување на обуките.

Член 18-б

(1) Организаторот на обуките поднесува писмено барање до министерот надлежен за работите од областа на трудот за добивање на одобрение за спроведување на обуки за стручно усовршување на стручни лица за безбедност при работа.

(2) По поднесеното барање од ставот (1) на овој член министерот надлежен за работите од областа на